Introduction: Biosecurity measures in nursing are important for several reasons, primarily to prevent healthcare-associated infections (HAIs) and to protect both healthcare workers and patients from infectious diseases. These measures include a wide range of protocols, such as hand hygiene, the use of personal protective equipment (PPE), safe injection practices, and proper handling and disposal of potentially infectious materials. **Purpose:** The objective of this research was to observe/study the implementation of biosafety standards by the nursing staff in the regional hospital of Vlorë. **Methodology:** This is across-sectional descriptive study conducted on the nursing staff of the regional hospital of Vlorë during April-June 2024, using the applied instrument "Questionnaire on knowledge of biosafety measures in nursing". **Discussions:** According to the data presented in the table, we obtain the information that 87.1% of nurses are aware of the proper method of disposing of hospital waste compared to 80% of nurses in Spain. The most commonly used method of handwashing is antiseptic, with 60% of nurses using it. 67.1% have chosen to wash their hands in all cases, both before and after using gloves, and also when having contact with the patient. 52.6% of nurses have reported that they use personal protective equipment more than 6 times per shift compared to 37.7% of staff in Peru, and compared to 11% in Spain who never use them. Work experience influences the knowledge that nurses have regarding biosafety measures, according to the Chi-Square table analysis. 52.9% of nurses have participated in training related to biological safety, while 47.1% have stated they have not but see it as important to participate in such training. **Conclusions:** Based on the data presented in the table, we gather that 20% of the nurses were selected for the emergency department, 8.6% for the ENT (Otolaryngology) department, and 18.6% work in the surgery department. 20% of them are part of

the pediatrics department. The majority, 25.7%, were chosen for the hepatology department, while only 7.1% work in the infectious diseases department. According to the results of the table above, we learn that 32.9% of the nurses hold a bachelor's degree, while 67.1% have a master's degree. 42.9% of the nurses had up to 10 years of work experience, whereas 57.1% had more than 10 years of experience. We observe that most of the nurses with over 10 years of work experience have better knowledge of who is involved in the protective barriers of biosafety. This interpretation suggests that work experience influences the level of information nurses have regarding biosafety measures, thus confirming Hypothesis 1. 87.1% of nurses are aware of the correct way to dispose of hospital waste, confirming Hypothesis 3. Meanwhile, 67.1% reported that they wash their hands in all cases, both before and after using gloves, and also when in contact with patients. This confirms Hypothesis 2. Additionally, 70% of them, who make up the majority of the sample, use gloves more frequently as a protective measure. 52.6% of nurses stated that they use personal protective elements more than six times per shift, 30% do this 4-6 times, 12.9% only 2-4 times, and 4.3% only once. 82.9% of nurses consider it necessary to participate in training on the biological safety of personnel. An interesting finding is that those who work night shifts more frequently report using personal protective elements only once. What stands out is that all the nurses in the surgery department view participation in training as very important and necessary. The nurses who reported having attended training stated that 30% of them had done so in the last four years, 15.7% in the last two years, and 7.1% in the last year. 64.3% of nurses believe that biosafety standards are a set of preventive measures that protect the health and safety of personnel, patients, and the community, thereby responding correctly to the question.

Key words: *biosecurity measures, nursing personnel, nosocomial infections, regional hospital*

Hyrje:

Masat e biosigurisë janë thelbësore për garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm në institucionet shëndetësore, duke mbrojtur pacientët dhe personelin nga rreziqet infektive që mund të hasen në mjediset spitalore.^[6] Shëndeti publik përbën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit dhe mirëqenies së çdo shoqërie. Brenda këtij kuadri, siguria dhe mbrojtja nga infeksionet spitalore luajnë një rol kyç në garantimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor. Në spitalet moderne, përdorimi i

masave të biosigurisë është i domosdoshëm për të mbrojtur jo vetëm pacientët, por edhe personelin shëndetësor nga rreziqet infektive që mund të hasen në mjediset spitalore. Ky studim, me titull "Përdorimi i Masave të Biosigurisë nga Personeli Infermieror në Spitalin Rajonal Vlorë", synon të shqyrtojë në detaje rëndësinë dhe zbatimin e këtyre masave në një nga institucionet kryesore shëndetësore në Shqipëri. Spitali Rajonal Vlorë, duke shërbyer si një qendër referimi për një pjesë të madhe të popullsisë në jug të vendit, përballet çdo ditë me një gamë të gjerë rastesh klinike që përfshijnë trajtimin e sëmundjeve infektive dhe menaxhimin e pacientëve me sëmundje të ndryshme. Infermierët, si një nga grupet më të rëndësishme të personelit shëndetësor, kanë një përgjegjësi të madhe në parandalimin e përhapjes së infeksioneve dhe garantimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë. Zbatimi i rregullt dhe rigoroz i masave të biosigurisë nga ana e tyre është vendimtar për të minimizuar rreziqet dhe për të siguruar një standard të lartë të kujdesit. Biosiguria përfshin një sërë masash dhe praktikash të dizajnuara për të parandaluar ekspozimin ndaj agjentëve infektues dhe për të kontrolluar përhapjen e tyre brenda institucioneve shëndetësore. Këto masa përfshijnë përdorimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse personale (PMP), higjienën e duarve, sterilizimin e pajisjeve mjekësore, dezinfektimin e sipërfaqeve, menaxhimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme dhe edukimin e vazhdueshëm të personelit për procedurat më të mira të praktikës klinike.^[7] Studimet kanë treguar se zbatimi i rregullt dhe i saktë i masave të biosigurisë mund të ulë ndjeshëm incidencën e infeksioneve spitalore, të cilat përbëjnë një problem të madh për sistemet shëndetësore globalisht.^[17] Në Shqipëri, megjithatë, ekzistojnë ende sfida të konsiderueshme lidhur me zbatimin e këtyre masave, të cilat lidhen me mungesën e burimeve, trajnimin të pamjaftueshëm dhe ndërgjegjësimin të ulët. Ky studim do të fokusohet në analizimin e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të personelit infermieror në Spitalin Rajonal Vlorë lidhur me masat e biosigurisë. Do të shqyrtohen gjithashtu faktorët që ndikojnë në zbatimin e këtyre masave, si dhe barrierat që mund të pengojnë një zbatim të plotë dhe efektiv. Përmes këtij hulumtimi, synohet të nxirren në pah rekomandime dhe strategji që mund të përmirësojnë më tej përpjekjet për kontrollin e infeksioneve në këtë institucion dhe të kontribuojnë në përmirësimin e përgjithshëm të sigurisë shëndetësore në vend. Përfundimisht, ky studim synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të detajuar të situatës aktuale të biosigurisë në Spitalin Rajonal Vlorë dhe të nxisë zhvillimin e politikave dhe praktikave që do të mbështesin një mjedis më të sigurt dhe më të shëndetshëm për pacientët dhe personelin shëndetësor.

Qellimi: Të analizojë njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e personelit infermieror në Spitalin Rajonal

Vlorë lidhur me përdorimin e masave të biosigurisë, me qëllim identifikimin e niveleve të ndërgjegjësimin dhe përgatitjes së tyre për parandalimin e infeksioneve spitalore. Të identifikojë faktorët dhe barrierat që ndikojnë në zbatimin efektiv të masave të biosigurisë nga personeli infermieror në Spitalin Rajonal Vlorë, duke ofruar rekomandime dhe strategji për përmirësimin e praktikave të biosigurisë dhe rritjen e sigurisë shëndetësore në këtë institucion.

Objektiva: Të identifikojmë se eksperiencia në punë ndikon në informacionin që infermierët kanë në lidhje me masat e biosigurisë.

Të vërtetojmë se infermierët janë të mirëinformuar rreth masve të biosigurisë dhe mënyrës se si dhe kur duhet ti zbatojnë ato.

Të vërtetojmë se infermierët janë të mirëinformuar rreth mënyrave të eliminimit të mbeturinave spitalore.

Metodologjia: Ky është një studim kros-seksional deskriptiv që është realizuar në personelin infermieror të Spitalit Rajonal Vlorë. Si instrument matës është përdorur një pyetësor i vetëstrukturuar dhe i vetëadministruar. Të dhënat e fituara janë paraqitur përmes grafikëve, tabelave të ndryshme. Në qendër të këtij studimi qëndrojnë masat e biosigurisë që përdoren nga personeli infermieror, informacionet rreth tyre janë siguruar nëpërmjet faqeve me informacionet më të reja dhe të sigurta në literatura të ndryshme të shënuara me referenca.

Tema përfshin Informacione të ndryshme në lidhje me masat e biosigurisë të cilat zbatohen dhe nëpër botë nga personeli mjekësor në shtete të ndryshme. Në teme janë përfshirë studime shkencore të huaja në lidhje me masat e biosigurisë të gjetura përmes faqeve shkencore në internet ose librave/revistave të ndryshme shkencore.

Rezultatet: 87.1% e infermierëve janë në dijeni të mënyrës së duhur së hedhjes së mbeturinave spitalore krahasuar me 80% të infermierëve në Spanjë.

Mënyra më e përdorur e larjes së duarve është ajo antiseptike me 60% të infermierëve.

67.1% kanë zgjedhur se i lajnë duart në të gjitha rastet edhe para dhe pas përdorimit të dorezave por edhe kur kanë kontakte me pacientin.


52.6% e infermierëve kanë deklaruar se mbi 6 herë në turn përdorin elementet e mbrojtjes personale krahasuar me 37.7% të personelit në Peru krahasuar dhe me 11% të cilët nuk i përdorin kurrë në Spanjë.

Përvoja në punë ndikon në informacionin që zotërojnë infermierët në lidhje me masat e biosigurisë sipas analizës së tabelës Chi-Square.

52.9% e infermierëve kanë marrë pjesë në trajnime në lidhje me sigurimin biologjik, ndërkohë që 47.1% kanë deklaruar se jo por që e shihnin të rëndësishme të merrnin pjesë në një të tillë.

➤ **Paraqitja grafike e infermierëve pjesëmarrës në këtë pyetësor sipas pavionit**


Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun e mëposhtëm marrim informacion se 20% e infermierëve u përzgjedhën në pavionin e urgjencës, 8.6% në ORL, 18.6% punojnë në repartin e kirurgjisë, 20% e tyre janë pjesë e pediatriisë. Pjesa më e madhe e tyre përkatësisht 25.7% u përzgjedh në pavionin e patologjisë dhe vetëm 7.1% në infektiv.



Grafik 1 Paraqitja grafike e infermierëve pjesëmarrës në këtë pyetësor sipas pavionit

➤ **Paraqitja grafike e vlerësimit të gjinisë të personelit që ka plotësuar pyetësorin.**


Sipas të dhënave të grafikut të mëposhtëm marrim informacion se 80% e infermierëve i përkasin gjinisë femërore dhe vetëm 20% e tyre i përkasin gjinisë mashkullore.



Grafik 2 Paraqitje grafike e vlerësimit të gjinisë që kanë plotësuar pyetësorin.

➤ **Paraqitja tabelare dhe grafike e moshës së personelit që ka plotësuar pyetësorin**


Sipas të dhënave vlerësuese të paraqitura në grafik kemi të dhëna se infermierët që u bënë pjesë e këtij studimi u përkasin moshave të ndryshme. 12.9% ishin nën moshën 30 vjeç. 40% prej tyre i përkasin grupmoshës 31-40 vjeç dhe pjesa e mbetur 47.1% ishin mbi moshën 40 vjeç.



Grafik 3 Paraqitja grafike e vlerësimit të moshës që kanë plotësuar pyetësorin

➤ **Paraqitje tabelare dhe grafike e vlerësimit të eksperiencës në punë**


Rezultoni se 42.9% e infermierëve kishin deri në 10 vite përvojë pune ndërkohë që 57.1% kishin mbi 10 vite në punë.



Grafik 4 Paraqitja grafike e vlerësimit të eksperiencës në punë.

➤ **Keni shfaqur ndonjë sëmundje infektive për shkak të profesionit?**


Sipas rezultateve të paraqitura më poshtë 61.4% e infermierëve të përzgjedhur për të realizuar këtë studim kanë deklaruar se ata nuk kanë shfaqur sëmundje infektive për shkak të profesionit të tyre.



Grafik5 Paraqitja grafike e shfaqjes së sëmundjeve infektive

- **Nëse jeni infektuar me çfarë lloj sëmundje?**


Nga rezultatet e paraqitura në grafikun e mëposhtëm kemi se 18.6% e infermierëve pretendojnë se janë prekur nga Covid- 19, 14.3% nga gripi dhe 5.7% nga probleme të lëkurës dermatitis.



Grafik 6 Paraqitje grafike e llojit të sëmundjes

- **Cila ka qenë arsyeja që jeni infektuar?**

24.3% e infermierëve deklarojnë se ata janë infektuar si pasojë e mungesës së mjeteve mbrojtëse. 14.3% nga puna e tejkzgatur , lodhja. 14.3% nga mungesa e rregullit dhe 8.6% nga mjetet e punës difektoze. Më poshtë kemi paraqitjen grafike.



Grafik 7 Paraqitje grafike e Arsyes së infektimit

Në vazhdim do të shikojmë nëse ndikon eksperiencia në punë në informacionin që zotërojnë infermierët në lidhje me masat e biosigurisë.

Analiza Chi-Square

Tavola di contingenza barrierat mbrojtëse të biosigurisë: * eksperiencia në punë				
Conteggio		eksperiencia në punë		Totale
		1- 10 vjet	mbi 10 vjet	
barrierat mbrojtëse të biosigurisë:	mbrojtëse kepucësh, maske, syze , dorashka, mbajtëse flokes, perparese	19	34	53
	dorashka, maske perparese	11	6	17
Totale		30	40	70
Chi- Square		Valore	gl	Significativit a bilaterale
		4.377*	1	,030

Table 1 Paraqitje tabelore e analizave statistikore

Sipas të dhënave të tabelës shikojmë se pjesa më e madhe e atyre infermierëve që ka në eksperiencë pune mbi 10 vite zotërojnë informacion se kush përfshihet te barrierat mbrojtëse të biosigurisë.


Analiza statistikore Chi- square nëpërmjet të dhënave ku vlera e testit statistikor është 4.377 dhe niveli i rëndësisë $p = 0.05$ Në këtë test p - value është $p = 0.03$. Kur vlera e $p < 0.05$ do të thotë se mes variablave ka një lidhje statistikisht të rëndësishme.

Ky interpretim na lë të kuptojmë se përvoja në punë ndikon në informacionin që zotërojnë infermierët në lidhje me masat e biosigurisë.

- Më poshtë do të shohim si janë përgjigjur infermierët mbi arsyet e përdorimit të masave të biosigurisë sipas nivelit arsimor

Ajo që vihet re është se ata që besojnë se janë të gjitha arsyet e cila është dhe përgjigja e saktë kanë përfunduar dhe ciklin master.


A barre sovrapposto Conteggio di cila mendoni ju se është arsyeja kryesore që duhet të përdorim masat e sigurisë? per niveli arsimor



Grafik 8 Paraqitje grafike e shpërndarjes së arsyeve sipas nivelit spitalor

- **A keni marrë ndonjë trajnim paraprak për sigurimin biologjik?**

Sic do të vëmë re në grafikun e mëposhtëm 52.9% e infermierëve kanë marrë pjesë në trajnime në lidhje me sigurimin biologjik, ndërkohë që 47.1% kanë deklaruar se jo.




Grafik 9 Paraqitja grafike e pjesëmarrjes ne trajnime

- **Nëse po sa kohë më parë**

Ata infermierë të cilët kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në trajnim deklarojnë se 30% e tyre i kanë


zhvilluar katër vitet e fundit. 15.7% dy vitet e fundit dhe 7.1% në vitin e fundit. Më poshtë paraqitet grafiku me rezultatet.



Grafik 10 Paraqitje grafike e periudhës së trajnimit

- **Sa herë në turn përdorni elementet e mbrojtjes personale?**


Sic shohim nga rezultatet e paraqitura më poshtë 52.6% e infermierëve kanë deklaruar se mbi 6 herë në turn përdorin elementet e mbrojtjes personale. 30% e bëjnë këtë gjë 4-6 herë. 12.9% vetëm 2-4 herë dhe 4.3% vetëm një herë.



Grafik 11 Paraqitje grafike e shpeshtësisë së përdorimit të elementeve mbrojtëse

- **Duke marrë në momentin e parë një informacion se cili është turni që infermierët punojnë më shpesh do të shikojmë sesi ndikon ai në frekuencën e përdorimit të elementeve mbrojtëse.**

Një gjetje shumë interesante është se ata që punojnë më shpesh turni i natës pohojnë se i përdorin elementet e mbrojtjes personale vetëm një herë e cila mund të lidhet dhe me faktin se jo shumë pacientë kanë nevojë për përkujdesje natën.



Grafik 12 Paraqitje grafike e përdorimit të elementeve mbrojtëse sipas turnit

➤ **Cilat elemente të mbrojtjes personale përdorni më shumë?**


80% e tyre që përbejnë dhe pjesën më të madhe të kampionit përdorin më tepër dorezat



Grafik 13 Paraqitje grafike e përdorimit të elementeve mbrojtëse

➤ **Kur e kryeni hedhjen e mbeturinave spitalore?**

87.1% e kryejnë hedhjen e mbeturinave spitalore pas përfundimit të procedurës,



Grafik 14 Paraqitje tabelare e hedhjes së mbetjeve spitalore

Diskutime

Biosiguria është një hallkë shumë e rëndësishme në fushën e shëndetësisë, jo vetëm për shkak të kostove ekonomike që përfshihen, por edhe për shkak të kostove të jetës që mund të shkaktohen nga mungesa e masave të biosigurisë. Qëllimi i studimit ishte të analizonte njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e personelit infermieror në Spitalin Rajonal Vlorë lidhur me përdorimin e masave të biosigurisë, me qëllim identifikimin e niveleve të ndërgjegjësimit dhe përgatitjes së tyre për parandalimin e infeksioneve spitalore dhe të identifikojë faktorët dhe barrierat që ndikojnë në zbatimin efektiv të masave të biosigurisë nga personeli infermieror në Spitalin Rajonal Vlorë, duke ofruar rekomandime dhe strategji për përmirësimin e praktikave të biosigurisë dhe rritjen e sigurisë shëndetësore në këtë institucion

Rezultatet treguan se në këtë studim morën pjesë 70 infermierë nga të cilët vetëm 38.6% kanë shfaqur sëmundje infektive si pasojë e profesionit një numër ky I ulët krahasuar me studime të ngjashme të kryera në Spanjë ku numri I infermierëve të infektuar ishin 40.4%. Vihet re se shkaku kryesor I infektimit ka qenë mungesa e materialit mbrojtës me 24.3% ndjekur nga lodhja me 14.3% dhe me pas mungesa e rregullit me 14.3%.

Gjithashtu shohim se 75.7% e infermierëve janë në dijeni të barrierave fizike të biosigurisë të cilat duhet të zbatohen për të mbrojtur veten dhe pacientët krahasuar me numrin prej 60% te infermierëve ne Spanjë.^[37]

Vëmë re se 87.1% e infermierëve janë në dijeni të mënyrës së duhur së hedhjes së mbeturinave spitalore krahasuar me 80% të infermierëve në Peru.^[37]

Mënyra më e përdorur e larjes së duarve është ajo antiseptike me 60% të infirmierëve.

52.6% e infirmierëve kanë deklaruar se mbi 6 herë në turn përdorin elementet e mbrojtjes personale krahasuar me 37.7% të personelit në Peru krahasuar dhe me 11% të cilët nuk i përdorin kurrë në Spanjë.^{[32][6]}

Ajo që të bën përshtypje është se të gjithë infirmierët e pavionit të kirurgjisë e shikojnë si shumë të rëndësishme dhe të nevojshme pjesëmarrjen në trajnime në krahasim me Spanjën ku më të rëndësishme si proces e vinte re personeli i pediatriës.^[6]

Rekomandime

Masat e biosigurisë luajnë një rol shumë të rëndësishëm në profesionin tonë. Më poshtë paraqiten disa rekomandime: Raportoni menjëherë çdo incident ose shkelje të masave të biosigurisë. Merrni pjesë në trajnime të rregullta mbi biosigurinë dhe parandalimin e infeksioneve. Informoni dhe edukoni pacientët dhe vizitorët mbi praktikën e biosigurisë. Menaxhoni dhe hidhni mbeturinat mjekësore dhe materialet e tjera të rrezikshme në mënyrë të sigurt. Pastroni dhe dezinfektoni rregullisht të gjitha sipërfaqet dhe pajisjet mjekësore që janë në kontakt me pacientët. Përdorni produkte dezinfektuese të aprovuara dhe ndiqni udhëzimet për përdorim të sigurt. Sigurohuni që të gjitha pajisjet mbrojtëse të përdoren dhe të hidhen siç duhet pas përdorimit. Lani dhe dezinfektoni duart rregullisht para dhe pas çdo kontakti me pacientët. Përdorni sapun dhe ujë ose një dezinfektues duarsh me bazë alkooli.

Referencat:

1. Louise Brown, Julianne Munro and Suzy Rogers (2019) "Use of personal protective equipment in nursing practice" *Scientific article* 34(5):59-66
DOI: [10.7748/ns.2019.e11260](https://doi.org/10.7748/ns.2019.e11260)
PMID: 31468815
2. Tahar Bajjou, Khalid Ennibi, Idriss Lahlou Amine, (2020) "Role of Training and Experience in Biosafety Practices Among Nurses Working in Level 2 or 3 Patient Containment" 96-103
doi: [10.1177/1535676019899506](https://doi.org/10.1177/1535676019899506)
PMID: [36035083](https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/36035083/)
3. Becerra N. (2016) *Escuela de Ciencias de la Salud, Enfermería: "Aplicación de las normas de bioseguridad de los profesionales de*

enfermería" 30-33 18(1):29
DOI: [10.18633/bt.v18i1.225](https://doi.org/10.18633/bt.v18i1.225)

4. Maria Alejandra Criollo (2020) "Principios de la Bioseguridad en Enfermería" <https://www.slideshare.net/slideshow/principios-de-la-bioseguridad-en-enfermeria-epp/239282296%20%20%202020> 24 Prill 2024
5. Vaccines/Nurses 24 Prill 2024
<https://www.nursingworld.org/practice-policy/work-environment/health-safety/immunize/vaccines/>
6. Puertas M, Normas de bioseguridad del personal de enfermería en prevención de infecciones nosocomiales unidad de medicina, universidad Centro Occidental Lisandro Alvarado UCLA (Venezuela).
<http://bibmed.ucla.edu.ve/DB/bmucla/edocs/textocompleto/TIEWY16DV4A732011.pdf> 24 Prill 2024
7. Manuali I biosigurisë OSH.
https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/42981/9241546506_alb.pdf?sequence=2&isAllowed=y 23 Prill 2024
8. La OMS pide "5 momentos" para la higiene de manos colegio oficial de enfermería de Huesca (2018)
<https://www.colegioenfermeriahuesca.org/higiene-manos-2018/> 30 Prill 2024
9. A. Prüss, E. Giroult, P. Rushbrook "Safe management of wastes from health-care activities" 2-27
<https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/42175/9241545259.pdf?sequence=1> 30 Prill 2024
10. ICRC "Medical waste management" <https://www.icrc.org/eng/assets/files/publications/icrc-002-4032.pdf> 1 Maj 2024
11. Water Sanitation
http://www.who.int/watersanitation_health/healthcare_waste/module6.pdf?ua=1 1 Maj 2024
12. Australian Government "Guidance for the Selection and Use of Personal Protective Equipment (PPE) in Healthcare Settings" (2022)
<https://www.health.gov.au/sites/default/files/2022-12/guidance-on-the-use-of-personal-protective-equipment-ppe-for-health-care-workers-in-the-context-of-covid-19.pdf> 7 Maj 2024
13. Ducl G, Ginebra, Suiza, Bernard C, Organización Mundial de la Salud (OMS) -

- Estados Unidos para el Desarrollo Internacional (USAID). Prevención de las infecciones Nosocomiales GUÍA PRÁCTICA 2a edición,
<http://sanitariacarbula1.blogspot.com/2008/02/infecciones-nosocomiales.html> 7 Maj 2024
14. Menaxhimi i mbetjeve spitalore dhe përdorimi i masave të biosigurisë në Spitalin Rajonal Vlorë Dr. Denada Selfo BULETINI SHKENCOR REALD Numër 2, Vëllimi 1, 2015, ISSN 2411-5592
 15. How improperly disposed of medical waste is putting everyone at risk biomedical waste service (2023)
<https://allpointsmedicalwaste.com/the-dangers-of-improper-medical-waste-disposal/#:~:text=Improper%20disposal%20of%20medical%20waste.affect%20the%20foods%20we%20eat> 7 Maj 2024
 16. Prüss-Üstün, A., Emmanuel, J., Stringer, R., Pieper, U., Townend, W., Wilburn, S., & Chantier, Y. (2014). Safe management of wastes from health-care. World Health Organization
 17. Anna Sikora; Farah Zahra. (2024) "Nosocomial infections" PMID: 32644738 Bookshelf ID: NBK559312
 18. Bennett & Brachman, Jarvis W.2024 "Infecciones hospitalarias" ISBN/ISSN: 9788419663290
 19. B.Moraes "An assessment on the level of knowledge of biosecurity measures in the academic environment" DOI:10.1007/978-3-319-41652-6_20
 20. Uso de dispositivos de bioseguridad en enfermería: análisis de un cambio cultural <https://dialnet.unirioja.es/servlet/articulo?codigo=6817413> Revista Enfermería ISSN-e 2174-2510, Vol. 8, Nº. 2, 2018, págs. 62-71
 21. Manual de bioseguridad universidad industrial de Santader(2020)
https://uis.edu.co/wp-content/uploads/2022/06/resolucionUIS662_compressed.pdf
 22. Faqja zyrtare e Spitalit Rajonal Vlorë <https://www.spitalirajonalvlore.gov.al/reparatet/urgjenca> 10 Maj 2024
 23. "CDC/NHSN surveillance definitions for specific types of infections"(2024)
https://www.cdc.gov/nhsn/pdfs/pscmanual/17pscnosindef_current.pdf 10 Maj 2024
 24. Normas de bioseguridad https://www.researchgate.net/publication/299518536_NORMAS_DE_BIOSEGURIDAD_DEL_PERSONAL_DE_ENFERMERIA_EN_UNA_INSTITUCION_HOSPITALARIA 10 Maj 2024
 25. Sidorela Pulaj 2020 Kujdesi infermieror në menaxhimin e infeksioneve intrahospitalore DOI 10.33107/ubt-etd.2020.2514
 26. Medical assisting, Booth, Wayhman, Whacker ISBN-101259197743
 27. Safe management of wastes from health-care activities
<http://apps.who.int/iris/handle/10665/85349> 15 Maj 2024
 28. A.Pruss, E.Giroult, P.Rushbrook,"Safe Management of Waste from Health-Care activities", Gjenev 1999, ISBN 92 4 154525 9, faqe nr.148, 149, 152
 29. Royal College of Nursing, "Good practice in infection prevention and control", Londër, faqe nr.2, 3, 10.
 30. Workplace, safety + health profile, Ministry of Manpower, Singapore,
http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/--asia/--ro-bangkok/--srobangkok/documents/policy/wcms_208348.pdf 15 Maj 2024
 31. Seminar-trajnuet "Menaxhimi I mbetjeve spitalore dhe ndikimi I rreziqeve profesionale ne mirëqenie" Dr. Denada Selfo. ISBN: ISBN 978-9928-4470-4-3
 32. Ramirez: Medidas de seguridad fq:60-66.
 33. Chao Wu"The biosafety incident response competence scale for clinical nursing staff: a development and validation study"(2024) DOI:10.1186/s12912-024-01848-6
 34. Gustavo Baade de Andrade; Juliana Marques Weykamp; Diana Cecagno;(2017) "Biosafety: risk factors enhanced by the nurse in their work" DOI:10.9789/2175-5361.2018.v10i2.565-571
 35. Magdalena Castro MSc "La enfermería y la investigación: Nursing and research" Volume 29, Issue 3, May-June 2018, Pages 301-310 <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0716864018300531> 15 Maj 2024
 36. Allison T. Chamberlain, LouAnn C. Burnett "Biosafety training and incident-reporting practices in the United States: A survey of biosafety professionals"

37. *Sherbimi I kujdesit mjedisor*
https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/pa00jw7x.pdf
16 Maj 2024
38. *Diana Leonor Uceda Ochoaa, Mónica Elisa Meneses La Rivab(2020) "Healthcare-associated infection control and biosecurity measures for nurses in the emergency department of a National Essalud Hospital"*
DOI:10.32829/ghmj.v4i1.185
39. *Best practices for injection*
<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK138495/> 16 Maj 2024

REZISTENCA NDAJ ANTIBIOTIKËVE TEK FËMIJËT E VEGJËL DHE VLERËSIMI I NJOHURIVE INFERMIERORE RRETH SAJ

Iris Bellaj, Denada Selfo¹, Entela Idrizaj²

bellaj.iris02@gmail.com

¹ Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti Ismail Qemali, Vlorë Albania
denadaselfo@yahoo.com/denada.selfo@univlora.edu.al

² Fakulteti i shkencave mjekësore, Universiteti Aleksandër.Xhuvani, Elbasan Albania

Abstrakti

Hyrje: Rezistenca ndaj antibiotikëve është një kërcënim i rëndësishëm për shëndetin publik dhe një krizë gjithënjë e më në zhvillim si në nivele kombëtare dhe global, sidomos tek fëmijët e vegjël. Ky fenomen tanimë në rritje kërkon një bashkëpunim në nivele ndërkomëbare si dhe pasjen e një stafi të mirë informuar dhe të trajnuar. **Qëllimi i këtij studimi:** analizimi dhe studimi i dukurisë së antibiotiko-rezistencës tek fëmijët e vegjël si dhe vlerësimi njohurive të stafit infermieror mbi antibiotiko-rezistencën në Spitali Rajonal Vlorë Pavioni Pediarti. **Materialet dhe metodologjia:** Ky është një studim kross-seksional diskriptiv. **Rezultate:** Në luftën kundër antibiotiko-rezistencës shtete të ndryshme kanë realizuar kërkime të ndryshme nga ku zbuluam se në botë 1 në 4 fëmijë marrin antibiotikë të përkohshëm në mënyrë të gabuar [1]; në janar 2024 është zbuluar versioni më të fortë dhe më infektiv i ST410 CREC, 'B5/H24RxC [2]; u njohëm me WAAW [3]; si dhe mënyrat për identifikimin, menaxhimin apo parandalimin e antibiotiko-rezistencës. Gjithashtu në studimin tonë mbi bazën e tabelave dhe grafikëve të nxjerra na rezultoi se ekziston një lidhje mjaft e fortë mbi lidhjen midis viteve të eksperiencës në punë dhe njohurive infermierore. **Konkluzione:** Do të rekomandoja:

- ✓ Zhvillimi i protokolleve të reja për përmirësimin e situatës në lidhje me përdorimin e medikamenteve.
- ✓ Përfshirja e kurseve special në kurrikulën e infermierisë në shkolla dhe kolegjet për të përmirësuar rolin klinik të infermierëve në lidhje me përdorimin dhe rezistencën e antibiotikëve.

Fjalë kyçe: antibiotikët, antibiotiko-rezistenca, fëmijët e vegjël, stafi infermieror, njohuri.

Abstract

Introduction: Antibiotic resistance is a significant threat to public health and an ever-growing crisis both at the national and global levels, especially among young children. This already growing phenomenon requires cooperation at international levels as well as having a well-informed and trained staff. **The purpose of this study:** to analyze and study the phenomenon of antibiotic resistance in young children, as well as to evaluate the knowledge of the nursing staff on antibiotic resistance in the Vlorë Regional Hospital, Pediatrics Pavilion. **Materials and methodology:** This is a descriptive cross-sectional study. **Results:** In the fight against antibiotic-resistance, different countries have carried out different researches from which we discovered that in the world 1 in 4 children receive antibiotics prescribed incorrectly [1]; in January 2024 was discovered the strongest and most infectious version of ST410 CREC, 'B5/H24RxC [2]; we got to know WAAW [3]; as well as ways to identify, manage or prevent antibiotic-resistance. Also, in our study, based on the tables and graphs, we found that there is a strong relationship between years of work experience and nursing knowledge.

Conclusions: I would recommend:

- ✓ Development of new protocols to improve the situation related to the use of medications.
- ✓ Inclusion of special courses in the nursing curriculum in schools and

colleges to improve the clinical role of nurses regarding the use and resistance of antibiotics.

Keywords: antibiotics, antibiotic resistance, young children, nursing staff, knowledge.

Hyrje:

Antibiotiko-rezistenca është një nga sfidat më të mëdha të shëndetit publik të kohës sonë sidomos kur bëhet fjala për fëmijët.

Kjo gjendje problematike në të tashmen, përbën një kërcënim akoma më të madhë për të ardhmen tonë dhe lidhet me shkaqe të ndryshme dhe të ndërlydhura. Edhe pse Alexander Fleming kishte paralajmëruar komunitetin shkencor dhe mjekësor në lidhje me përdorimin e tepërt të antibiotikëve në vitin 1945, përsëri, një epokë e abuzimit me antibiotikë në bujqësi, blegtori, veterinare dhe praktikant mjekësore njerëzore filloi pas Luftës së Dytë Botërore. Ky abuzim ishte shtytësi kryesor i evolucionit të rezistencës në baktere [4].

Mbipërdorimet apo keqpërdorimet problematike të antibiotikëve, diagnozat joadekuate, indikacionet e gabuara, apo dhe dozat e gabuara, nxitur gjithashtu edhe nga mungesa e të dhënave dhe provave specifike ndaj fëmijëve të vegjël kontribuan në zhvillimin e këtij fenomeni.

Gjithashtu, natyra gjithnjë në zhvillim e kësaj grupmoshe shtron gjithashtu një çështje tjetër, vështirësinë për të kodifikuar lehtësisht moshën ose peshën, pra gjetjen e një dozë të saktë për fëmijën. Kjo popullatë penalizohet gjithashtu nga kundërlidhjet e tetraciklinave dhe fluorokinoloneve dhe nga keqformimet kongjenitale të cilat shpesh kërkojnë shtrime të përsëritura në spital dhe trajtime farmakologjike dhe kirurgjikale që në moshë shumë të re. [5]

Një studim i fundit nga Universiteti i Sidneit zbuloi se shumë nga antibiotikët e testuar kishin më pak se 50% efektivitet. Kjo i atribuohet rezistencës ndaj antibiotikëve, që do të thotë se bakteret nuk i përgjigjen më trajtimit me antibiotikë. Në mbarë botën, rezistenca ndaj antibiotikëve ka qenë në rritje për 15 vitet e fundit. Megjithatë, trajtime të reja dhe efektive nuk janë zhvilluar ende [6]

Antibiotiku më i ri u zhvillua në vitet 1980 dhe asnjë klasë tjetër e re antibiotikësh nuk është

zhvilluar që atëherë. Prandaj, sot ne jemi në një garë me kohën, ku sa më shumë të varem nga ata antibiotikë, aq më shumë ka të ngjarë të gjejmë baktere që kanë zhvilluar mekanizma për t'u mbrojtur kundër këtyre antibiotikëve[7]

Materialet dhe metodologjia:

Ky është një studim cross-sectional diskriptiv, i cili është realizuar në stafin infermieror të Spitalit Rajonal të qytetit të Vlorës, Pavioni Pediatri përgjatë periudhës Mars – Qershor 2024 ku si instrument matës është përdorur instrumenti "Pyetësor mbi vlerësimin e njohurive infermiere mbi antibiotiko-rezistencën".

Pyetësori përbëhet prej 21 pikash dhe është i vetëstrukturuar dhe i vetadministruar, duke u bazuar dhe mbi studime të tjera ndërkombëtare lidhur me temën, si dhe ruan anonimitetin e plotësuesve të tij.

Në total pyetësori është plotësuar prej 30 infermiera nga 30, pra ka pasur një bashkëpunim 100% nga ana e stafit në plotësimin e tij. Të dhënat e fituara më pas janë paraqitur përmes tabelave dhe grafikëve dhe janë përfutur nëpërmjet analizave statistikore me programin SPSS 20.

Tema përfshin informacione të ndryshme në lidhje me antibiotiko – rezistencën tek fëmijët e vegjël (kryesisht grupmosha 2 - 6 vjeç), studime shkencore të huaja në lidhje me të si dhe informacione të tjera të cilat janë siguruar nëpërmjet faqeve me informacionet më të reja dhe të sigurta në literaturë të ndryshme, të shënuara me referenca.

Antibiotiko- rezistenca është një fenomen që ndodh kur bakteret evoluojnë dhe zhvillojnë rezistencë ndaj antibiotikëve që janë krijuar për t'i luftuar ato. Ajo mund të jetë natyrale ose e fituar. Bakteret natyrisht bëhen rezistente ndaj ilaçeve me kalimin e kohës. Por ekzistojnë gjithashtu disa faktorë mund ta përshpejtojnë procesin, ku mund të përmendim:

- Keqpërdorimi apo përdorimi i tepërt i antibiotikëve.
- Rezistenca spontane apo e transmetuar.
- Diagnostifikimi joadekuat dhe qëndrimi i gjatë spitalor
- Përdorimi i antibiotikëve në bujqësi.
- Mutacioni i bakterit.
- Faktorët e ndryshëm socio-ekonomik dhe sjellja.

Gjithashtu ja vlen të përmendim se këta faktorë duke qenë se janë "të ndërlidhur" me mekanizmin e antibiotiko-rezistencës, kanë bërë që këtë të fundit tanimë ta kategorizojmë në katër grupe kryeore:

1. Rezistenca e brendshme: Bakteret mund t'i mbijetojnë një antibiotiku për shkak të rezistencës së brendshme përmes evolucionit duke ndryshuar strukturën ose përbërësit e tyre.
2. Rezistenca e fituar: Bakteret mund të fitojnë aftësinë për t'i rezistuar aktivitetit të një agjenti të veçantë antimikrobik ndaj të cilit ishin më parë të ndjeshëm (p.sh. mund të përmendim rezistencën e Mycobacterium tuberculosis ndaj rifamicinës.)
3. Ndryshimi gjenetik: ADN-ja e baktereve mund të ndryshojë dhe të shkaktojë ndryshimin në prodhimin e proteinave, duke çuar në komponentë dhe receptorë të ndryshëm bakterialë që i bëjnë bakteret të panjohura nga antibiotiku (p.sh. Escherichia coli (E. coli) dhe Haemophilus influenza rezistenca ndaj trimetoprimidit.)
4. Transferimi i ADN-së: Bakteret mund të ndajnë përbërës gjenetikë me baktere të tjera dhe të transferojnë ADN-në rezistente përmes një transferimi horizontal të gjenit.^[8]

Nga ana tjetër faktorët e lartpërmendur dhe dozimet **[Fig. 1]** joadekuate tek fëmijët ka bërë që një grup specifik bakteresh të jenë më rezistente.

Mënyra 1. (Oral)	Mënyra 2. (Injektim IV)	Mënyra 3. (Infuzion IV)
Hapi 1. Shndërroni kilogramët në kg	Hapi 1. Llogaritni dozën në mg	Hapi 1. Shndërroni kilogramët në kg
Hapi 2. Llogaritni dozën në mg	Hapi 2. Ndani dozën me frekuencën	Hapi 2. Llogaritni BSA: $\sqrt{\text{kg} \times 97 \text{ cm}/3600}$
Hapi 3. Ndani dozën me frekuencën	Hapi 3. Konvertoni dozën e mg në ml	Hapi 3. Llogaritni dozën në mg
Hapi 4. Konvertoni dozën e mg në ml		Hapi 4. Llogaritni dozën në ml

Fig. 1 Skeme dozimit adekuate tek fëmijët.^[9]

Në listën e baktereve që shfaqin më tepër rezistencë tek fëmijët mund të përmendim:

- Staphylococcus aureus,
- Streptococcus Pneumonia,
- Enterokokët,

- Clostridioides difficile,
- Carbapenem-Rezistent Enterobacteriaceae (CRE),
- Escherichia coli,
- Acinetobakter.

Çfarë duhet të kemi parasysh për parandalim

A. Si qytetar:

1. Parandaloni infeksionet duke larë rregullisht duart dhe duke u përditësuar me vaksinat.
2. Parandaloni infeksionet e shkaktuara nga ushqimi duke larë frutat dhe perimet dhe duke gatuar siç duhet ushqimin.^[10]
3. Pyesni mjekun tuaj pse fëmija juaj ka ose nuk ka nevojë për antibiotikë. Nëse mjeku i fëmijës beson se fëmija nuk do të ndihmohet nga antibiotikët, ka një arsye të mirë për vendimin për të mos i dhënë ato. Asnjëherë mos i bëni presion mjekut për antibiotikë. Në vend të kësaj, kërkoni trajtimin më të mirë për sëmundjen e fëmijës suaj ^[11], si dhe për mënyra të tjera për të lehtësuar simptomat ^[12].
4. Duhet pasuar parasysh se antibiotikët janë efektivë vetëm kundër infeksioneve bakteriale prandaj ^[13] nuk duhet t'i jepni fëmijës antibiotikë për:
 - Ftohje,
 - Grip,
 - Dhimbjet e fytyrës të cilat nuk shkaktohen nga streptococcus,
 - Rrjedhje nga hundët,
 - Në dhimbje veshi.
5. Asnjëherë mos i jepni fëmijës antibiotikë të përshkruar për të tjerët.
6. Mos ndani kurrë antibiotikët me të tjerët ^[14].
7. Mos përdorni paketat e vjetra të antibiotikëve për një infuzion të ri.
8. Ndiqni gjithmonë dozën dhe udhëzimet e përshkruara nga mjeku dhe farmacisti juaj – kjo përfshin sasinë e duhur dhe në kohën e duhur ^[13].
9. Përfundoni mjekimin edhe nëse ndiheni më mirë. Nëse e ndërprisni trajtimin shumë shpejt, disa baktere mund të mbijetojnë dhe t'ju riinfektojnë ^[15].
10. Përdorni antibiotikët natyral kur është e mundur për parandalimin e infeksioneve.

B. Si staf shëndetësor:

Infermierët luajnë një rol kyç në luftën ndaj antibiotiko-rezistencës duke:

1. Ndhimuar në reduktimin e përdorimit të panevojshëm dhe të papërshtatshëm të antibiotikëve.
2. Promovuar dhe praktikuar kontrollin të mirë të infeksioneve.
3. Edukuar e pacientëve dhe publikut të gjerë për çështjen dhe gjërat që njerëzit mund të bëjnë për të parandaluar përkeqësimin e tij.
4. Promovuar dhe praktikuar i masave parandaluese standarde, duke përfshirë larjen e duarve dhe masa të tjera të kontrollit të infeksionit.
5. Njohur shenjat dhe simptomat e infeksionit.
6. Filluar vlerësimin dhe rishikimin klinik.
7. Siguruar që ekzemplarët në kohë për mikrobiologji të janë mbledhur në mënyrë korrekte.
8. Promovuar përdorimin e udhëzimeve për receta.
9. Ofruar informacion dhe mbështetj për pacientët dhe familjet e tyre për shëndetin e tyre, gjendjen, opsionet e trajtimit dhe si dhe pse të merrin ilaçe sipas udhëzimit e mjekut.
10. Administrimin dhe menaxhimin e medikamenteve.
11. Siguruar se trajtimet janë regjistruar siç duhet në kartelën shëndetësore të pacientit.^[16]

Për të vlerësuar nivelin e njohurive të stafit infermieror mbi antibiotiko-rezistencën është realizuar pyetësori, i cili ndodhet i paraqitur në fund të artikullit. Me anë të këtij pyetësori kemi bërë të mundur vërtetimin e hipotezës: “Stafi infermieror me më vite eksperiencë pune është më i informuar dhe përgatitur ndaj antibiotiko – rezistencës sesa stafi më i ri me më pak vite punë.” si dhe kemi arritur në konkluzionet e mëposhtëme.

Konkluzione:

Studimi i kryer në stafin infermieror të Spitalit Rajonal të qytetit të Vlorës Pavioni Pediatri arriti në këto konkluzione:

- 50% e infermierëvei përkasin grupmoshës 38-47 vjeç, 53.3% janë me master shkencor, 40% kanë 11-15 vite punë eksperiencë.

- Në studim në total 76.7% deklaruan se kanë dëgjuar për antibiotiko- rezistencën ku dhe 76.7% e infermierëve pohuan se antibiotiko- rezistenca ndikon në shëndetin e përgjithshëm të një individi; 63.3% shprehën se antibiotikët nuk mund të kurojnë infeksionet virale; 70% e infermierëve ishin të mendimit se përdorimi i antibiotikëve në grip dhe ftomë nuk e përshpejton kohën e shërimit; 76.7% ishin dakord me shprehjen se antibiotikët mund të kurojnë infeksionet bakteriale; 53.5% e infermierëve shprehën pasiguri në lidhje me antibiotikët e rinj duke mos e ditur nëse ata janë më efikas se të tjerët; 46.7% pohuan se ata nuk e rekomandojnë ndalimin e antibiotikut pas shërimit të simptomave.

Fig. 2 Crosstabulim mbi lidhjen midis


	niveli i studimeve			Totale
	bachelor	master profesional	master shkencor	
a mendoni se antibiotiko-po rezistenca është kthyer në një jo problem madhor?				
nuk jam i/e sigurt	1	4	13	18
	5	0	0	5
Totale	6	8	16	30

Eksperienca në punë dhe Shndërimi në problem madhor.

- Pjesa më e madhe e personelit infermieror që e konsideron antibiotiko-rezistenën një problem madhor zotëron nivelin master shkencor (18 veta). Në table e figuruar më lart shohim gjithashtu se pjesa më e pak informuar i takon infermierëve vetëm me bachelor.
- Nga studimi shohim se sipas pjesës më të madhe të infermierëve keqpërdorimi i antibiotikëve është një nga faktorët që ka ndikuar në antibiotiko- rezistencë.
- Sipas infermierëve të pavionit të pediatriisë janë të ndryshëm faktorët të cilët mund të çojnë në antibiotiko-rezistencë ku ndër faktorët më kryesor u renditën:
 - 36.6% mos marrja e antibiotikëve sipas mënyrës së rekomanduar nga mjeku.

- 26.7% marrja nga ana e prindërve të fëmijës e antibiotikëve nga dikush tjetër përveç punonjësve shëndetsor.
 - 16.7% përdorimi e shpeshtë të antibiotikëve.
- 63.3% e infermierëve janë të informuar mbi WAAW dhe pse vetëm 36.3% e tyre kanë marrë pjesë në trajnime [Fig. 3].

Fig. 3 Krahasimi midis nivelit të studimeve dhe pjesëmarrjes në trajnime.



- Infermierët të cilët kanë marrë pjesë në trajnime kanë deklaruar se:
- 26.7% (ose 72.7% në bazë të grafikut) e tyre i kanë zhvilluar këto trajnime 2 vitet e fundit,
 - 6.7% (ose 18.2% në bazë të grafikut) vitin e fundit
 - 3.3% (ose 9.1 në bazë të grafikut) në 4 vitet e fundit

(Këtu bëjnë pjesë 8 veta me master shkencor dhe 3 veta me master profesional.)

- Nëpërfjet analizave statistikore Chi-square të realizuara mbi "Lidhja midis Eksperiencia në punë dhe Informimi mbi antibiotiko- rezistencën" [Fig. 4] si dhe "Lidhja midis Eksperiencia në punë dhe Keqpërdorimi i antibiotikëve" [Fig. 5] vumë re se me një vlerë $p = 0.0$

Fig. 4 Lidhja midis Eksperiencia në punë dhe Informimi mbi antibiotiko- rezistencën.

eksperiencia ne pune		a keni degjuar ndonjehere per antibiotiko-rezistencen?			Totale
		po	jo	nuk jam i/e sigurt	
	1-5 vite	0	4	1	5
	6-10 vite	0	1	1	2
	11-15 vite	12	0	0	12
	mbi 15 vite	11	0	0	11
Totale		23	5	2	30
Chi- Square	Valore	gl	Significativita bilaterale		
		32,700 ^a	6	,000	

- Pjesa më e madhe e infermierëve që kanë njohuri mbi antibiotiko rezistencën kanë më tepër se 11 vite në punë (që do të thotë se vitet e eksperiencës në punë ndikojnë në njohuritë rreth antibiotiko - rezistencës).

Fig. 5 Lidhja midis Eksperiencia në punë dhe Keqpërdorimi i antibiotikëve.

Tavola di contingenza eksperiencia ne pune * A mendoni se keqpërdorimi është një nga faktorët kryesor që ka çuar në antibiotiko-rezistencë?

Conteggio

eksperiencia ne pune		a mendoni se keqpërdorimi eshte nje nga faktoret kryesor qe ka çuar ne antibiotiko-rezistence?			Totale
		po	jo	nuk jam i/e sigurt	
	1-5 vite	0	2	3	5
	6-10 vite	0	1	1	2
	11-15 vite	12	0	0	12
	mbi 15 vite	11	0	0	11
Totale		23	3	4	30
Chi- square	Valore	gl	Significativita bilaterale		
		30,250 ^a	6	,000	

Të dhënat të paraqitura në figurën 3 na dëshmojnë se ata infermierë të cilët nuk janë dakord që keqpërdorimi i antibiotikëve ka çuar në antibiotiko- rezistencë kanë më pak se 10 vite në punë.

- Pra eksperiencia ndikon në informacion e infermierëve mbi:
 - njohuritë mbi antibiotiko rezistencën
 - keqpërdorimin e antibiotikëve.

Në përfundim të këtij studimi bëjmë të mundur dhe verifikimin e hipotezës së ngritur.

Diskutime:

Nëse do të bënim një krahasim midis studimeve të bëra ndër vite (përkatësishtë Pakistan 2017^[17], Sri Lank 2019^[18] & Jordani 2022^[19]) dhe rezultaveve të studimit tonë do të vinim re se:

- Ndër vite në seksionin e kujdesit ndaj fëmijëve pjesën më të madhe të punonjësve e përbëjnë femrat të cilat i përkasin grupmoshës 28-47.
- Në krahasim me studimin e dy viteve më parë në Jordani^[19] rezultoni se stafi ynë infermieror ka një përqindje më të lartë njohurish të përgjithshme, ndonëse vetëm 26.7% e tyre kanë marrë pjesë në trajnime/konferenca në 2 vitet e fundit.
- Vumë re një rritje me 67.2% të ndërgjegjësimit të infemierëve përsa u përket faktorëve ndikues kryesor dhe lidhjes midis mënyrës së dhënies së antibiotikëve dhe antibiotiko - rezistencës, si dhe një rritje me 63.3% të ndërgjegjësimit të infemierëve në lidhje me rolin e tyre në përfshirjen kundër antibiotiko - rezistencës.
- Në krahasim me studimet ne vitet e mëparëshme në vënde më të zhvillura, stafi ynë infermieror pediatrik rezultoi me i informuar, ndonëse mund të themi se ka akoma boshëllëqe dhe nevojë për trajnime si informative dhe praktike, si për brezat e rinjë që po përgatiten të futen në punë e deri tek ata që janë gati për ta mbyll këtë profesion.
- Gjithashtu nuk duhet të anashkalojmë dhe rezultatin ku një rol të rëndësishëm prej 73.4% në shkaktimin e antibiotiko - rezistencës luajnë vet prindërit e fëmijëve, por kjo si temë i përketë një studimi të mëtejshëm

Rekomandime:

Antibiotiko - rezistenca tek fëmijët e vegjël është një gjëndje e rëndë me progres fatal nëse nuk kapet dot në kohë prandaj do të rekomandoja:

- ✓ Shtimin e edukimit klinik për t'u siguruar infemierëve përmirësimin praktikë ndaj këtij problemi në rritje.
- ✓ Përfshirja e kurseve special në kurrikulën e infemierisë në shkolla dhe kolegjet për të përmirësuar rolin klinik të infemierëve

në lidhje me përdorimin dhe rezistencën e antibiotikëve.

- ✓ Zhvillimi i protokolleve të reja për përmirësimin e situatës në lidhje me përdorimin e medikamenteve.
- ✓ Përfshirjen dhe trajnimin e prindërve nga ana e stafit shëndetësor përsa i përketë përdorimit të antibiotikëve dhe efekteve të tyre.

Bibliografia:

[1] Kristina Sauerwein, January 28, 2020, 1 in 4 kids who get antibiotics in children's hospitals are prescribed the drugs incorrectly, Washington university School of Medicine in St. Louis, marrë nga: < <https://medicine.wustl.edu/news/1-in-4-kids-who-get-antibiotics-in-childrens-hospitals-are-prescribed-the-drugs-incorrectly/> > [30 Maj 2024]

[2] University of Birmingham, January 31, 2024, New and highly infectious E. coli strain resistant to powerful antibiotics, ScienceDaily, marrë nga: < <https://www.sciencedaily.com/releases/2024/01/240131144448.htm> > [2 Maj 2024]

[3] World AMR Awareness Week, World Health Organization, marrë nga: < <https://www.who.int/campaigns/world-amr-awareness-week> > [3 Maj 2024]

[4] Alessandra Romandini, Arianna Pani, Paolo Andrea Schenardi, Giulia Angela Carla Pattarino, Costantino De Giacomo and Francesco Scaglione, Antibiotic Resistance in Pediatric Infections: Global Emerging Threats, Predicting the Near Future, MDPI marrë nga: < <https://www.mdpi.com/2079-6382/10/4/393> > [6 Maj 2024]

[5] Preeti Patel; Harrison R. Wermuth; Chara Calhoun; Gregory A. Hall, 2021, Antibiotic Resistance in Pediatric Infections: Global Emerging Threats, Predicting the Near Future, NIH, National Library of Medicine, National Center of Biotechnology Information, PubMed Central, marrë nga: < <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC8067449/> > [2 Maj 2024]

[6] Gudrun Heise, 11/17/2023, Antibiotic resistance in children on the rise, DW, marrë nga: <<https://www.dw.com/en/antibiotic-resistance-in-children-on-the-rise/a-67411523>> [29 Maj 2024]

[7] Katherine Leach-Kemon, Senior Content Strategist, October 24, 2023, Saving children from antibiotic-resistant infections, University of Washington School of Medicine, the Institute for Health Metrics and Evaluation (IHME) marrë nga: <<https://www.healthdata.org/news-events/insights-blog/acting-data/saving-children-antibiotic-resistant-infections>>, Dr. Gisela Robles Aguilar. Cit. [2 Maj 2024]

[8] Yacob Habboush; Nilmarie Guzman, June 20, 2023, Antibiotic Resistance, NIH, National Library of Medicine, National Center of Biotechnology Information, StatPearls [Internet], marrë nga: <<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK513277/>> [6 Maj 2024]

[9] Pediatric Dosage Calculations Davis's Drug Guide. Com, marrë nga: <https://www.drugguide.com/ddo/view/Davis-Drug-Guide/109514/all/Pediatric_Dosage_Calculations> [29 Maj 2024]

[10] 7 December 2022, Australian Government - General Public | Antimicrobial Resistance, marrë nga: <<https://www.amr.gov.au/what-you-can-do/general-public>> [2 Maj 2024]

[11] Nationwide Children's Hospital, Columbus, OH 43205, Antibiotic Resistance, NationWilde Children's, marrë nga: <<https://www.nationwidechildrens.org/family-resources-education/health-wellness-and-safety-resources/helping-hands/antibiotic-resistance>> [2 Maj 2024]

[12] Australian Government - General Public | Antimicrobial Resistance, marrë nga: <<https://www.amr.gov.au/what-you-can-do/general-public>> [2 Maj 2024]

[13] Dr Julia Clark | Director, Infection Management and Prevention Services, Queensland Government, Children's Health Queensland, Antibiotic resistance: what you need to know, marrë nga: <<https://www.childrens.health.qld.gov.au/about-us/news/feature-articles/antibiotic-resistance-what-you-need-to-know>> [21 Maj 2024]

[14] Antibiotic Resistance marrë nga: <<https://www.nationwidechildrens.org/family-resources-education/health-wellness-and-safety-resources/helping-hands/antibiotic-resistance>> [3 Maj 2024]

[15] Community Health, Biblioteka e Shëndetit siguroar nga Biblioteka Kombëtare e Mjekësisë (NLM), Rezistenca ndaj antibiotikëve - Shëndeti i Komunitetit, marrë nga: <<https://www.chcrr.org/sq/health-topic/antibiotic-resistance/>> [21 Maj 2024]

[16] Australian Government - Nurses and Antimicrobial Resistance (AMR), pdf, pg.1 marrë nga: <<https://www.amr.gov.au/sites/default/files/2022-10/nurses-and-antimicrobial-resistance-amr-fact-sheet.pdf>> [26 Maj 2024]

[17] M. Habib, F. Saleem, Q. Iqbal, S. Haider, Faculty of Pharmacy & Health Sciences, University of Balochistan, Quetta, 2017, INDO AMERICAN JOURNAL OF PHARMACEUTICAL SCIENCES, marrë nga: <<https://web.archive.org/web/20200113213701/https://zenodo.org/record/822444/files/44.Nurses%E2%80%99%20perception%20towards%20antibiotic%20use%20and%20resistance.pdf>> [16 Maj 2024]

[18] Mathanki Jayaweerasingham, Sacheera Angulmaduwa, and Veranja Liyanapathirana, 2019, Knowledge, beliefs and practices on antibiotic use and resistance among a group of trainee nurses in Sri Lanka, PubMed Central, marrë nga: <

<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC6751666/> > [26 Maj 2024]

[19] Sawsan Abuhammad, Hamza Ababneh, 2022, Department of Maternal and Child Health, Faculty of Nursing, Jordan University of Science and

Technology, Irbid, JORDAN, marrë nga: <
<https://www.ejgm.co.uk/download/nurses-knowledge-motivation-behaviors-and-information-sources-on-antibiotic-use-and-resistance-in-12571.pdf> > [2 Maj 2024]

Pyetësor mbi vlerësimin e njohurive infermierore mbi antibiotiko-rezistencën

Ky pyetësor ka për objektiv analizimin e njohurive infermierore mbi antibiotiko-rezistencës, është realizuar për qëllime akademike.

Ky studim është realizuar dhe në shumë vende të botës.

NUK DUHET TË SHËNONI EMRIN TUAJ në këtë pyetësor. Përgjigjet tuaja do të qëndrojnë anonime dhe askush nuk do të mund t'ju identifikojë.

Ju lutem, analizoni çdo pyetje, përgjigjuni me sinjeritet dhe sigurohuni që t'i keni lexuar të gjitha pyetjet. Vendosi një X tek kutia për çdo përgjigje tuajën.

TË DHËNAT PERSONALE DHE PROFESIONALE

1. Grupmosha:

- 22-27 38-47
 28-37 >47

2. Niveli i studimeve:

- Bachelor
 Master Shkencor
 Master Profesional

3. Vitet e eksperiencës në punë:

- 1-5 vite 6-10 vite
 11-15 vite Mbi 15 vite

4. Turni i punës: Vetëm paradite Vetëm mbasdite

- Vetëm natën Me tre turne

5. A keni dëgjuar ndonjëherë për antibiotiko-rezistencën?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

6. A mendoni se antibiotiko-rezistenca ndikon në shëndetin e përgjithshëm të pacientëve?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

7. A jeni dakord me shprehjen se antibiotikët mund të kurojnë infeksionet virale?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

8. A besoni se përdorimi i antibiotikëve në grip dhe ftohme përshpëjtonë kohën e shërimit?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

9. A jeni dakord me shprehjen se antibiotikët mund të kurojnë infeksionet bakteriale?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

10. A i konsideroni antibiotikët më të rinjë dhe më të kushtueshëm, më efikas se të tjerët?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

11. A e rekomandoni ndalimin e marrjes së antibiotikëve pas shërimit të simptomave?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

12. A mendoni se keqpërdorimi është një ndër faktorët kryesor që ka çuar në antibiotiko-rezistencë?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

13. Cilët nga faktorët e mëposhtëm mendoni se ndikon gjithashtu më shumë në shfaqjen e antibiotiko-rezistencës tek fëmijët?

- Përdorimi i shpeshtë i antibiotikëve
 Përdorimi në dozë më të ulët i antibiotikëve
 Mos mbajtja e higjenës së duhur të fëmijës.
 Mos marrja e antibiotikëve sipas mënyrës së rekomanduar nga mjeku.
 Qëndrimi i gjatë spitalor.
 Mos vaksinimi i fëmijës në datat e duhura.

- Ndarja nga ana e prindërve të fëmijës të antibiotikëve të fëmijës së tyre me të tjerë.
 Merrja nga ana e prindërve të fëmijës e antibiotikëve nga dikush tjetër përveç punonjësve shëndetësor.
 Përdorimi nga ana e prindërve të fëmijës i antibiotikëve të mbetur nga recetat e mëparshme.

14. A mendoni se antibiotiko-rezistenca është kthyer në një problem madhor?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

15. A mendoni se përfshirja e gjithë punonjësve të shëndetësisë është një opsion i mirë për minimizimin e antibiotiko-rezistencës?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

16. A keni dëgjuar për testin e antibiotiko-rezistencës?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

17. A i rekomandoni pacientët të pyesin mjekun për testin e sensibilitetit ndaj antibiotiko-rezistencës?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

18. A keni degjuar ndonjëherë për World AMR Awareness Week (Java Botërore e Ndërgjegjësimit për AMR)?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

19. Po ju, a keni marrë ndonjëherë pjesë në konferenca/trajtime lidhur me antibiotiko - rezistencën?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

Nëse po, sa kohë më parë;

- vitin e fundit 2 vitet e fundit 4 vitet e fundit

20. A e konsideroni bërjen e testit të antibiotiko-rezistencës një opsion të mirë në parandalimin e antibiotiko - rezistencës?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

21. A i konsideroni studimet e deri tanishme për antibiotiko-rezistencën të vërteta?

- Po S'jam i/e sigurt Jo

Ju faleminderit për kohën tuaj!

Farmakovigjilenca në Shqipëri: Situata aktuale dhe Përafrimi i Legjislacionit me Bashkimin Evropian

Prof. Assoc. Malvina Hoxha

*Departamenti për Vlerësimin Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave, Fakulteti i Farmacisë, Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, Rruga Dritan Hoxha, Tiranë;
m.hoxha@unizkm.al*

Abstrakt

Pavarësisht ndryshimeve të bëra në Ligjin për "Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik", ka ende shumë hapa për tu ndërmarrë për përafrimin e legjislacionit shqiptar më atë evropian në sektorin e Farmakovigjilencës. Disa studime të kryera në vend tregojnë mungesë të informacionit mbi mënyrën e raportimit të efekteve të padëshiruara si nga profesionistët e shëndetit, edhe nga pacientët. Aktualisht nuk është publikuar asnjë statistikë zyrtare lidhur me numrin e raportimeve në vitet e fundit. Pavarësisht ndryshimeve të bëra së fundmi dhe futjes së aplikacionit për raportimet e efekteve të padëshiruara të barnave "AKBPM Farmakovigjilenca", formulari i raportimeve si për pacientët dhe për profesionistët e shëndetit ka ende informacione që mungojnë, ndër të cilat: përfshirja e datës së menstracioneve të fundit, trimestrit përkatës të shtatëzanisë, etj. Përveç raportimeve për efektet e padëshiruara të barnave, në legjislacion mungon mënyra e raportimit të efekteve të padëshiruara nga produktet kozmetike dhe ato bimore.

Fjalët kyç: *Farmakovigjilenca, kuadri ligjor, raportimi, ligji shqiptar dhe evropian për farmakovigjilencën, përafrim legjislacionesh, Uppsala Monitoring Centre, OBSH, Eudravigjilanca*

Abstract

Despite the changes made in the Law for "Medicinal Products and Pharmaceutical Service", there are still many steps to be taken for the harmonization of the Albanian pharmaceutical legislation with the European pharmaceutical directive in the Pharmacovigilance sector. Some studies

conducted in the country show a lack of information on how to report the adverse drug reactions (ADR) both from health professionals, and from patients. Currently, no official statistics have been published regarding the number of ADR signalling in the recent years. Despite the recent changes and the introduction of the signalling software "AKBPM Farmakovigjilenca", the reporting form for both patients, and health professionals still has many information that is missing, among which: the inclusion of the date of the last menstruation, the corresponding trimester of pregnancy, etc. In addition, the legislation lacks the way to report the adverse reactions related to cosmetic and herbal products.

Keywords: *Pharmacovigilance, legal framework, reporting of adverse drug reactions, Albanian and European law for pharmacovigilance, harmonization of legislations, Uppsala Monitoring Centre, WHO, Eudravigilance*

Hyrje

Farmakovigjilenca përfaqëson shkencën dhe aktivitetet që përfshijnë një sërë praktikash të lidhura me identifikimin, vlerësimin, kuptimin, si dhe parandalimin e çdo efekti të padëshiruar, ose çdo problemi që lidhet me barnat/vaksinat [1].

Legjislacioni farmaceutik shqiptar nr 105/2014 "Për Barnat dhe Shërbimi Farmaceutik", i ndryshuar në dhjetor 2022, përkatësisht kreu XI, shprehet në lidhje me sektorin e Farmakovigjilencës në Shqipëri. Ky sektor është pjesë e strukturës së Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) prej vitit 2011, dhe është përgjegjës për mbledhjen e

informacionit mbi shfaqjen e riskut të barnave ndaj pacientëve, ose ndaj shëndetit publik [2].

Si mbajtësi i autorizimit të tregtimit, edhe mbajtësi i autorizimit të tregtimit lokal dorëzojnë pranë AKBPM-së të dhënat e detajuara mbi personin përgjegjës për farmakovigjilencën [2]. Ky i fundit, duhet të ketë përfunduar studimet në degën e farmacisë, mjekësisë, ose stomatologjisë, duhet të jetë rezident në Shqipëri, si dhe duhet të jetë i specializuar ose të ketë kryer trajnime të certifikuara për farmakovigjilencën [2].

Raportimi i efekteve të padëshiruara të barnave në përputhje me indikacionet e përshkruara në autorizimin e tregtimit ose jo, ose si rezultat i ekspozimit të papërshtatshëm ndaj barnave, nëpërmjet formularëve të raportimit të efekteve të padëshiruara për pacientët dhe profesionistët e shëndetit [2] është pjesë thelbësore e sistemit të farmakovigjilencës.

Metodologjia

Në këtë studim Direktiva 2012/26/EU, Direktiva 2001/83/EC, në lidhje me farmakovigjilencën, Rregullorja (EU) Nr. 520/2012 e datës 19 qershor 2012 mbi farmakovigjilencën, Rregullorja 726/2004, Rregullorja (EU) Nr 1027/2012 janë krahasuar me Legjislacionin farmaceutik shqiptar nr 105/2014 "Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik", i ndryshuar (Ligji Nr 95/2022). Njëkohësisht faqja zyrtare e AKBPM-së, institucioni përgjegjës shqiptar për sektorin e Farmakovigjilencës u rishikua në lidhje me procedurat e raportimit të efekteve të padëshiruara të barnave, si dhe mbi ekzistencën e të dhënave vjetore për raportimin e efekteve të padëshiruara të barnave në Shqipëri.

Legjislacioni mbi farmakovigjilencën në Republikën e Shqipërisë

Konsolidimi i sistemit të farmakovigjilencës në Shqipëri ka filluar me anëtarësimin e Shqipërisë në Qendrën Ndërkombëtare të Monitorimit Uppsala (Uppsala Monitoring Centre), Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), fillimisht si anëtare e asociuar prej vitit 2011 dhe me vonë si anëtare e plotë që nga viti 2020 në Programin Ndërkombëtar të Monitorimit të Barnave të OBSH-së (WHO-PIDM) [3].

Anëtarësimi në Uppsala Monitoring Centre nënkupton raportimin e efekteve të padëshiruara në një databazë të përbashkët me vendet e tjera anëtare (rreth 170 vende anëtare), me qëllim shkëmbimin e informacionit

mbi efektet e padëshiruara të barnave në kohë reale [3].

Sektori i Farmakovigjilencës në Shqipëri, pranë AKBPM-së ka për detyrë grumbullimin, përpunimin dhe raportimin e efekteve të padëshiruara të barnave. Kreu XI, Neni 57 pika 1 e Ligjit nr 105/2014 "Për Barnat dhe Shërbimi Farmaceutik", i ndryshuar (Ligji Nr 95/2022), përcakton se "Sektori i farmakovigjilencës, strukturë e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, funksionon në bazë të një rregulloreje të sistemit të farmakovigjilencës në Republikën e Shqipërisë dhe është përgjegjës për mbledhjen e informacionit mbi shfaqjen e riskut të barnave ndaj pacientëve ose ndaj shëndetit publik. Ky informacion, në mënyrë të veçantë, u referohet efekteve të padëshiruara në qëniet njerëzore, si rezultat i përdorimit të barnave në përputhje me indikacionet e përshkruara në autorizimin e tregtimit ose jo, si dhe si rezultat i ekspozimit të papërshtatshëm ndaj barnave. Efektet e padëshiruara raportohen nëpërmjet formularëve të raportimit të efekteve të padëshiruara për pacientët dhe profesionistët e shëndetit." [2].

Ligji Nr. 95/2022 sjell disa ndryshime në ligjin 105/2014, siç janë vendosja e disa përkufizimeve, përkatësisht shtimi i pikës 82, 87, 88 dhe 89 si më poshtë:

"82. **"Dita zero"** është dita në të cilën mbajtësi i autorizimit për tregtim, mbajtësi i autorizimit për tregtim lokal, zyra e përfaqësisë ose tregtuesi me shumicë mësoi për efektin e padëshiruar. [4];

87. **"Efekt i padëshiruar"** është një përgjigje ndaj një bari që shfaqet në doza që zakonisht përdoren te njerëzit për profilaksinë, diagnostikimin, terapinë e sëmundjes, për restaurimin, korrigjimin ose modifikimin e funksionit fiziologjik. [4]

88. **"Efekt i padëshiruar serioz"** është një reaktion negativ që rezulton me vdekje, është kërcënues për jetën, kërkon shtrimin në spital ose zgjatjen e shtrimit ekzistues, rezulton në paaftësi ose paaftësi të vazhdueshme ose të konsiderueshme, ose është një anomali e lindur, e shkaktuar nga përdorimi i barit." [4]

89. **"Efekt i padëshiruar i papritur"** është një reaktion anësor, natyra, ashpërsia ose rezultati i të cilit nuk përputhet me përmbledhjen e karakteristikave të produktit." [4]

Ndër risitë në sektorin e farmakovigjilencës në legjislacion janë kufijtë kohorë të raportimit të efekteve të padëshiruara të barnave, konkretisht, 24 orë nga dita zero për efektet e padëshiruara serioze të papritura, 15 ditë nga

dita zero për efektet serioze dhe 90 ditë nga dita zero për efektet e padëshiruara [4].

Së fundmi, raportimi i efekteve të padëshiruara si nga pacientët, dhe nga profesionistët shëndetësor mund të kryhet përmes aplikacionit "AKBPM FARMAKOVIGJILENCA", hap i cili lehtëson raportimin e efekteve të padëshiruara të barnave në Shqipëri [5].

Ligji Evropian

Numri i lartë i efekteve të padëshiruara të barnave, të shoqëruara me rreth 197,000 vdekje në vit në vendet e Bashkimit Evropian (BE), çoi në rishqyrtimin e legjislacionit mbi farmakovigjilencën në vitin 2005 dhe në sponsorizimin e një studimi të pavarur, si dhe në një konsultim publik në vitin 2006-2007 [6].

Ndryshimi më i madh legjislativ që Komisioni Evropian ka bërë në fushën e farmakovigjilencës, përkatësisht Direktivës 2001/83/EC dhe Regullores 726/2004, është Regullorja Nr 520/2012, Rregullorja (EU) Nr 1027/2012, dhe Direktiva 2012/26/EU (e hyrë në fuqi në 28 Tetor 2013) [6].

Autoritetet përgjegjëse kombëtare mbi farmakovigjilencën bashkëpunojnë me Agjencinë për monitorimin e të dhënave mbi Eudravigilencën.

EudraVigilance, e krijuar në dhjetor 2001, është databaza evropiane për mbledhjen dhe analizën e raportimeve të efekteve të padëshiruara të barnave që kanë autorizim tregtimi, ose janë objekt i studimeve klinike. Trasmetimi i informacionit në EudraVigilance bëhet në mënyrë elektronike nga autoritetet rregullatore nacionale, kompanitë farmaceutike mbajtëse të autorizimit të tregtimit të barnave, nga studimet klinike, etj. EVCTM dhe EVPM janë dy modulet që përdoren për mbledhjen e informacioneve lidhur me efektet e padëshiruara të barit nga EudraVigilance.

EVCTM është moduli "provat klinike" që regjistron të gjitha efektet e padëshiruara të dyshuara që vijnë nga studimet klinike. EVPM është moduli "post-autorizim" që regjistron raportimet e efekteve të padëshiruara të dyshuara që vijnë nga raportimet spontane, studimet cohort, studimet klinike post-autorizim [7].

Aktualisht, pranë Agjencisë Evropiane të Barnave (EMA) ekziston një Komision i Vlerësimit të Riskut të Farmakovigjilencës (PRAC- Pharmacovigilance Risk Assessment

Committee), i përbërë nga anëtar të emëruar nga Komisioni dhe shtetet anëtare, i cili është përgjegjës për vlerësimin e riskut që lidhet me përdorimin e barnave. PRAC jep rekomandime si CHMP-së (Komitetit për Barnat për përdorim human), edhe CMDh-së (Grupit Koordinues për Njohjen Reciproke dhe Proçedurat e Decentralizuara për përdorimin e barnave në Shtetet Anëtare) për çështje të ndryshme të farmakovigjilencës [8].

Përafrimi i Legjislacionit Shqiptar mbi Farmakovigjilencën me Ligjin Evropian

Pavarësisht ndryshimeve të bëra në Ligjin për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik, ka ende shumë hapa për t'u ndërmarrë për përafrimin e ligjit shqiptar me atë evropian në sektorin e Farmakovigjilencës. Sektori Nacional për Farmakovigjilencën në Shqipëri pranë AKBPM-së ka për detyrë, përveçse të mbledh dhe analizojë informacionet lidhur me efektet e padëshiruara të barnave/vaksinave, edhe të informojë publikun në faqen zyrtare të AKBPM-së dhe rrjetet e tij sociale, lidhur me numrin e raportimeve dhe me efektet e padëshiruara të raportuara, të cilat janë konfirmuara si të tilla, jo vetëm për ruajtjen e shëndetit të publik, por edhe për rritjen e transparencës dhe besueshmërisë lidhur me proçesin e raportimit, i cili ndihmon ndjeshëm në rritjen e numrit të raportimeve. Disa studime të kryera në vend tregojnë mungesë të informacionit mbi mënyrën e raportimit si nga profesionistët e shëndetit dhe nga pacientët [9,10]. Aktualisht nuk është publikuar asnjë statistikë lidhur me numrin e raportimeve në vitet e fundit. Pavarësisht ndryshimeve të bëra së fundmi dhe futjes së aplikacionit për raportimet "AKBPM Farmakovigjilencia", formulari i raportimeve si për pacientët dhe për profesionistët e shëndetit ka ende informacione që mungojnë, ndër të cilat: përfshirja e datës së menstracioneve të fundit, trimestrit përkatës të shtatëzanisë, të dhëna lidhur me përdorimin e mëparshëm të barit dhe përdorimin e barnave të tjera për trajtimin e efekteve të padëshiruara të shkaktuara. Në rast se bari është dhënë me recetë mjekësore, të dhënat lidhur me mjekun duhet të përfshihen në formën e raportimit. Pacienti gjithashtu duhet të pyetet nëse mjeku është informuar lidhur me efektet e padëshiruara dhe nëse pacienti autorizon ekspertin e farmakovigjilencës të kontaktojë mjekun përkatës [11]. Origjina etnike e pacientit, diagnoza e pacientit, përdorimi i njëkohshëm i suplementeve ushqimore dhe fitoterapeutikëve janë informacione të cilat mungojnë në formën e raportimit të efekteve të

padëshiruara nga profesionistët shëndetësorë [11]. Në rast se bari është përshkruar nga mjeku, të dhënat lidhur me mjekun përkatës (emër, mbiemër, specialiteti) duhet të përfshihen në formën e raportimit për pacientët.

Përpos raportimeve për barnat, në legjislacion mungon mënyra e raportimit të efekteve të padëshiruara që lidhen me produktet kozmetike dhe ato bimore. Formular raportimi të posaçëm, të ndryshëm nga ai për barnat për përdorim njerëzor/vaksinat duhet të krijohen, për të informuar popullatën se efekte të padëshiruara serioze lidhen edhe me to. Vlen për tu theksuar fakti se raportimi i efekteve të padëshiruara të barnave, duhet bërë edhe për barnat për përdorim veterinar.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe mbajtësi i autorizimit të tregtimit lokal duhet të dorëzojnë pranë AKBPM-së të dhënat e detajuara jo vetëm mbi personin përgjegjës për farmakovigjilencën, por edhe procedurat që duhen ndjekur në rast mungese, koordinatat dhe përgjegjësitë e personit zëvendësues. Gjithashtu AKBPM duhet të informohet lidhur me ambientet ku kryhen aktivitetet e farmakovigjilencës, si më poshtë: mbledhja e raporteve të sigurisë për raste individuale, hartimi i raportit periodik të përditësimit të sigurisë, identifikimi dhe analizën e sinjaleve, menaxhimi i studimeve para dhe pas autorizim, etj. Përshkrimi i procesit të përpunimit dhe regjistrimit të të dhënave dhe procedurat për komunikimin e problemeve të sigurisë dhe variacioneve të sigurisë në lidhje me indikacionet në përmbledhjen e karakteristikave të produktit dhe fletëpalosjen e barit duhet të paraqiten pranë Sektorit të Farmakovigjilencës, AKBPM. Gjithashtu, dosja me dokumentet për sistemin e farmakovigjilencës duhet të ruhet si në formë elektronike, dhe në kopje të printuar me informacionin përkatës, i cili duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm, dhe të vihet në dispozicion për auditime dhe inspekte. Dokumentat duhet të indeksohen dhe arkivohen në mënyrë që të mund të gjenden me lehtësi në rast nevojë për konsultim, interpretim dhe verifikim.

Të gjitha këto hapa do të ndihmojnë ndjeshëm në përmirësimin dhe forcimin e Sistemit të Farmakovigjilencës në Shqipëri, nxitjen e pacientëve dhe punonjësve shëndetësorë mbi raportimin, si dhe monitorimin e sigurisë së barnave dhe produkteve të tjera, të cilat do të ndihmojnë në procesin e trasmetimit të

informacionit në databazën evropiane "EUDRAVIGILANCE".

Falenderime

Autorja dëshiron të falënderojë Programin Erasmus+ të BE për financimin e Projektit Jean Monnet Module me titull "Harmonizimi i Legjislacionit Farmaceutik Shqiptar me Direktivën Evropiane të Barnave"-PHARM-EU. Mendimet e shprehura janë vetëm të autores, jo domosdoshmërisht pasqyrojnë ato të Bashkimit Evropian. As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti sponsorizues nuk mund të mbajnë përgjegjësi për të.

Literaturë

1. World Health Organization. Regulation and Prequalification. www.who.int/teams/regulation-prequalification/regulation-and-safety/pharmacovigilance#:~:text=Pharmacovigilance%20is%20the%20science%20and,other%20medicine%2Fvaccine%20related%20problem
2. Ministria e Shëndetësisë. <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Ligj-Nr.105-2014-Per-Barnat-Dhe-Sherbimin-Farmaceutik.Pdf>
3. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM). <https://akbpm.gov.al/sektori-i-farmakovigjilences/>
4. Ligji 95/2022. <https://akbpm.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/LIGJI-Nr.-952022.pdf>
5. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM). <https://akbpm.gov.al/shkarko-aplikacionin-akbpm-farmakovigjilenca/>
6. European Medicines Agency. Legal Framework: Pharmacovigilance. <https://www.ema.europa.eu/en/human-regulatory-overview/pharmacovigilance-overview/legal-framework-pharmacovigilance>
7. European Medicines Agency. Legal Framework: Eudravigilance system overview. <https://www.ema.europa.eu/en/human-regulatory-overview/research-development/pharmacovigilance-research-development/eudravigilance/eudravigilance-system-overview>
8. European Medicines Agency. Legal Framework: Pharmacovigilance Risk

- Assessment Committee (PRAC).*
<https://www.ema.europa.eu/en/committees/pharmacovigilance-risk-assessment-committee-prac>
9. Shkreli R, Dhamo K, Haloçi E, Tabaku A. *Knowledge, Attitude and Practice towards Pharmacovigilance and Reporting of Adverse Drug Reactions among Health Care Professionals in Albania: A Cross-Sectional Study.* *Pak J Pharm Sci.* 2023 May;36(3):713-721.
 10. Hoxha M, Spahiu E, Spahiu M, Zappacosta B. *Reporting of Adverse Drug Reactions by Dentists and Dental Patients in Albania.* *Int Dent J.* 2024 Apr;74(2):242-245. doi: 10.1016/j.identj.2023.08.005.
 11. Hoxha M, Zappacosta B, Franco M. *An overview of Albanian Pharmacovigilance system and its harmonization with the European Pharmacovigilance Legislation.* *Biomedicine & Prevention.*2024; vol 1-249; doi: 10.19252/0000000F9

**SHKENCAT HUMANE, POLITIKE-JURIDIKE DHE
EKONOMIKE**

PËRSHKRIMI DHE MATJA E NDIKIMEVE TË VARIABLAVE MAKROEKONOMIKË NË BILANCIN TREGTAR TË SHQIPËRISË

Brikena Sulejmani¹

¹Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri

Yldeze Sokoli²

²Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Vlorë, Shqipëri

Olsi Xhoxhi³

³Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Ekonomiksit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Vlorë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim shqyrton ndikimin e variablave makroekonomikë në bilancin tregtar në Shqipëri, duke përdorur të dhëna dytësore tremujore për periudhën 2005-2023 të marra nga Trading Economics. Metodologjia e kërkimit përfshin përdorimin e programit Microsoft Office për analizën dhe përfaqësimin grafik të të dhënave. Variablat e përdorur përfshijnë bilancin tregtar si variabël i varur dhe variabla të pavarur si oferta monetare (M3), investimet e huaja direkte (FDI), Produktin e Brendshëm Bruto (GDP), dhe kursin e këmbimit euro/lekë.

Modeli ekonometrik i aplikuar është një regresion i shumfishtë që ka si qëllim të masë ndikimin e variablave të pavarur mbi variablën e varur. Rezultatet e analizës tregojnë një lidhje të moderuar të fortë midis variablave të pavarur dhe variablave të varur, me një R Square prej 0.5788, që sugjeron se 57.88% e variancës në të dhënat e varura mund të shpjegohet nga variablat e pavarur. Analiza e variancës (ANOVA) mbështet rëndësinë statistikore të modelit me një F-vlerë të lartë prej 16.30357318 dhe një Significance F shumë të vogël, që tregon se variablat e pavarur kanë një ndikim të konsiderueshëm në variablën e varur.

Statistikat e regresionit tregojnë se oferta monetare (M3) dhe investimet e huaja direkte (FDI) kanë ndikime të rëndësishme dhe negative në bilancin tregtar, ndërsa GDP-ja dhe kursi i këmbimit nuk tregojnë lidhje të dukshme

statistikore me bilancin tregtar. Këto rezultate theksojnë nevojën për politika ekonomike të qëndrueshme dhe të mirë-strukturuara për të përmirësuar stabilitetin ekonomik dhe rritjen e qëndrueshme në Shqipëri.

Fjalët kyçe: *Bilanci Tregtar, Oferta Monetare, Investimet e Huaja Direkte, Produkti i Brendshëm Bruto, Kursi i Këmbimi*

Abstract

This study examines the impact of macroeconomic variables on the performance of banking institutions in Albania, using quarterly secondary data for the period 2005-2023 obtained from Trading Economics. The research methodology includes the use of the Microsoft Office program for data analysis and graphical representation. The variables used include the trade balance as a dependent variable and independent variables such as money supply (M3), foreign direct investments (FDI), Gross Domestic Product (GDP), and the euro/lek exchange rate.

The applied econometric model is a multiple regression that aims to measure the influence of the independent variables on the dependent variable. The results of the analysis show a moderately strong relationship between the independent variables and the dependent variables, with an R Square of 0.5788, suggesting

that 57.88% of the variance in the dependent data can be explained by the independent variables. Analysis of variance (ANOVA) supports the statistical significance of the model with a high F-value of 16.30357318 and a very small Significance F, indicating that the independent variables have a significant impact on the dependent variable.

Regression statistics show that money supply (M3) and foreign direct investment (FDI) have significant and negative impacts on the trade balance, while GDP and the exchange rate show no significant statistical relationship with the trade balance. These results highlight the need for sustainable and well-structured economic policies to improve economic stability and sustainable growth in Albania.

Keywords: *Trade Balance, Monetary Supply, Foreign Direct Investments, Gross Domestic Product, Exchange Rate*

1. Hyrje dhe rishikimi i literaturës

Bilanci tregtar është një nga indikatorët kryesorë të shëndetit ekonomik të një vendi, duke reflektuar diferencën ndërmjet eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve. Në Shqipëri, ndryshimet në bilancin tregtar janë të ndikuara nga një sërë variablash makroekonomikë, siç janë normat e interesit, kursi i këmbimit, inflacioni, dhe rritja ekonomike. Ky artikull synon të ofrojë një përshkrim të detajuar të këtyre variablave dhe të masë ndikimin e tyre në bilancin tregtar të Shqipërisë, duke përdorur analiza statistikore dhe modelet ekonometrike. Përmes kësaj analize, ne synojmë të nxjerrim në pah faktorët kyç që ndikojnë në tregtinë ndërkombëtare të vendit dhe të ofrojmë rekomandime për politikën ekonomike që mund të përmirësojnë balancën tregtare.

Studimi heton determinantët e bilancit tregtar të Somalisë nga viti 1970 deri në vitin 2010, duke përdorur të dhëna vjetore nga Trading Economics, Indeksi Mundi i Bankës Botërore dhe Indikatorët e Zhvillimit Botëror [1]. Objektivi kryesor i studimit ishte të identifikonte faktorët që ndikojnë në bilancin tregtar, duke përdorur statistika përshkruese për të përmbledhur të dhënat përpara analizës. Parametrat u vlerësuan dhe një Matricë e Korrelacioneve u përdor për të kontrolluar për multikollinearitetin midis variablave të pavarur, ndërsa një test për Heteroskedasticitetin vlerësoi stabilitetin e variancës së mbetjeve. Analiza e Regresionit të Drejtpërdrejtë (OLS), e kryer duke përdorur softuerin E-views, tregoi se investimet e huaja direkte (FDI) kishin një ndikim negativ të

rëndësishëm në bilancin tregtar, ndërsa kursi i këmbimit dhe norma e inflacionit kishin ndikime pozitive. Studimi theksoi nevojën për të adresuar ndikimin negativ të FDI-së në bilancin tregtar të Somalisë, duke sugjeruar politika për përmirësimin e klimës së investimeve, arsimit, stabilizimit të monedhës dhe mbështetjen e prodhimit dhe eksportit vendas. Rekomandimet përfshijnë mbajtjen e politikave të qëndrueshme për të tërhequr investitorë të huaj, mbështetjen e eksporteve përmes incentivave dhe kufizimin e importeve për të siguruar që prodhimi vendas plotëson nevojat e konsumatorëve.

Tregtia e jashtme e Indisë ka evoluar ndjeshëm që nga fitimi i pavarësisë, duke kaluar nga shkëmbimet e kufizuara me disa vende dhe mallra në një angazhim më të diversifikuar dhe më të gjerë global [2]. Aktivitetet e eksportit kanë dalë si një shtytës thelbësor i rritjes së PBB-së së Indisë gjatë viteve. Ky studim eksploron ndërveprimin midis bilancit tregtar dhe variablave kryesore makroekonomike si kursi i këmbimit, oferta monetare dhe PBB-ja (të ardhurat e brendshme), duke mbuluar periudhën nga viti 2000 deri në 2018. Duke përdorur modelin Auto Regressive Distributed Lag (ARDL), kërkimi heton si dinamikat afatshkurtra ashtu edhe marrëdhëniet afatgjata midis këtyre variablave. Gjetjet tregojnë se oferta monetare dhe PBB-ja kanë një ndikim të rëndësishëm në bilancin tregtar, ndërsa kursi i këmbimit tregon një ndikim të papërfillshëm. Kërkimet e ardhshme mund të zgjerojnë fushën për të përfshirë faktorë të tjerë makroekonomikë për të ndriçuar më tej efektet e tyre në bilancin tregtar, duke dhënë njohuri më të sakta.

Ky studim empirik heton ndikimin e bilancit tregtar dhe kurseve të këmbimit në rritjen ekonomike në Komunitetin e Zhvillimit të Afrikës Jugore (SADC) duke përdorur të dhëna tremujore nga viti 1970 deri në 2022 [3]. Gjetjet tregojnë se bilanci tregtar dhe performanca e kursit të këmbimit ndikojnë pozitivisht dhe në mënyrë të rëndësishme në rritjen ekonomike, duke përputhur me literaturën ekzistuese. Megjithatë, u zbulua se investimet e huaja direkte (FDI) kanë një ndikim të parëndësishëm në rritjen ekonomike në rajonin SADC, duke sugjeruar që faktorë ose politika të tjera mund të jenë më ndikues në zhvillimin ekonomik. Testet e kauzalitetit të panelit Dumitrescu-Hurlin (DH) treguan se nuk kishte prova për kauzalitet të dyanshëm midis bilancit tregtar dhe rritjes ekonomike në komunitetin SADC. Në kontrast, u gjet kauzalitet i dyanshëm midis performancës së kursit të këmbimit dhe rritjes ekonomike, duke treguar se ndryshimet në kurset e këmbimit

mund të ndikojnë në rritjen ekonomike dhe anasjelltas. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e politikave të mira që promovojnë eksportet dhe reduktojnë varësinë nga importet për të krijuar kushte të favorshme makroekonomike që nxisin rritjen ekonomike dhe përmirësojnë performancën e kursit të këmbimit. Për më tepër, rekomandohet zbatimi i politikave që maksimizojnë përfitimet dhe ruajtjen e fitimeve nga FDI për të mbështetur më tej zhvillimin ekonomik në rajonin SADC. Kufizimi kryesor i këtij studimi është numri i variablave të përfshira. Studimet e ardhshme duhet të përfshijnë më shumë variabla makroekonomike si inflacioni dhe normat e interesit dhe të kryejnë kërkime të ngjashme në blloqe të tjera rajonale afrikane si ECOWAS për analiza krahasuese kuptimplota në të gjithë kontinentin.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë ndikimin e politikës monetare në tërheqjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja [4]. Ne përdorëm të dhëna nga vendet tipike të Azisë Juglindore për periudhën 1997 deri në 2020, duke përdorur regresionin e katrorëve më të vogël (OLS), efektet fikse (FEM) dhe efektet rastësore (REM), si dhe teste të varësisë ndërkufitare duke përdorur standardet e korrigjuara për panelet (PCSE) dhe standardet e Driscoll-Kraay për të vlerësuar ndryshimet në politikat monetare të vendeve të Azisë Juglindore në kalimin e kohës. Rezultatet konfirmojnë se politika monetare ekspansioniste ka një ndikim negativ në tërheqjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja, ndërsa politika monetare kontraktuale ka efektin e promovimit të fluksit të kapitalit ndërkombëtar në vendet e Azisë Juglindore. Studimi gjithashtu konfirmoi ndikimin pozitiv të liberalizimit të tregtisë dhe cilësisë së burimeve njerëzore në aftësinë për të tërhequr investime të drejtpërdrejta të huaja. Megjithatë, nuk u gjet asnjë efekt në investimet e drejtpërdrejta të huaja për shkallën e urbanizimit, madhësinë e popullsisë, ose numrin e turistëve.

Studimet e mëparshme tregojnë se bilanci i tregtisë ndikon në rritjen ekonomike, por rezultatet janë të paqarta, duke theksuar nevojën për të sqaruar rëndësinë e bilancit të tregtisë [5]. Tregtia njihet si një faktor kyç për rritjen ekonomike, duke nxitur akumulimin e kapitalit, modernizimin e strukturës industriale, përparimin teknologjik dhe përparimin institucional. Shumica e studimeve shqyrtojnë ndikimet e eksporteve dhe importeve veçmas, duke dështuar të kapin efektin e përgjithshëm të bilancit të tregtisë. Për të adresuar këtë, analiza jonë përfshin të gjitha periudhat e bilancit të tregtisë dhe përqendrohet në periudhat e

deficitit të bilancit të tregtisë në 28 vendet e BE-së, duke zbuluar përmirësime në bilancet e tyre të tregtisë me rritje të surplusit dhe ulje të deficitit. Megjithatë, krahasimi i rritjes mesatare të bilancit të tregtisë dhe rritjes ekonomike për periudha prej 10 dhe 20 vjetësh tregon rezultate të ndryshme ndërmjet 28 vendeve, duke kërkuar një vlerësim më të thellë të ndikimeve të bilancit të tregtisë. Në përputhje me gjetjet e Busse dhe Königer (2012), Abbas dhe Raza (2013), dhe Cetintas dhe Barisik (2008), analiza jonë e regresionit multivariat (modeli I) konfirmon një ndikim negativ statistikisht të rëndësishëm të përkeqësimit të bilancit të tregtisë në rritjen ekonomike, me faktorin e punës që ka një ndikim pozitiv statistikisht të rëndësishëm dhe kapitali dhe rritja ekonomike fillestare që kanë ndikime negative. Analiza e Modelit II, duke u përqendruar në periudhat e deficitit të tregtisë, mbështet këto gjetje. Në përgjithësi, përkeqësimi i bilancit të tregtisë ul rritjen ekonomike mesatare, pavarësisht nëse fillon nga një deficit apo surplus. Hulumtimet e ardhshme duhet të shqyrtojnë faktorë të tillë si madhësia e deficitit dhe përhershmeria e tij dhe ndërveprimin midis deficitit të tregtisë dhe faktorëve që ndikojnë në heterogjenitetin e ndikimit të tij, duke mundësuar efektet jo-linear. Politikat e tregtisë duhet të shqetësohen për përkeqësimin e bilancit të tregtisë, si në situatat e deficitit ashtu edhe në ato të surplusit.

Ky studim shqyrton lidhjet ndërmjet furnizimit me para, indikatorëve makroekonomikë dhe investimeve të portofolit të huaj në Vietnam [6]. Duke përdorur Modelin Autoregressive Distributed Lag dhe duke analizuar të dhënat trimestrale nga Q1/2007 deri në Q4/2022 me softuerin Stata 17, analiza tregon lidhje të forta dhe të qëndrueshme. Rritja e furnizimit me para dhe rritja ekonomike kanë një ndikim pozitiv në investimet e portofolit të huaj, me furnizimin me para nga çerekvjetorët e mëparshëm që ndikon ndjeshëm në investimet e portofolit të huaj ($Vlera-P < 0.01$). Nga ana tjetër, kursi i këmbimit dhe investimet e drejtpërdrejta të huaja kanë një ndikim negativ në investimet e portofolit të huaj. Tre indikatorë makroekonomikë tregojnë rëndësi në nivelet 1% dhe 5%, ku produkti i brendshëm bruto (PBB) ka një efekt pozitiv në investimet e portofolit të huaj, ndërsa kursi i këmbimit dhe investimet e drejtpërdrejta të huaja kanë ndikime negative. Konkretisht, një rritje prej 1% në PBB korrespondon me një rritje prej 50.426 milion USD në investimet e portofolit të huaj, ndërsa një rritje prej 1 milion USD në investimet e drejtpërdrejta të huaja rezultojnë në një ulje prej 0.025 milion USD. Kursi i këmbimit ka një ndikim të rëndësishëm, me mundësinë e

reduktimit të investimeve të portofolit të huaj përmes devalvimit të VND-së ose rritjes së kursit VND/USD për shkak të rregullimeve qeveritare. Për të nxjerrë përfundime përfundimtare mbi borxhin e jashtëm, normat e interesit dhe inflacionin kërkohen të dhëna dhe kërkime shtesë. Vlera R-squared e studimit është 0.2738, me një R-squared të përshtatur prej 0.1813, duke shpjeguar 27.38% të ndryshimeve të ardhshme në investimet e portofolit të huaj në Vietnam. Këto rezultate ofrojnë informacione të rëndësishme për politikëbërësit, duke sugjeruar që zgjerimi i furnizimit me para dhe zbatimi i politikave të përshtatshme të normës së interesit mund të rrisin tërheqjen e investimeve të portofolit të huaj në afatin e afërt.

Ky dokument shqyrton lidhjen ndërmjet kursit të këmbimit (MYR/RMB) dhe bilancit të tregtisë, duke përdorur Malajzinë si një rast studimor [7]. Ai merr parasysh çmimet e aksioneve, furnizimin me para dhe eksportet në Kinë si variabla kontrolli. Metododat ARDL dhe Nonlinear ARDL përdoren për të testuar nëse lidhja ndërmjet kursit të këmbimit dhe bilancit të tregtisë është simetrike apo asimetrike në afat të shkurtër dhe afat të gjatë. Rezultatet tregojnë se variablat janë teorikisht të lidhur, siç e vërteton ko-integrimi i tyre. Për më tepër, lidhja ndërmjet kursit të këmbimit dhe bilancit të tregtisë duket të jetë simetrike në afat të shkurtër, por asimetrike në afat të gjatë. Testi i Granger-it tregon se kursi i këmbimit është një variabël endogjen (i varur) që udhëhiqet kryesisht nga furnizimi me para, ndjekur nga çmimet e aksioneve dhe bilanci i tregtisë. Këto rezultate kanë implikime të forta për politikën.

Gjatë periudhave të pandemisë COVID-19 nga 2020-21 dhe 2021-22, qeveria e Indisë ndërmori masa të menjëhershme për të zvogëluar shqetësimet në mes të grupeve të ndjeshme dhe sektorëve të biznesit [8]. Masat kryesore përfshijnë programin Skill India, transferimet në llogaritë e PM-Kisan Yojana, sigurinë ushqimore përmes PM-GKAY dhe kartës së një kombi një racion, krijimin e vendeve të punës përmes PM-GKRA, MGNREGA, dhe Atmanirbhar Bharat Rojgar Yojana. Këto përpjekje kontribuuan në mënyrë të ndjeshme në rimëkëmbjen në formë V të ekonomisë indiane. Performanca e rritjes së sektorit industrial pritet të jetë motori kryesor i rritjes ekonomike, e përkrahur nga programe të rëndësishme si Make in India, Ease of Doing Business dhe Start Up India. Rritjet vjetore të furnizimit me para, kredia e bankave komerciale, investimet në kapital, prodhimi kombëtar, hyrjet e investimeve të drejtpërdrejta të huaja, tregtia e

jashtme dhe rritja e sektorit industrial janë përballur me sfida për të arritur rimëkëmbjen në formë V nga nivelet e para-COVID në nivelet post-COVID. Megjithatë, një përmirësim në performancën e sektorit industrial u shfaq në 2021-22 për shkak të rihapjes graduale të ekonomisë, vaksinimeve rekord, rritjes së kërkesës së konsumatorëve, mbështetjes së vazhdueshme të politikave përmes paketës Atmanirbhar Bharat, zgjerimit të linjave të kreditit dhe forcimeve të tjera nga qeveria e Indisë (Raporti Ekonomik i Indisë, 2020-21).

2. Metodologjia e kërkimit

2.1. Burimi i të dhënave

Në këtë studim janë përdorur të dhëna dytësore tremujore që mund të aksesohen lehtësisht nga të gjithë, të marra nga websiti Trading Economics për Shqipërinë për periudhën 2005 - 2023.

2.2. Instrumentet e përdorura për analizimin e të dhënave dhe variablat

Për analizimin e të dhënave dhe për paraqitjet grafike u përdor programi Microsoft Office. Si variabla u përdorën variablat e mëposhtme:

Variabli i varur:

- **Bilanci Tregtar** është një indikator ekonomik që tregon diferencën midis vlerës së eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve në një ekonomi. Ai mat nëse një vend ka një bilanc të favorshëm (kur eksportet janë më të mëdha se importet) apo të pafavorshëm (kur importet janë më të mëdha se eksportet). Ky bilanc është një komponent kyç i bilancit të pagesave dhe ndihmon në vlerësimin e shëndetit ekonomik dhe marrëdhënieve tregtare të një vendi.

Variabla të pavarur makroekonomikë:

- **Money Supply (M3):** M3 është një masë e gjerë e ofrimit të parasë në ekonomi që përfshin monedhat në qarkullim, depozitat e kursimeve dhe disa lloje të tjera të likuiditeteve. Përdoret për të monitoruar ofertën totale të parasë në një ekonomi dhe ndihmon në vlerësimin e politikës monetare dhe inflacionit.
- **Foreign Direct Investment (FDI):** Investimet e Huaja Direkte (FDI) përfaqësojnë investimet që bëhen nga

individë, kompani, ose qeveri të huaja në një ekonomi të huaj, shpesh në formën e ndërtimit të impianteve, blerjes së aksioneve në kompani lokale, ose në investime të tjera të drejtpërdrejta. FDI ndihmon në rritjen e kapitalit të vendit, krijimin e vendeve të punës dhe transferimin e teknologjisë.

- **Gross Domestic Product (GDP):** Produkti i Brendshëm Bruto (GDP) është një matës i përgjithshëm i aktivitetit ekonomik të një vendi, duke përfshirë vlerën totale të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara brenda një periudhe të caktuar. GDP ndihmon në vlerësimin e rritjes ekonomike dhe shëndetit të përgjithshëm ekonomik të një vendi.
- **Kursi i Këmbimit Euro/Lekë:** Ky kurs përfaqëson vlerën e një njësi të monedhës euro në terma të monedhës vendase, lekut shqiptar. Është i rëndësishëm për të monitoruar ndikimin e lëvizjeve të kursit të këmbimit në tregtinë ndërkombëtare dhe inflacionin, si dhe për të analizuar efektet e politikës monetare dhe ekonomike.

2.3. Modeli ekonometrik

Për të realizuar objektivin e studimit, fillimisht janë përdorur metoda sasiore, mbi bazën e të cilave është ndërtuar një model ekonometrik për të matur ndikimin e variablave të pavarur.

Modeli i regresionit të shumfishtë është një model më se i përshtatshëm për të kryer një analizë me një ose më shumë variabla përcaktues.

Modeli i regresionit të shumfishtë është një zgjerim i modelit linear të thjeshtë, i cili përfshin një numër më të madhë variablash të pavarur. Formulimi bazë për një model të tillë është:

$$y_i = \beta_0 + \beta_1 x_1 + \beta_2 x_2 + \dots + \beta_k x_k + \epsilon$$

ku, për $i=n$ vëzhgime:


- y_i : variabli i varur
- x_i : variablat e pavarur
- β_0 : intercepti (termi konstant)
- β_0 : koeficientët e pjerrësisë për çdo variabël shpjegues
- ϵ : termi i gabimit të modelit (i njohur gjithashtu si termi i mbetjeve).

3. Paraqitja Dhe Analizimi i Të Dhënave

Rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP growth) tregon variacione të konsiderueshme gjatë periudhës. Duke filluar me -2 në tremujorin e parë të vitit 2005, GDP ka kaluar nëpër faza të ndryshme rritjeje dhe rënieje. Periudha e vitit

2020 tregon një rënie të ndjeshme, me GDP që bie në -8.7 në tremujorin e dytë, ndoshta për shkak të ndikimeve të pandemisë COVID-19. Pas kësaj, GDP fillon të rimëkëmbet dhe arrin në 0.79 në tremujorin e katërt të vitit 2023. Këto ndryshime reflektojnë ndikimet e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në ekonominë shqiptare. Një GDP negativ tregon një tkurrje ekonomike, ndërsa një GDP pozitiv tregon rritje. Lulatjet në GDP mund të ndikohen nga faktorë si ndryshimet në konsum, investime, shpenzimet qeveritare dhe eksportet neto. Për shembull, rënia e GDP gjatë pandemisë mund të lidhet me kufizimet e vendosura për të parandaluar përhapjen e virusit, që ndikuan në aktivitetin ekonomik. Rimëkëmbja e mëvonshme mund të jetë rezultat i lehtësimit të masave dhe stimulit ekonomik të qeverisë.

Figura 3.1: Norma e rritjes së PBB-së së Shqipërisë



Burimi: tradingeconomics.com

Në figurën 3.2 shikojmë se nga viti 2005 deri në vitin 2023, masa monetare (M3) shfaq një trend rritës të qëndrueshëm. Në fillim të periudhës, në tremujorin e parë të vitit 2005, M3 ishte 514.67 dhe arriti në 1666.67 në tremujorin e katërt të vitit 2023. Kjo rritje e vazhdueshme mund të reflektojë një politikë monetare ekspansive ose rritjen e aktivitetit ekonomik dhe kërkesës për para në Shqipëri. Ndër faktorët që mund të kenë ndikuar në rritjen e M3 janë shtimi i kreditimit, rritja e depozitave në sistemin bankar dhe stabiliteti makroekonomik. Një ofertë më e madhe e parasë në qarkullim mund të nxisë konsumin dhe investimet, duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike të vendit.


Figura 3.2: Oferta e parasë për Shqipërinë



Burimi: tradingeconomics.com

Investimet e huaja direkte (FDI) tregojnë variacione të mëdha gjatë periudhës së studiuar. Në tremujorin e parë të vitit 2005, FDI ishte 45.33 dhe arriti kulmin në tremujorin e tretë të vitit 2007 me 220.35. Megjithatë, pas kësaj, FDI tregon një luhajtje të konsiderueshme me rritje dhe ulje të ndjeshme, duke arritur në 401.94 në tremujorin e katërt të vitit 2023. Këto ndryshime mund të reflektojnë faktorë të ndryshëm ekonomikë dhe politikë, si stabiliteti ekonomik, politikat qeveritare dhe atraktiviteti i tregut shqiptar për investitorët e huaj. Për shembull, periudhat me rritje të FDI mund të korrespondojnë me përmirësime në infrastrukturë, reformat strukturore dhe përpjekjet për tërheqjen e investimeve. Ndërsa uljet mund të jenë pasojë e krizave globale, ndryshimeve në legjislacion ose problemeve politike dhe ekonomike të brendshme.

Figura 3.3: Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri



Burimi: tradingeconomics.com

Të dhënat statistikore në tabelën 3.1 ofrojnë një pamje të detajuar të disa treguesve kryesorë ekonomikë të Shqipërisë, duke përfshirë sasinë e parave (M3), investimet e huaja direkte (FDI),

Britjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP), kursin e këmbimit (euro/lekë), dhe bilancin tregtar. Mesatarja e sasisë së parave (M3) është 1,112.87 miliardë lekë, duke treguar një nivel të konsiderueshëm të likuiditetit në ekonomi, ndërsa investimet e huaja direkte arrijnë mesatarisht 217.68 milionë euro, që tregojnë një interes të vazhdueshëm të investitorëve të huaj. GDP-ja mesatare prej 0.87 miliardë lekë është një tregues i rritjes ekonomike, megjithatë, varion ndjeshëm me një devijim standard prej 2.54, duke reflektuar luhajtjet në aktivitetin ekonomik. Kursi mesatar i këmbimit prej 129.42 lekë për euro ilustron stabilitet relativ, megjithëse variacioni prej 37.54 tregon luhajtje të konsiderueshme gjatë periudhës së studiuar. Bilanci tregtar mesatarisht negativ, me një deficit prej -80,776,065,722 lekësh, tregon për një disbalancë të vazhdueshme midis eksporteve dhe importeve, duke theksuar nevojën për përmirësimin e konkurrencës dhe eksportit. Shpërndarja dhe asimetria e treguesve reflektojnë karakteristikat e ekonomisë shqiptare, ku kurtosis negativ për M3 dhe FDI tregon një shpërndarje më të sheshtë se shpërndarja normale, ndërsa GDP-ja me kurtosis të lartë tregon prani të pikave ekstreme. Skewness tregon një asimetri të lehtë në të dhëna, me bilancin tregtar që ka një asimetri negative të fortë. Rangu i gjerë i treguesve, veçanërisht për bilancin tregtar dhe FDI, ilustron variacionet ekstreme dhe sfidat e përballura në këto fusha. Minimumi dhe maksimumi i treguesve ofrojnë një pamje të qartë të ndryshimeve dramatike që mund të ndodhin në ekonominë shqiptare, duke theksuar nevojën për politika ekonomike të qëndrueshme dhe të mirë-strukturuara për të përmirësuar stabilitetin ekonomik dhe rritjen e qëndrueshme

Tabela 3.1: Statistikat përshkruese mbi variablat

	Money supply (M3)	FDI	GDP	Exchange rate (euro/leke)	Trade Balance
Mean	1,112.87	217.68	0.87	129.42	-80,776,065,722
Median	1,156.67	232.42	0.95	127.03	-80,943,669,618
Standard Deviation	315.71	87.55	2.54	9.15	18,894,373,677
Kurtosis	-0.72	-0.31	6.08	-0.41	2
Skewness	-0.13	-0.19	0.21	-0.42	-1
Range	1,152.00	360.91	20.40	37.54	104,323,902,793
Minimum	514.67	45.33	-8.70	104.21	-141,901,854,997
Maximum	1,666.67	406.24	11.70	141.75	-37,577,952,204

(këngët e lindjes e të djepit), këngët e ceremonialit të dasmës dhe vajet kanë shoqëruar ritualet e tri ngjarjeve më të spikatura të jetës njerëzore: lindjes, martesën dhe vdekjes. Çdonjëra nga këto ngjarje të jetës sonë ka pasur "protokollin" ceremonial në mundësitë tradicionale popullore me ritualin shpirtëror të gëzimit e festimit (në lindje dhe në martesë) dhe të hidhërimit e vajtimit (në vdekje) nëpërmjet poezisë popullore të kënduar (muzikës, instrumenteve) dhe të vallëzimit popullore (kërcimit në grup, hedhjes së valles labe), "krahas veshjes, mjedisit, kohës dhe hapësirës së praktikimit" [5]. Për realizimin e këtij punimi, përveç njohjes tërësore të traditës folklorike, pasurimit dhe përditësimit të polifonisë labe të Lumit të Vlorës, aplikimit të metodës etnografike të vëzhgimit me pjesëmarrje në terren, kemi shfrytëzuar edhe botime të nivelit akademik, të tilla si: "Këngë popullore lirike", Instituti i Shkencave, Tiranë, 1955; "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912), 2: "Bëleta shqypëtare, 1" mbledhur e botuar nga Thimi Mitkua më 1878", Instituti i Folklorit, Sektori i Folklorit Letrar, 1961; botimet e Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Sektori i Etnografisë: "Etnografia shqiptare", 1/1962 dhe "Etnografia shqiptare", 4/1972; "Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, 3" (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1970; "Lirika popullore, 4", Akademia e Shkencave e RPSHSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1990; "Mbledhës të folklorit. Këngë popullore të Labërisë", vëll. 8, përgat. Fatos Mero Rrapaj, Akademia e Shkencave e RPSHSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1991; "Etnologjia dhe folklori shqiptar": Agron Xhagolli; Vlorë, Triptik, 2007; "Kënga popullore e Lumit të Vlorës": Bardhosh Gaçe; Tiranë, Toena, 2009, si dhe tekste të tjera të rëndësishme lokale, por që plotësojnë dhe freskojnë burimet e nevojshme të informacionit folklorik. Pa dyshim që është edhe mundësia konkrete e bartjes, praktikimit nëpërmjet zërit/tekstit, muzikës/ melodisë, kërcimit në valle, patjetër e transmentimit në komunitet, pranimit e pëlqimit edhe nëpërmjet qasjes në kohë të poezisë popullore zonale, si pasqyrim artistik nga Ansambli i Vajzave të Tërbaçit, për të cilin jemi drejtues artistik dhe autor kryesor i teksteve të kënduara që nga themelimi i tij dhe që është një grup unikal në Labëri dhe ndër të rrallët në Shqipëri dhe Ballkan, duke identifikuar vulën folklorike të Polifonisë Femërore.

2. Këngët e lindjes dhe ninullat

Vargu i gëzimeve e kënaqësive për familjen është i madh. Lindja e fëmijës ishte çast i veçantë në jetën familjare dhe të farefisit. Lindja bëhej nën kujdesin e grave të moshuara e me përvojë që u thoshin babo. Kur lindëte fëmija, gratë e farefisit dhe ato fqinjë i shkonin lehonës me gjellë të ngrohta, petulla, peta, rosnica e ëmbëlsira, të natyrës që nxisnin dhe qumështin e nënës së re. Prindërit e lehonës, sidomos kur lindte për herë të parë, i përgatisnin djepin, shpërgënj leshi, këmishë etj. Sidomos kur lindte djalë, gëzimi ishte më i thellë dhe kur ai lindte në orët e vona të natës, si rregull qëllohej me pushkë, për gëzim e hare, por edhe për sihariq, që të merrte vesh fshati, se diku ka lindur një djalë. Djali vlerësohej si trashëgimtar, si mbrojtës, për të marrë hakun. Babëzoti (gjyshi), kur nipi mbushte 16-17 vjeç, sipas traditës, i blinte dyfekun. Pas tri ditësh nga lindja, (sipas rastit dhe pas pesë ditësh apo më vonë) organizohej ceremonia e vënies së emrit. Bëhej një kulaç gruri, në të futej një monedhë ari ose argjendi dhe, kur ndahej pjesë -pjesë kulaçi, ai që gjente monedhën kishte të drejtën e vënies së emrit. Në disa fshatra praktikohesh me disa letra, ku në çdonjërin shënohej një emër për fëmijën. E ëma e fëmijës tërhiqte njërin nga letrat dhe emri i shkruar në të mbetej për jetë lexohej, tregohej dhe ishte emri që fëmija do të kishte për jetë. Kur flasim për doket e zakonet, duhet të kujtojmë se kishte fshatra si Tërbaçi, Vranishti, zona e Rrëzës së Mesaplikut etj., ku emri vihej nga dajua ose nga të parët e familjes së burrit apo të gruas. Aplikohej dhe me anë të shortës (llotari). Kur caktohej emri, merrej një tepsit me bukëvale dhe kalohej në të gjithë të pranishmit, të cilët uronin dhe duke hedhur para sidomos ai që i kishte vënë emrin. Disa nga motivet kryesore që trajtojnë këngët e lindjes e ninullat janë: ëndrra e gruas për t'u bërë nënë, e familjes për t'u konsoliduar e zmadhuar, dëshirat e nënës, ëndrrat dhe pëfytirimet e prindërve për mirërritjen dhe të ardhmen e fëmijës.

Në klasifikimin hierarkik të poezisë popullore (me tri ndarjet e veçanta: epike, lirike dhe epiko-lirike apo liriko-epike), këngët e lindjes e të djepit (ninullat, nina - nanat), grupohen në gjininë e poezisë lirike, më ngushtë në nënndarjen e lirikës familjare. Në lirikë zotëron pasqyrimi i botës së brendshme shpirtërore, ndjenjave e përjetimeve intime, aq më tepër në lirikën familjare, ku shpirti i njeriut konkurron me thëllëzat e bilbilat. Nusja kërkohet nga derë e parë, sojllëshë e soj pjellor. Sidomos me lindjen e djalit, nusja konsiderohej pjesëtare e denjë e familjes dhe për këto raste thuhej, "nusja ka zënë rrënjë". Edhe për banorët e Lumit, këngët e

lindjes dhe ninullat bëjnë pjesë në folklorin e ciklit të jetës individuale dhe familjare. Nga që nuk mund të hapemi në këngët e paralindjes, theksojmë çka vërejmë në këngët e lindjes. Kemi të bëjmë me dy personazhe kryesore, me nënën dhe fëmijën, pasi këngët e lindjes bëjnë fjalë për lehonën dhe lehoninë, për vënien e emrit të fëmijës, për ardhjen e qumështit tek lehona - nënë, për ngritjen e fëmijës në këmbë etj. Kanë arritur deri në kohën e nënave tona reminishenca të praktikave të lashta rituale si tërësia e veprimeve të jashtme, që bëheshin në mënyrë të rregullt e të pandryshueshme për të kryer ç'ka besohej për t'i ardhur qumësht lehonës. Kujtojmë që ajo ngrihej herët në mëngjes, merrte një gjym, pak bukë e qepë dhe shkonte te kroji a te burimi me ujë të rrjedhshëm. Kur mbërrinte tek uji, lagte bukën e qepën, i kafshonte nga pak dhe e vinte gjymin të mbushej. Ndërkohë, për t'i ardhur qumështi thoshte dhe vargje si këto: "*Vito, vitë, moj xhanë,/ Fati im, o bukurë/ Kam lindur një djalë flori/ Sillma qumështin në gji*" etj. Siç vërejmë teksti këtyre këngëve është lakonik, që vjen përmes një gjuhe të thjeshtë e të qartë. Elementët përbërës të këtyre këngëve, veçanërisht shoqërimi i tekstit me melodinë, sado e thjeshtë qoftë ajo, mbështetin figurshmërinë, ëndrrën, dëshirat për një jetë sa më të lumtur të foshnjës që sapo lind e rritet. Në sotmëri, edhe pse ka ndryshuar shumë pozita sociale e femrës, që bëhet nënë dhe këngët e lindjes janë një lloj mjaft i rudimentuar i lirikës familjare, përsëri ato janë të natyrshme e vijnë origjinale, pakrahueshmërisht me kënd, se dalin së brendshmi, si i thuren e këndohen trupit të njomë, gjakut, shpirtit, krijimit më të mrekullueshëm në botë të nënës së re.

2.1. Këngët për të "mos hëngër me sy" fëmijën dhe yshtjet

Edhe ne e mbajmë mend ritualin e prerjes së flokëve të fëmijës. Paraqet interes jo thjesht si akt i kalimit të tij në shoqërinë njerëzore, por kohë më të hershme, si dëshmi e ndërprerjes së lidhjeve të fëmijës me të keqen, si sëmundjen, vdekjen etj. po paraqesim tri njësi folklorike, regjistruar në Tërbaç nga studiuesi B. Gaçe, më 1988: 1- "*Syri i zi,/ Në ngjill të zi;/ Syri i kuq,/ Në ngjill të kuq;/ Syri i bardhë/ Në ngjill të bardhë*" [6]. Fjala dialektore *ngjill* ka kuptimin *thëngjill*. Kur dyshohej se një fëmijë ishte marrë mësysh, për të individualizuar sykeqin, e ëma apo një distare (plakë me përvojë, e largët) i shuante thëngjij të ndezur në një enë me ujë. Distarja vinte përpara enën, zbulonte zjarrin që e kishte mbuluar me hi në vatër të shtëpisë dhe merrte me një mashë në formë bige thëngjijit për t'i

hedhur në ujën e enës. Para se të vepronte kështu, për çdo thëngjill thuhej emri i atij për të cilin dyshohej se ka marrë mësysh fëmijën. Po qe se thëngjilli qëndronte mbi sipërfaqen e ujit i dyshuari ishte i shfaqur, por në qoftë se thëngjilli binte në fund të enës, besohej se ai ishte fajtor. Sa herë që shuheshin thëngjijtë pëshpëriteshin vargjet e sipërcituara.

2- "Syri i zi/ Ndër fëmi,/ Hëngërt mua/ Hëngërt ty! Yfff! Yfff!***/ Në thëngji,/ Dy thëngji./ Fluturoi/ Syri i zi!/ yfff! Yfff!" [7]. Distarja mbante përpara sapllakun me ujë dhe thëngjij (kongjij) të shuar, i hidhte së ëmës së fëmijës nga ky ujë në sapllakun e saj dhe e porosiste që, sapo të vinte në shtëpi, t'i jepte fëmijës të pijë pak nga ky ujë, pjesën tjetër ta derdhë në një faqe muri ose t'ia hidhte pulës mbi kurriz që të shkundet. Ashtu si shket uji në faqen e murit ose nga kurrizi i pulës, ashtu besohej se do t'i shkiste e liga apo syri i zi edhe fëmijës. E gjithë kjo përsëritej tri herë. 3- *Viçi dem e demi kà,/ Vasha yll e si pasha,/ I plaçin syt' atij q'e ha , / Mo gjet' rehat në kët' dynja*". Këto vargje distarja ia thotë një fëmije, vajzë apo djalë që është marrë mësysh nga bukuria. Ajo priste një tufë flokësh nga të djalit apo të vajzës dhe fillonte ta yshte pa zë, që "të mos ia vidhnin formulën", kështu thuhej. Gjatë yshtjes gogësinte dy - tri herë për të treguar se fëmija kishte marrë vërtet sy të keq. Yshja ishte një ritual që e bënin plaka të caktuara e të njohura me fjalë a shprehje, që shqiptoheshin kur yshtnin dikë të yshturat (sipas besëtytnive). Paralelizmi me rrezikun, që mund t'u kanosej edhe kafshëve shtëpiake nga syri i keq, tregon për qëndrueshmërinë dhe universalitetin e këtyre besimeve në mendësinë tradicionale të popullit. Folkloristi Fatos M. Rrapaj ka shënuar një variant të ngjashëm në Dukat të Vlorës, që përdoret për të yshtur një djalë. Këto lloj këngësh në formë pëshpëritje me zë e jo pak herë me frymë sot mund të quhen relikte etnofolklorike, nga ku mund të ketë mbetur e shfaqet ende ndonjë atavizëm rritesh nga plakat e vjetra në malësitë e Lumit.

2.2 Ninullat ose këngët e djepit

Si kudo, edhe në Labërinë e Lumit të Vlorës, ninullat janë burimore dhe bëjnë ende jetë aktive, funksionale, monofonike dhe janë prurje të pasura folklorike. Ninullat, si shprehje me elementë letrarë e muzikorë, të praktikuara për të vënë fëmijën në gjumë, për një rritje të qetë e të shëndetshme, kanë ndikuar për të përdorur një gjuhë të ëmbël, të figurshme, sepse fjalët sikur janë zëdhënësë të shpirtit të nënës. Fëmija e bën nënën vetvetiu këngëtare e nëna tradicionalisht ka kënduar për fëmijën e për veten e saj, duke shfaqur botën e brendshme, ku

sundon e bukura. Nënata tradicionalisht kanë dëshiruar për fëmijën. Kjo ëndërr njerëzore mbështetet gjithnjë nga parimi estetik i zbulimit, që është dhe një nga "ligjet" e pashkruara të folklorit. Na vjen deri në kohët e sotme një këngë djepi e vjetër, kënduar nga nënat e malësisë së Lumit: "*Shkojnë zoqtë palë-palë/ T'i sjellin djalit fjalë./ Shkojnë zoqtë gur më gur./ T'i sjellin djalit gjumë./ Të rritet, të bëhet burrë*" [8]. Nga këto vargje marrim mesazhin që nëna e do djalin që të bëhet i zoti, burrë trim, i pari fshatit, t'i rritet, ta martojë e ta gëzojë bashkë me të, prandaj nga zemra i buron urimi me gurgullimë të kulluar. Shpesh herë ninullat transferoheshin shabllon, klishe nga stërgjyshet, gjyshet e nënat e nënave të reja, duke hequr apo shtuar vargje sipas dëshirës. Qysh në vargjet e para të këtyre këngëve ndihet nevoja e komunikimit të nënës a gjyshes me fëmijët e vet, për ta vënë fëmijën në gjumë nga njëra anë e nga ana tjetër për të shpalosur ndjenjat e saj në formë monologu me fëmijën, me dëshirën për t'u ngjarë figurave të njohura historike të Lumit si Gjoleka i Kuçit e Miro Tërbaçja. Ja dy njësi që kemi vjelur në terren në vjeshtën e vitin 1979, në Kuç nga bartësja Shaho Luçi: "*Llaj-llaj e nina nina./ Djali lidhur në skutina./ Skutinat i mori Lumi/ Dhe djalin e zuri gjumi./ Rritu, bir, si lisi me dega./ Të më bëhesh si Gjoleka*" [9]; në Tërbaç nga bartësja Shero Lushaj (1912-2012): "*Nina-nina vajzën-o,/ Që e kam të vogël-o./ Rritma, Orë me sahat,/ Ma faltë zoti, ma faltë,/ Suferinë në majë të kalit./ T'i ngjashë Miro Tërbaçit*" [10], e cila ia këndonte vajzës së vetme. Ninullat me pak vargje shprehin shumë dashuri nëna me fjalë të thjeshta të drejtpërdrejta. Ja një tjetër ninullë regjistruar në Gjorm, 1965, nga bartësi Hysen Seitaj (86 vjeç): "*Ndihet era verë,/ Erë trëndafil,/ Në shtëpinë tonë,/ Mbiu karafil,/ Mbiu djalë i bukur,/ Si yll i këputur*" [11]. Nga Nertesi Asllani (1959-2019, me arsim të mesëm), krijues, bartës dhe aplikues i këngës labe të Bolenës (Kurveleshi i Poshtëm i Lumit), na vjen si stafetë e traditës në kohë të re ninulla: "*Llai-llai e nina-nina,/ Djalin-o, nina-nina./ Rritu djalë si hardhia,/ Se kërkon zot shtëpia,/ Unë jam vetëm me tyja,/ Se yt atë për dy stërlina,/ Mbeti tej në shkretëtira,/ Rritu se të pret martina,/ Të luftosh bashkë me trima,/ T'i thuash armikut prina,/ "Llai-llai e nina-nina,/ Djalin-o, djalin-o,/ Nina-nina..."*", që u këndua aq bukur, ëmbël, me dashuri gjaku e shpirti nga magjicka e trëndelintë Fatbrdha Hosi Brahimi, laureate e Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, tetor, 1988. Nusja e re labe ëndërronte një djep të vogël, që ia sillte dera e babait tek e përkundëte thoshte me një këngëzim përkëdhelës të vargjeve që improvizonte: "*Po vjen djepi nga Janina,/ Vjen me dymbëdhjetë*

trima". Fëmija duhej patjetër të rritej trim ose trimëreshë. Po në përkundjet e tyre nënat e uronin fëmijën të bëhej pallua ose pëllumb, çoban i zgjedhur, trim e i mençur: "*Rritu djalë nina-nina,/ Rritu se të pret martina*". Ninulla është e përzier me ëmbëlsinë dhe krenarinë për fëmijën. "Në këto këngë, zakonisht të shkurttra, del përgjithësisht dëshira e nënës që fëmija të jetë i shëndetshëm e i pashëm, ndaj e fillon atë me një grishje të gjumit: "*Shkojnë zogjtë turmaturma,/ Venë e pinë ujë në lumë,/ Djalit të m'i bien gjumë,/ Shkojnë zogjtë çeta-çeta,/ Mbi lulet ku kullon blea,/ Shkojnë e marrin ujë në det,/ Djalit t'm'i bien shëndet*" [12]. Dhe pse ninullat e djepit janë rrudhur, nuk janë pjesë e arkivit folklorit. Janë rudimentuar, sepse nënat kanë dekada të tëra që janë të zëna me punë jashtë shtëpisë dhe kanë një pozicion të ndryshëm civilizues dhe ekonomik në familje, të vegjëlit rriten në çerdhe apo nga njerëz të tjerë (dado, gjyshe), koha e qëndrimit të nënës me beben është tkurrur, ka mjete të tjera që zëvendosojnë praninë e domosdoshme për ta vënë në gjumë fëmijën. Ka ndryshim në strukturën e të kënduarit, të tekstit, veshjes, djepi pothuaj nuk egziston as në malësitë e thella të Lumit, ka ndryshuar mënyra e jetesës në familje, por jo raporti afektiv nënë - fëmijë (një raport i përzemërt e i pëmallshëm, i dashurisë sa të shtrenjtë aq shenjtërore, shën. ynë: A. H.).

E quajmë fatmirësi jo vetëm folklorike ekzistencën e një grupi të përbërë vetëm nga femra (nëna e gjyshe) sikurse është Ansambli "10 Shqiponjat e Tërbaçit", në grup unikal i Polifonisë Femërore. Pa u futur në komente a interpretim, po paraqes për Buletinin shkencor të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë një prurje të re në këtë lëmë. Është ninulla. Ajo vjen me dymotërzime. E para është Ninulla e Vajzës "*Thëllëzo, të keqen nëna*" interpretuar mjeshtërisht nga Shpresa Kapo Çelaj, shoqëruar nga Shqiponjat e Tërbaçit në sfond me jehonë isoje nga Liri Gaçe Shkurtaç, Vito Shiroku Vera, Liljana Rrapi Kapo, Evgjeni Habili Seferaj, Flutura Nanaj, Lavdie Goxho Xhakaj, Hava Çelaj Muçaj. Në Festivalin X të Polifonisë në Bylis, 24-25.09.2021, ninulla e Shqiponave të Tërbaçit u vlerësua: "Homofoni e rrallë" nga Juria e festivalit e përbërë nga Zhani Ciko, Daut Gumeni dhe Golik Jaupi; ndërkohë që u shqua si një ndër paraqitjet folklorike më të pëlqyera nga publiku artdashës, mbështetur në burim, në gurrën popullore dhe interpretuar me aq dashuri, pasion, shpirt e nivel të lartë artistik nga Artistja e njohur popullore, mësuesja Shpresa Kapo Çelaj. Drejtues artistik dhe teksti: Albert Habazaj. Ja teksti: "*Llaj - llaj, nina - nina,/ E llaj - llaj e nina - nina!/ Thëllëzo, të keqen nëna,/ Për ty lule më çel kënga./ Llaj - llaj, nina - nina,/ E llaj,*

llaj llaj e nina -nina!/ Me ty vallëzojnë ëndrrat/ Për ty diell më ngroh kënga./ Llaj - llaj, nina - nina,/ E llaj, llaj llaj e nina - nina!/ Me mua këndon dhe hëna/ Bijë, o bij', të të keqen nëna./ Llaj - llaj, nina - nina,/ E llaj, llaj llaj e nina - nina!/ Të keqen nëna, të keqen/ Mjalt' e hoje, qumësht blea./ E llaj -llaj, nina - nina/, E llaj, llaj llaj e nina - nina!/ O gjerdan i art' për gushe/ Shtëpinë me drit' e mbushe./ E llaj - llaj, nina - nina,/ E llaj, llaj llaj e nina - nina!/ Lule mali, lule fushe/ O syr' i bukur drenushe./ Llaj - llaj, nina - nina,/ E llaj, llaj llaj e nina - nina!/ Gjum' i ëmbël, gjum' i bardhë/ Mbi ball' të djepit ka ardhë./ Llaj - llaj, nina - nina, E llaj, llaj llaj e nina - ninaaa! [13]

Pra, si kudo në familjet shqiptare, brenda dhe jashtë kufijve zyrtarë, edhe për familjet labe të Lumit, fëmija ka qenë, është e do të jetë "gonxhja më e jetës". Kjo ninullë nis si monofoni, siç ka qenë dhe tradita e ninullave në Labëri e kudo në Shqipëri, ku nënat e gjyshet u këndojnë ferishtevë, bebushave, engjëlleshëve tanë aq të ëmbël e të njomë. Qysh në përsëritjen e refrenit pas vargut të parë, futet grupi me një iso qiellore, që realizon një harmoni polifonike të mrekullueshme.

Varianti tjetër është Ninulla Polifonike e Djalit "*Qumësht blete, mjaltë zgjoi*", e cila u paraqit siç i ka hije grupi "10 Shqiponjat e Tërbaçit" në Festivalin Folklorik Kombëtar (FFK) të Gjirokastrës 2023, natën e dytë të Festivalit, të dielën e 25 qershorit, si pjesë integrale e Ansambllit të Qarkut të Vlorës.

Fuqia e imazhit të kësaj prurjeje, sa të lashtë, aq moderne dhuroi emociione të veçanta tek të pranishmit e shumtë. Kemi parë e dëgjuar që ninulla interpretohej nga një grua. Po, por kur gëzimi merr përmasa tutje, edhe shpirti i nënës a gjyshes i shpërndan tingujt në familje, në fis, në mëhallë, në lagje, në fshat, përtej lumit e përtej malit dhe mblidhen graria me harë se do t'i vihet emri djalit (në rastin e kësaj paraqitjeje), apo vajzës sipas rastit të lindjes. Ato (hallat, tezet, krushka, kunatat, apo gjitonet etj.) nuk mund të rrinë statike në skenë, sepse në fakt, te vatra familjare ato nuk rrinë në heshtje, të palëvizshme në shiltë apo lëshje ku janë ulur, apo në këmbë, sipas rastit, ato s'ka sesi të mos e shfaqin kënaqësinë e tyre, kur gjyshja tund djepin e nanuris beben. Kjo ninullë (që në festivalet e mëparshme, së shumti, është paraqitur si interpretim monofonik) erdhi e pasuruar me elementin polifonik, sepse gratë kanë disa vjet që e kanë diskutuar këtë gjë me njëra-tjetrën (të dhjeta janë nëna dhe gjyshe), kanë pyetur nënat apo vjehërrat e tyre (ato që i

kanë ende fatlumturisht), kanë pyetur dhe më tutje në mëhallë e miqësi, e kanë bërë prova shumë herë, e kanë prurë në "gonenë" e saj, e kanë pëlqyer vetë, e kanë kënduar për të tjerët (në skena kanë dalur vetëm me një ninullë vajze) dhe publiku e ka pëlqyer dhe vlerësuar në disa veprimtari të rëndësishme folklorike si në Kukaj- Prishtinë, Bylis, Horë dhe Vlorë, ku kanë fituar admirim, duartrokitje dhe çmime). Kjo ishte risia e kësaj ninulle, që kur gjyshe Shpresa vë djalnë në gjumë duke i kënduar e duke e përkundur në djep, gëzimtaret, artistet popullore nga Tërbaçi e shoqërojnë atë ëmbël, lehtë, me zë koke, siç dinë ato, që kanë bërë e rritur fëmijë, nipër e mbesa. Si të thuash, e përjetojnë gëzimin, kënaqësinë e qetësinë e gjyshe, e shoqërojnë atë, se ndaj kanë ardhur, që ta ndajnë së bashku gëzimin dhe kështu derë më derë. Mësuese Shpresa, tashmë gjyshe dhe artiste popullore, së bashku me simotrat e saj, që përbëjnë ansamblin sa simpatik aq dinjitoz "10 Shqiponjat e Tërbaçit" i falën magjinë fisnike të shpirtit të tyre të bardhë festivalistëve dhe artdashësve që kishin mbushur Kalanë atë mbrëmje të ngrohtë qershori me këngën e djepit për kapedanin e vogël që u ndriti derën...Ato janë artiste të vërteta popullore që ditën ta mbanin ndezur me ngjyra të ngrohta dhe të ëmbla shpirti atë natë gjirokastrite, duke i dhënë kështu më shumë hijeshi dhe emancipim Detashmentit folklorik të Qarkut të Vlorës. Faleminderit Shpresa Kapo Çelaj, Liri Gaçaj Shkurtaç, Antoneta Goxho Mehmetaj, Lirjana Rrapaj Kapaj, (Hava Çelaj Muçaj), Meme Ribaj Habazaj, (Evjeni Habili Seferaj), Flutura Nanaj, Fatmira Hodo Skendaj, Lavdie Goxho Xhakaj, aq virtuozë si bartëse, ruajtëse, pasuruese dhe përçuese në breza të traditave më të mira të stërgjyshërve, gjysheve, nënave dhe thesaret e shpirtit të tyre, se janë nëna e gjyshe të lumtura, që u këndojnë ninulla/ këngë djepi aq ëmbël, ngrohtë e me dashuri si ato nipërve dhe mbesave të tyre, siç u buron urimi nga shpirti i tyre aq i pasur e i pastër. Kjo është tradita e burimit, kjo është kultura popullore e kultura kështu bëhet dritë dhe ato bëjnë dritë shpirti e janë të ndritura. Ato u shfaqën siç janë, përcjellëse dinjitoze të vlerave folklorike burimore të trevës, trashëguar nga stërgjyshet, gjyshet dhe nënat e tyre, që dhe vetë po i çojnë më tej, se janë vetë nëna shembullore e gjyshe të

mrekullueshme, artiste të vërteta. Një interpretim brilant në harmoni me një veshje që shkëlqen, ky kostum ceremonial vërtet dinjitoz, stafetë e pasuruar e veshjes popullore për gratë tërbaçote, ardhur sipas Historikut të Tërbaçit, të paktën që nga shek. XVII. "10 Shqiponjat e Tërbaçit" përçojnë brezave ato tradita të bukura, që zanafillën e kanë në këngët e djepit, në vënien e emrit, në jehonën e gëzimit, që buron nga shpirti, se lindi një jetë, një djalë (në rastin e ninullës "Qumësht blete, mjaltë zgjoi" e gjyshja e ndan me familjaret e më tutje. Ta marrë vesh bota që nusja lindi djalë!... Janë vargje lakonike, vetëm 10 vargje (5 strofa dyshe) të thjeshta, jo bombastike, por të dala nga gurra e zemrës në 2' e 16"[14].

Ninulla e "10 Shqiponjave të Tërbaçit" me Shpresën është vlerësuar si "Tjetër arritje në artin folklorik". Një ninullë për kopertinë, një mrekulli madhështore jo vetëm në llojin e vet, një numër i rrallë, që i dha shkëlqim të ëmbël dhe të ngrohtë skenës dhe kalasë së festivalit. Fjalë nga më të mirat dëgjohmë për grupin "10 Shqiponjat e Tërbaçit": "Të mrekullueshme. U trashëgofshin brez pas brezi traditat, kultura dhe pasuria jonë folklorike!"

Në fakt, ku ka më mirë se t'i këndosh si "10 Shqiponjat e Tërbaçit", aq bukur e me shpirt mjaltit të mjaltit!

Si bartëse të rralla të vlerave folklorike të krahinës së Labërisë, ishte misioni që duhet realizuar me ninullën dhe pikërisht nga ATO, 10 SHQIPONJAT E TËRBAÇIT e kryen përsosmërisht.

Ja dhe teksti:

QUMËSHT BLETE, MJALTË ZGJOI

Ninullë/ këngë djepi

Teksti: Albert Habazaj

Këndon (monofoni): Shpresa Kapo Çelaj [Kjo ninullë interpretohet nga Shpresa Kapo Çelaj, si folklor dhe etnologji shoqëruar nga "10 Shqiponjat e Tërbaçit" me mizanskenë – një sfond femëror me atmosferë shtëpie: nusja çon djepin vjehrrës të nanuris nipin për ta vënë në gjumë dhe pastaj shkon te zonjat/ gratë e plakat e shtëpisë: kunatat, hallat, tezet ..., të cilat, me zë të ulët mund të bisedojnë, bëjnë natyrshëm punë dore e shprehin gëzimin me hove të ngrohta e të ëmbla melodike: Liri Gaçe Shkurtaç, Antoneta Goxho Mehmetaj, Liljana Rrapaj Kapo, Meme Ribaj Habazaj, Evjeni Habili Seferaj, Flutura Nanaj, Lavdie Goxho Xhakaj, Hava Çelaj Muçaj.

[në sfond me mbushje me zë koke, si mërmërimë e ëmbël që merr jehonë për të

dhënë një mesazh me iso gurgulluese: "O shoqe, o motra, o nëna! Një djalë na erdhi në jetë" ...]

*Nina - nina djalit-ë,
O ëngjëll i vogël-ë!
Llaj-llaj e nina-nina!* [ref.]
*O lezeti ynë në djepe
O yll i bukur me cepe.
O gjerdan i art' për gushe
Shtëpinë me drit' ma mbushe.
Qumësht blete, mjaltë zgjo,
Të më bëhesh si dragoi!
Gjum' i ëmbël, gjum' i bardhë
Mbi ballë të djepit ka ardhë!*

3. Këngët e dasmës

Edhe në familjen labe të Lumit, sidomos në shtëpinë e dhëndrrit, veç jo më pak dhe në të nuses, ceremoniali i dasmës, d.m.th. i martesës, lidhjes për jetë të një çifti të ri është gëzimi më madhështor në jetën dokesore (zakonore) të banorëve. Studiuesit nënvizojnë se elementët e dasmës vijnë si shprehje e njësisë së kulturës shpirtërore (jomateriale) të banorëve të trevës. Gëzimi në këngë e valle, larmia e ngjarjeve të bukura, kujdesja deri në detaje për veshjen, gatesat, aplikimin e riteve tradicionale dhe më të reja të ngjashme vijnë për një sërë arsyesh emocionale, sociale e psikologjike, duke ruajtur ende elementë që i kanë rezistuar kohërave nga Kanuni i Labërisë për këtë çast të veçantë të jetës dhe kulmit të gëzimit të çiftit. Aty hidheshin themelet e një shtëpie të re dhe krijohej bërthama familjare. Dasma fillonte që kur fillonte që kur caktohej dita e marrjes së nuses, duke filluar kënga dhe vallja. Edhe sipas prof. Sakos, "një nga zakonet rituale të ceremonialit të dasmës, më i rëndësishmi, ka qenë zënia e brumit" [15]. Bëhet fjalë për kulaçin e nuses, që gatuhet nga ky brumë (të enjten të shtëpia e dhëndrrit, të premtën të shtëpia e nuses). Ceremonia e brumit është rit pagan, pra paraislamike e parakristiane. Vetë karakteri recitativ i këngëve për brumin, siç del dhe nga melodia e një kënge të mbledhur në Kallarë (Kurvelesh i Poshtëm), na flet se ky zakon ka të bëjë më shumë me formula magjike të tipit të yshtjeve. Bartësi, krijuesi dhe studiuesi i etnokulturës së Lumit, Llambro Hysi, 71 vjeç, me arsim të lartë, Kallarë, na ka sjellë në kohë këtë prurje të veçantë: "*Zur brumin, moj gjeraqinë,/ Më dëgjo, o Zër' e malit!* [ref.]/ *Shtro hodën me trëndelinë,/ Qëndis dorën që mbush gjinë,/ Me mjaltë spërkate shtëpinë,/ Mbushe gjinë me qumësht zëre,/ Sorkadhe e mëmës drëre./ Hën' me byzlyk në dorë,/ O hëna me yll në ballë,/ Unaz' floriri në dorë,/ Sumbullat margaritar./ Më*

dëgjo, moj Zër' e malit,/ Bekoma nusen e djalit!" (1988).

Duke qenë festa më e bukur e jetës për dy personazhet qendrore të veprimtarisë kryesore gëzimtare të familjes, fisit, mëhallës, rrethanave e miqësisë, ndryshimi i statusit civil të djalit dhe vajzës që lidhin jetën realizohet mundësisht deri në përsosmëri, që nga veshja e çiftit, këngët, sipas etapave të ceremonialit të dasmës, ushqimi, pijet, zbukurimi sipëror i çiftit dhe paraqitja dinjitoze sa më e hijshme e dasmorëve, jo vetëm emocionalisht. Këngët e vallet e dasmës kalojnë në disa faza: A - Fejesa, zënia, vlesa; B - Këngë e valle në fillim e gjatë dasmës; C - Këngë e valle rituale të dasmës, të cilat vijnë me improvizime variantesh, sepse i thonë: "Fshat e tabiat, der' e zanat". Dasmat në përgjithësi bëheshin në vjeshtë, kur kishin mbaruar punët kryesore të bujqësisë e blegtorisë, por edhe për faktin se vjeshta ishte e begatë, i thonë stina e frutave. Ishte zier rakia, ishte hequr mënjanë ç'i duhej dasmës, mishi, ushqimet e tjera ishin bërë gati me bollshmëritë e duhura. E enjtja ose e diela ishte dita e marrjes së nuses. Qe një zakon në Lumin e Vlorës, që edhe më i vobekti ekonomikisht, dasmën do ta bënte si dasëm beu, siç e donte zakoni. Për këtë realizim ndihmohej nga fshati me vullnetarizëm ekonomik, me vullnetarizëm folklorik, në solidaritet. Nuk do të merremi me detajet e ceremonialit të dasmës, sepse ato janë të mbarënjohura, sidomos festa realizuar në shtëpinë e nuses, realizuar në trevën e Lumit me Ansamblin "Çipini" të Tomorr Lelo Këngës nga Televizioni "Top Channel" [16]. Nga mbledhësit e hershëm të folklorit vijnë këto njësi folklorike: "*As na pret, moj gjeraqinë,/ Bëj konak e shtro shtëpinë,/ Se krushqit ja tek po vinë,/ Vjen dhëndërrin me njëmijë,/ Njëmij' e njëqind kalorë,/ Trima e fustanehollë"* [17]. Kjo është ndër këngët më të vjetra (ndoshta jo akretip), mbledhur, regjistruar e botuar më 1878 nga Thimi Mitko, babai i Folkloristikës shqiptare [Shih: "*Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar/ 1635-1912/2"*, Instituti Folklorit, Tiranë, 1961, nr. 15, f. 59]. Tjetra, po e Mitkos: "*Dielli rrëzës së malit,/ Hën' e mir' e allonarit,* [kështu quhej dikur muaj korrik, shën ynë: A. H]/ *Shelege, bejk' e çobanit,/ Ti sos jeshë për çobanë,/ Po për dem, për kapedanë,/ Në gush' ma mbanë gjerdanë,/ Ç'e bëra xhoken-ë palë/ E mora përpjetë malë,/ Ku ma bënë mua varrë,/ Se mikja ma treti xhanë"* [18]. Këtë këngë e kemi dëgjuar të këndohet nga djemtë e viteve '70 në Tërbaç në një dasëm në mëhallën e Bragjinit. Është një këngë derti me maraze dashurie, që ndizte këngën e djemve të fshatit e digjte dasmën. Kështu thuhej për emocionet që përçonte tek dasmorët e të tjerët që e dëgjonin. Me dijeninë që kemi, veshja e përmendur në këngë na shpie

në shek. XVII-XVIII, kur përdorej xhokja (pallto leshi me ose pa mëngë), përveç se vjen nga Mitko më 1878. Po në tekstin e sipërpërmendur gjejmë këtë njësi folklorike: "*Ç'vetëtin atje rëposh?/ Shkon një djalë bukurosh,/ Doja ta kesh ilakà,/ Ja kushuri, ja vëlla,/ Ja po burrë me nigjà/ Ta shkonim jetën sefà* [19]. Vërejmë në tekst këto turqizma: ilakà=miqësi, gjak, farefis, pra të kesh të bësh me të; nigjà=urim, kurorë zyrtare, uratë e zotit, pagëzim; sefà=dëfrim. Dëshira e përvëlur e vajzës për të mos e humbur trimin e bukur jepet e shkallëzuar, lakonike dhe, për kohën kur është kënduar, shumë e emancipuar. Kemi rastisur në një dasëm në Vranisht, ku bartësi Sabri Skëndomemaj (1929-2017), me 7 klasë, marangoz i fshatit, këndoi këtë këngë të vjetër në variantin e tij, që sipas banorëve e moshatarëve e kishte kënduar për herë të parë në një "sebep" në vitin 1955. Ai ishte ende i ri, djalë 26 vjeçar, me vrulle moshe e ëndrra të ndezura dashurie dhe, për hir të zërit si bilbil, burrat e këngës i lejuan radhën. Duke tejkaluar shkallët hierarkike të traditës, Sabriu kaloi nga tavolina e të rinjve në trapezën e burrave, gjë që ndodhte në raste të veçanta. Ja teksti i regjistruar nga ne: "*Trak a truk ato këpucë,/ Zo-o, zonjushë!*[ref.]/ *Avash, mos i bësh, o moj me lucë,/ Vetëtin atje, more rëposh-ë* [dialekt: përposh]/ *Vjen një djalë, hajde bukurosh-ë,/ Kaçullohet, hajde si kaposh-ë,/ As ma jep-o, hajde njëzet grosh-ë,/ Kush ta kishte, hajde hilakà-e/ Ja kushuri, apo ja vëlla-e,/ Japo burrë, hajde me nigjà-e.../ Zo-o, o moj zonjushë!*" [20]. Kanë kaluar 36 vjet qysh kur e kemi dëgjuar këtë këngë [1986], që kur ia merrte xha Sabriu, dridheshin xhamat e dritareve, tundej oda. Një mrekulli bilbilash, që nuk e shprehim dot me fjalë magjepsjen e të kënduarit nga burrat e këngës në atë odë dasme dasme të burrave të dorës së parë për hierarkinë vertikale të ceremonialit. Xha Sabriu, i zoti i dasmës e kishte caktuar hysmeçi (që sot ka kuptimin e shërbimtarit ndaj komunitetit në harmonizimin e detyrës së dirigjentit me atë të administratorit apo shefit të prokurimeve dhe shërbimeve...). Te "*Bëleta shqypëtare*" e Mitkos gjejmë edhe këtë tekst poetik të një kënge tjetër me burim nga Bolena e Kurveleshit të Poshtëm, Lumi i Vlorës: "*Ngreu, shamiverdha, ngreu,/ Vallja jote më pëlqeu,/ Më kërcen si Mahmut Beu,/ Si Mahmut Beu në Vlorë,/ Delja, bejkë me këmborë,/ Më thanë se je beronjë,/ Ja sa të të hedh në dorë!...*" [21]. Ky variant aplikohet dhe në Gumenicë, Gjorm, Mavrovë e Sevaster, po thuaj pa ndonjë ndryshim të përfillshëm në tekst, por, kuptohet, sipas avazit të tyre [motivit muzikor, melodisë përkatëse]. Vini re ç'shpirt të madh e të vërtetë njerëzor, ç'univers të botës së madhe të Tërbaçit, ç'brilante dashurie përcjell vigani i

folklorit tradicional dhe të etnokulturës labe, i madhi Xhebro Gjika. Ishte i ftuar në një dasëm në mëhallën e Bite. 1978 viti. Burrat ulur këmbëkryq, sipas hierarkisë së nderimit të mikut në dasëm respektonin këtë ligj të pashkruar të këngës labçe pleqërishte e shtruar apo vënçe të Tërbaçit. E niste këngën i pari dhe këndonte dy vargje, pastaj i dyti - dy të tjera në vijim të tekstit e melodisë, i treti e plotësonte më tej e kështu me radhë të gjithë këndonin nga dy vargje, duke realizonte dhe mesazhin gëzimtar në përfundim të këngës. Vijonte me orë të tëra kënga, muhabeti e dollia dhe radha respektohej me fanatizëm. Kur radha i erdhi xha Xhebro, nga zëri i tij aq i bukur e i fuqishëm, oda e burrave, u deh nga kënaqësia sinkretike e mjeshtrit: "*Kur më shkon si kaçandone/ Tinë të plakesh harrone...*". Një parim specifik i folklorit është parimi fonetik, kështu që ne e paraqitëm tekstin (dhe jo vetëm këtë, por të gjitha tekstet apo njësitë folklorike të regjistruara në terren) ashtu siç e ka kënduar krijuesi dhe bartësi i shquar lab në odën e parë të burrave të këngës, ku qe si rregull që aty zinin vend burra të sërës që gëzonin këto tri ciëlsi: 1. Të ishin zotër të muhabetit, sipas zakonit; 2. Të ishin zotër të dollisë, po sipas zakonit, që kishte "nene" rreptësisht të detyrueshme e "dënoheshin" ata që mund të guxonin t'i shkëlpin; 3. Të ishin zotër të këngës, patjetër sipas zakonit. Ç'domethënë të ishte zot kënge sipas traditës? Do të thotë që çdo burrë, që ulej aty, duhej t'i llogariste mirë forcat e tij para se të matej me ujëqit e luanët e këngës e valles, përndryshe zbythej turpërueshëm. Çdo burrë që ulej në odën e këngës së parë, duhet t'ia merrte mirë këngës, t'ia kthente dhe t'ia hidhte bukur dhe, padiskutim, të dinte të bënte ison e duhur, t'ia mbushte këngës harmonishëm me të tjerët, që të mos haheshin zërat, por të kumbonin zile Janine, se ishte fyerje po të çirrej kënga. Kështu përdoren këto shprehje ndër banorët e Lumit e Labërisë. Kush nuk plotësonte këto kushte nuk mund të ulej në odën e parë, sipër në kat të dytë. E këngët e bukura mbahen mend, këndohen dhe sot e kësaj dite, sepse kanë shëndet folklorik, freski morale dhe zjarr dashurie: "*Kur më shkon si kaçandone/ Tinë të plakesh harrone...*". As do t'i kshite zili edhe Kadare, Agolli a Fatos Arapi këto dy vargje të improvizuara në plotësimin e këngës së dasmës nga ata burrat e parë?! Po kënga "*Çi gjet zakonet që pamë?*", aq e njohur edhe në ndër zonat e tjera të banuara me labë që na sjell para syve ritualin e dasmës në vargje të kënduara?! Në fund të dasmës burrat ngriheshin në valle. Vallja labe e burrave kishte lezetin e saj dhe të kënaqte shpirtin, por ndërkohë provonte edhe burrat, në e kishin përballuar rakinë, me mirësi, dolli e shëndete, sipas zakonit të dasmës

labe të Lumit. Bartësit e folklorit të kësaj zone tregojnë ato që mbajnë mend e që kanë përpërtuar: Brenda një dasme, me nisjen edhe mbylljen e saj, shpaloseshin të gjitha vlerat dhe ndjenjat njerëzore që njeriu ka në botë: kënga, vallja, gëzimi, hareja, loti, trishtimi, shakaja, krismat e armëve nga kënaqësia, lezetet e mbi të gjitha vëllazërimi, bashkimi dhe uniteti i shëndoshë e i dëlirë midis dasmorëve gëzimtarë.

4. Vajet dhe këngët e përvajshme

Hidhërimi më i madh në familje ka qenë vdekja, veçanërisht kur vdisnin në moshë të reja. Gjëma, kur ndodhte në shtëpi, merrej menjëherë vesh nga ulërimat e grave dhe nga të qarët e burrave me zë të lartë. Nga më të moshuarit kemi dëgjuar se si përcillej, qahej e kujtohej i vdekuri. Po ashtu edhe historikët e fshatrave të Lumit na kanë ndihmuar të njohim traditat e zonës edhe për përballimin e hidhërimeve të njeriut, po ashtu, sipas një protokollit natyrshëm të detyruar, bazuar në kodin zakonor vendor e Kanunin e Labërisë. Të gjitha gratë në raste mortore ç'pleksnin kostat (gërshetat), çirrnin faqet dhe hidhnin ligje (vargje me melodi të dhembshme pikëllimi), që i atribuoheshin të vdekurit, duke kujtuar jetën, punën, aftësitë, trimëritë, vujatjet dhe sakrificat e atij që ishte vlarë ose kishte vdekur në luftë apo hasmëri. Në raste mortore mbahej zi. Zija vazhdonte për një kohë të gjatë, dy e më shumë vjet. Nëna, motrat dhe gruaja visheshin me të zeza dhe qanin çdo mëngjes herët ("e këndonin", siç thuhej). Burrat nuk rruheshin për një kohë të gjatë, hiqnin zilet e këmborët nga bagëtitë, qanin çdo mëngjes jo vetëm për të afërmit, por edhe për shokët e tyre të ngushtë. Shumë nëna që u ishin vlarë apo vdekur djemtë e tyre, qanin çdo mëngjes gjatë gjithë jetës. Për humbjen e njeriut të afërm në Lumin e Vlorës praktikoheshin vajet, elegjitë, gjëmat dhe këngët e përvajshme. Janë të njohura dhe shumë tronditëse vajet e nënave labe për njerëzit e dashur që u janë larguar nga jeta, ndaj s'po ndalemi. Po paraqesim një njësi folklorike, ku kujtohet me një këngë të përvajshme, dmth qahet me ligje nga vajtonjësja (në rastin konkret ligjërohet hidhërueshëm një grua labe e Lumit nga Smokthina prej së kunatës, jo në çastin e vdekjes e përcjelljes, menjëherë sapo ndodh gjëma, por kohë më pas. Këtyre lloj qarjesh me ligje, me tekst poetik të improvizuar në çast, në ligjërim e sipër dhe me melodi trishtuese, kohë pasi ka ndodhur vdekja (muaj, vite), u thonë këngë e përvajshme: "I hoqe qyçet e mezit,/ Si trimi armët e brezit,/ Emërin e keshe grua,/Pëllua, Shano, pëllua!/, Po jeshe trime, fajkua,/ Vërje pëqinë në bres,/ Mbaje punën-ë në erson,/ O moj vitorja në mur,/ Tek rrije, lëshoje nur/

Dhe gjithë jetën me nder,/ të buroj' goja sheqer" [22]. Këtu kemi një kujtim nderues me nota zbuluese hiperbolizuese, ku ndihet trishtimi nga një vdekje ndodhur kohë më parë. Një tjetër njësi po në këtë tekst: "O mor Çeço namusqari,/ Korba, korba, o Çeço,/ Erdhi prilli, doli maji,/ M'i përvishje ato llërë,/ Më merrje atë gërshërë,/ Më qethje dhëntë, o drërë/ Më merrje vedrën në gjunjë,/ Merrje lugën, pije shkumë,/ Pa më merrje atë shark,/ Pa më flisje shkarp' më shkarp'/ Kur më del përpara dhëne,/ Cula jote me takëme!/ Kur i fryje culës-o,/ Me majë të buzës-o,/ Kërraba jote me pika,/ Gjithë sorka, gjithë syska,/ Pel' e bardh' e mushk' e kuqe,/ Kur më vareshe në luqe" [23]. Në këtë tekst poetik popullor kemi një vizatim në vargje jo thjesht dëshpëruese por edhe përshkruese deri në imtësi të jetës së blegtorit që kujtohet dhe mund ta klasifikojmë këngë të përvajshme baritore. Një njësi tjetër folklorike me natyrën e vajit na vjen nga Mitko, por nga kreu "Dorëshkrimi i Pragës": "O imzot, o vedërploti,/ S'është se të vrau cmokthinjoti,/ Në Kapokudhës Qirhati,/ Po të vrau i kallarati,- Hesh, o motër sado qave,/ Kallaratin fort e shave,/ Kallarati jelekuntë,/ Po pret e vret jelekuqtë,/ Kallarati, derku i derkut,/ Me të tretën e fishekut!/ - Ju veni të mirrni gjak/ e ata ju vrasin prapë,/ Ti je një bijë tërbaçe,/ u' jam bijë kallarate,/ Mo na bën të qajmë inaçe,/ Po lena të qajmë fshaçe" ("Mbledhës të hershëm...", vep. e cit. nr. 9, f. 220). Këtë fenomen, si duket, ka vrojtuar në gjurmimet e tij në këtë krahinë Kolë Kamsi, kur ka shënuar: "Ndër dekë, sidomos një vaj i madh e një ulërimë me zë të fortë të thekshëm bëhet prej grave të shtëpisë. Burrat e gratë e lagjes e të fshatit shkojnë menjëherë për kryeshëndosh në mort. Burrat kur i afrohen shtëpisë së të vdekurit fillojnë me qa, ndërsa gratë mbledhen herë-herë nga 20-30 bashkë e shkojnë rrugës duke ulëritë..." [24]. Sipas studiuesit turk Evlija Çelebi, në këtë zonë kemi të dhëna interesante për vajtimet dhe këngët e përvajshme. Sipas botëkuptimit islamik, hoxhallarët nuk i miratonin gjëmat, vajtimet dhe doket mortore. Në Lumin e Vlorës praktikoheshin 3 lloje vajtimesh në ditën e vdekjes: 1) vajtim i lirë, 2) vajtime shumëzërëshe dhe 3) vajtimet "hidh e prit". Në vajtimin e lirë, vajtonjëset këndojnë vajtueshëm ligjet e tyre në mënyrë të paorganizuar e spontane rreth trupit të të vdekurit. Në vajtimet shumëzërëshe gruaja që ligjëron vajtueshëm tekstin poetik, me ton solemn hidhërimi, me veshje, pamje e mimikë zie autoritare, si korifeu i ligjërimit, improvizon dhimbshëm vargje shumë prekëse, dëshpëruese, të atypëratyshme, të cilat shoqërohen me fjalët që thonë gratë e tjera mbledhur në odën e grave, rreth e rrotull meitit, sipas traditës, përvojës së hershme të

grave labe të zonës. Vajtimi me "hidh e prit" bëhen midis dy korifejeve a më shumë, ku gratë shkëmbejnë fjalët poetike të vajtimit. Në këto ceremoni mortore të përcjelljes së të vdekurit apo pas ndodhisë së fatkeqësisë familjare, "vargjet zënë vend natyrshëm në logjikën e ligjërimit sa, në shumë raste, në strukturën e tyre, duket se ka dalë prej ligjërimit organik të një vajtonjëseje" [25]. Vaje të tipit: "Arçë e t'u qasa pranë,/ Me duar ta hapa varrë,/ Më poqi dora në ballë,/ Në plumbin që keshe marrë" e kanë përfunduar kohëshërbimin funksional, i përkasin arkivës folklorike. Ndërsa gjëma e burrave ka qenë e rëndë në jetën zakonore. Shoqërohej me të "çjerrat" e të grisurat e faqeve" dhe shkuljen e flokëve dhe leshit të gjoksit. Në një formë të moderuar, shoqëruar me tekst poetik dhe melodi përmallimi me nota të përvajshme aplikon pothuaj i vetëm Tomor Lelo, "Mjeshtëri i Madh". Sipas folkloristit të njohur A. Xhagolli, janë të njohura dhe të praktikuar edhe ndër kombe të tjera dukuri të tilla si vënia e kujes, çjerrja e fytyrës, rënia përsipër të vdekurit dhe "hedhin dritë në karakterin arkaik të folklorit shqiptar" [26], pjesë e të cilit është edhe folklori i Labërisë së Lumit të Vlorës. Kjo zonë ka njohur dhe kurbetin apo jetën shërbimit të detyruar me vite të caktuara nën armë si nizamë nën Perandorinë Osmane, gjë që do të prodhonte elegji, vaje e këngë të nizamëve, kur trari i shtëpisë, babai i fëmijve, djemtë e nënave, shkonin ushtarë të shërbimit të detyrueshëm në kohën e Turqisë e s'ktheheshin gjallë... Në vëllimin "*Këngë popullore lirike*", Instituti i Shkencave, Tiranë, 1955, nr. 2, f. 278, është botuar edhe kjo këngë vaji, regjistruar në Tërbaç: "*Ç'u veshja malit përpjetë,/ Këmb', o këmbë pse m'u pretë?!/ Patët hall, a deshët vetë?!/ Seç m'u qep kuraj' e shkretë,/ Ç'i mblodhi pa qënë djemtë!/ Mbenë koperia malit,/ Qajnë të zonjat e stanit,/ Me lot e me djersë ballit,/ O ju të zonjat e stanit,/ Sa të vijmë nga nizami,/ Çitjane të zeza mbani!*" [27]. Po në këtë botim, f. 280, nr. 8, vjen nga Bolena dufi popullor që shpërthen tronditshëm në elegjinë në formën e një kënge të përvajshme, sjellë me mjeshtëri magjike si monofoni nga Zeqo Hoxha i Kallararit në Festivalin V Folklorik Kombëtar, tetor 1988 (në një variant tjetër) "*Ç'u këput një këmbë mali,/ O Stamboll, të rëntë zjarri!/ Të rënt' zjarri anëmbanë!/ Ç'na i bëre djemtë tanë?!/ ca redif' e ca nizamë,/ Nën at e grat' seç i lanë,/ Ç'na u vranë me Junanë,/ Ti, Sulltan, a paç belanë!/ Djemtë tanë na u vranë,/ Kopetë shkretë i lanë,/ Ç'punë kehtë me Junanë?*" [Kuraja-rekrut, ai që sapo është thirrur për të kryer shërbimin ushtarak, rekrut i ri. Redif-ushtar].

Nëpërmjet këtyre këngëve mallëngjyese shprehet hidhërimi që lidhet me respektin dhe

nderimin për njeriun e dashur, që na vijnë në trajtë simbolesh. Sy sistem simbolesh, ngritur rreth vdekjes, e cila është pranuar si një fenomen natyror, që kur ndodh shkakton reagime të forta që lidhen me mospranimin, është ndoshta edhe një formë komunikimi vlerash, ndërmjet të cilave mund të zbërthet më mirë kuptimi që vetë njerëzit i japin jetës së tyre.

Përfundime

Kultura jomateriale e krahinës etnografike të Lumit të Vlorës në Labëri nuk përfaqësohet vetëm nga epika historike, e cila është shumë e njohur nga studiuesit shqiptarë dhe të huaj. Shumë e pasur ka qenë në tematikë, në nivelin artistik të tekstit poetik dhe të të kënduarit (interpretimit) dhe ndoshta edhe shumë më e rëndësishme për zbukurimin e jetës së përditshme të banorëve të kësaj zone të lashtë ka qenë dhe lirika popullore apo poezia popullore lirike, ku lirika familjare është perla e këtij thesari të paçmuar të gurrës popullore labe të trevës. Duke qenë, se ishte një temë pak e rrahur nga studiuesit, ne paraqitëm këtë studim të thukët, që mund të na shërbejë si trase për punime më të gjera, më të imta, ndoshta asnjëherë shteruese, sepse jeta është e gjatë, e pafundme, me të pritura e të papritura, sa befalusë aq të bukura, me botë të gjallë shpirtërore të njeriut, që pasqyrohet edhe nëpërmjet folklorit. Gëzimet dhe hidhërimet në këngët lirike të Lumit të Vlorës bëjnë ende jetë aktive. Nëse, ndër llojet folklorikë të lirikës familjare, ninullat (këngët e lindjes e të djepit) dhe vajet, pothuaj i përkasin arkivistikës folklorike, këngët e dasmës po rikthehen me një formë të përshtatshme në traditën e bukur të të parëve tanë. Ato janë më të shumtat numerikisht dhe më të arrirat për nga nivel artistik. Nuk duhet të harrojmë se rinia e këtyre vise të banuara malore të krahinës së Labërisë pëlqen më tepër lirikën shoqërore dhe sidomos këngët e dashurisë, si lloj kryesor i kësaj nënfushe të poezisë popullore lirike. Ky problem ndoshta kërkon një vëmendje më përkushtuese të të vjetërve ndaj të rinjve, duke i marrë ata nëpër dasma, duke u nxitur kërshërinë dhe simpatinë që më të vegjëlit t'i dëgjojnë e t'i pëlqojnë këngët që këndohen e vallet që hidhen në këto ceremoni gëzimtare, edhe pse ceremoniali i dasmës ka pësuar shumë ndryshime në strukturë dhe organizimin e sotëm "protokollar" jo pak të rënduar e të superstolisur. Ndryshimet dhe zhvillimet në mënyrën e jetesës, në edukimin dhe prirjet kulturore të banorëve të rinj të kësaj krahine etnografike, kanë sjellë vetvetiu dhe

domosdoshmërisht ndryshime, prurje, risi në këtë lloj folklorik, si pjesa kulminante më gëzimtare e lirikës familjare. Shembull konkret i jetës aktive folklorike në këtë zonë dhe i përcjelljes së kësaj stafete të këngës e valles labe të dasmës në brezat që vijjnë janë pëlqimet e praktikimet e këngëve të vjetra prurë në kohë nëpër gëzime, ceremoni e veprimtari të tjera nga Grupi i Vajzave të Tërbaçit "10 Shqiponjat e Tërbaçit", Grupi i Djemve të Bratit, ai i Drashovicës etj. Përveç krijuesve njohur të traditës si Demir Ago Vlonjaku, Qazim Ademi (të dy nga Smokthina), dy vëllezërit Mato e Selim Hasani (nga Brataj), Xhebro Gjika (nga Tërbaçi), kanë dalë emra krijuesish popullorë të nivelit të lartë si Kujtim Mici (Tërbaç), Muhamet Tartari (Vranisht), Feti Brahimi (Lapardha), Llambro Hysi (Kallarat), Pelivan Barjami (Drashovicë, Tërbaç), Nexhip Seraj (Brataj), Lefter Haxhiraj (Armen), Meleq Kapllanaj (Kaninë), Nertesli Asllani (Bolenë) Felek Blea (Vërmik), Namik Jahaj (Smokthinë), Albert Habazaj (Tërbaç) apo matanë malit, mbi Himarë, Kristo Çipa i Pilurit, vëllai i vogël i Lefter Çipës së madh etj, që, duke pirë ujë të kulluar në traditën e këngës polifonike labe, na kanë dhuruar shumë njësi të bukura folklorike me vlera të larta artistike, estetike dhe morale dokesore. Për ta ilustruar ç'ka shprehim, do të mjaftonte të përmendim, që grupet polifonike të Tërbaç - Vranishtit kanë fituar çmimin "Europa për zhvillimin e folklorit" më 1986 dhe kanë dhënë koncerte folklorike në Hamburg të Gjermanisë, kurse grupi i Lapardhasë në Ganantë të Francës dhe Mishtenbah të Gjermanisë. Studiuesi skoces Aleksandër Fenton ka nxjerrë përfundimin, se këto fshatra të Lumit të Vlorës, me format e veçanta të këngëve polifonike dy - tre zërëshe e më shumë tregojnë "për pasuritë e mëdha shpirtërore të kësaj treve" [28].

Vlen për t'u përmendur pozitivisht nisma e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, (DRKK), Sektorit të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Vlorë për stafetën e traditave etnofolklorike tek brezi i ri, e cila na mblodhi me miqtë e Folklorit në Vlorë, me bartësin traditës së këngës labe dhe marrësin e shkëlqyer të këngës smokthinjoçe Hysen Ruka dhe me krijuesin e studiuesin e njohur Llambro Hysi për të ndjekur një veprimtari mbresëlënëse dhe me mesazhe jo vetëm për Vlorën e Labërinë. Një rikthim besimmbushur, që erdhi mbas shumë vitesh tallava e hallakatje pa tragë të traditës sonë folklorike, kur për here të parë gjatë "viteve demokratike", më datat 29 dhe 30 Mars 2017, në mjediset e Pallatit të Kulturës "Labëria", në Skelë, Vlorë u zhvillua Festivali Rajonal i Poezisë dhe Prozës letrare gojore "GURRA FEST" me shkollat 9 vjeçare dhe të

3) **Bisedat në kohë reale nëpërmjet IRC**(Internet Relay Chat). Informacioni i shtypur(printuar) shfaqet në ekranet e pjesëmarrësve të cilët mund të lëvizin në dhoma të ndryshme sipas interesave të tyre dhe të ndjekin informacionin që u përshtatet më shumë(8). Qëllimi i mësimit të një gjuhe të huaj është që t'u mësojë nxënësve/studentëve orientimin e lirë në mjedisin gjuhësor dhe të mundësojë dhe zhvillojë te nxënësit aftësinë për t'u përgjigjur në mënyrë adekuate komunikimit në situata të ndryshme. Pikëpamjet moderne mbi rezultatet e të mësuarit kanë çuar në shfaqjen e teknologjive të reja. Metodatat tradicionale të mësimit të një gjuhe të huaj janë zëvendësuar me metoda të reja duke përdorur burimet e Internetit. Metodatat tradicionale, para së gjithash, kuptohen si memorizim i rregullave apo edhe i ushtrimeve gjuhësore. Për të mësuar komunikimin në një gjuhë të huaj, duhen krijuar situata reale jetësore dhe duhen prezantuar nxënësit me mjedisin e ri gjuhësor(9). Sot, i gjithë ky proces bëhet me ndihmën e teknologjive të rrjetit ,pra të Internetit(10). Gjithashtu, me ndihmën e teknologjive të Web-rrjetit, pavarësia e studentëve po zhvillohet gradualisht. Teknologjitë e rrjetit zhvillojnë jo vetëm aftësitë e nevojshme për mësimin e një gjuhe të huaj, por gjithashtu edhe operacionet mendore të çdo individi; cilësitë sociale dhe psikologjike, vetëbesimin dhe aftësinë e tyre për të punuar në një ekip. Ka shumë faqe Web që ofrojnë mundësi komunikimi online. Duke përdorur teknologjitë e rrjetit, studenti/nxënësi gjen shumë informacion. Interneti fshin kufijtë gjeografikë. Mësimi online hap mundësi të reja për realizimin e interesave dhe aftësive të çdo individi(11). Pavarësisht nga fakti, që nxënësi punon në mënyrë të pavarur, është mësuesi, ai që ende kontrollon përparimin e tij. Me ndihmën e materialeve në Web, mund të gjenden informacione të shumta si dhe të studiohet kultura, mënyrat e komunikimit, dialektet e gjuhës target/synuar. Materialet didaktike janë në dispozicion për të gjitha moshat dhe gjithashtu sigurohen për nivele të ndryshme të aftësisë njohëse të gjuhës së huaj, pasi tanimë është e mundur të zgjedhësh nivelin e vështirësisë së detyrave të cilat duhet ti zgjidhësh. Teknologjitë didaktike të rrjetit veprojnë si një mjet efektiv edhe për mësimin e shkrimit në një gjuhë të huaj. Të mësosh të shkruash duke përdorur internetin është shumë interesante, sidomos për shkak të mundësisë së punës me e-mail(12).

Rezultatet dhe diskutime

Kështu, duke përdorur teknologjitë e rrjetit, duke i integruar ato në procesin arsimor, është e mundur të zgjidhen në mënyrë efektive një numër detyrash didaktike në një mësim të gjuhës së huaj:

- a) për të përmirësuar aftësinë e leximit duke përdorur materialet e rrjetit;
- b) për të përmirësuar aftësinë e dëgjimit bazuar në tekstet autentike në Internet;
- c) për të përmirësuar aftësinë e monologut dhe dialogut bazuar në problemet dhe materialet e rrjetit;
- d) për të zhvilluar aftësinë e shkrimit duke marrë pjesë në përgatitjen e eseve, hartimeve etj...;
- e) zgjeroni fjalorin tuaj;
- f) për t'u njohur me kulturën, etiketën e vendit, gjuhën e të cilit po studiojnë(13). Një nga detyrat kryesore të futjes së teknologjive të informacionit dhe rrjetit në procesin arsimor është përmirësimi i aftësive pedagogjike të mësuesit. Duke zotëruar teknologjitë e reja të informacionit, mësuesi zhvillon metoda dhe forma të reja të mësimit, duke rritur kështu efektivitetin e mësimit. Me ndihmën e teknologjive të rrjetit, ata mund të zotërojnë personalitetin e studentëve dhe të arrijnë rezultate të cilësisë së lartë. Me futjen e teknologjive të rrjetit, aktiviteti kognitiv dhe motivimi i nxënësve përsëri në procesin e të mësuarit, ndërsa mësuesit vërejnë kursime të rëndësishme kohore. Ka qasje dhe forma të ndryshme për të mësuar. Çdo mësues zgjedh për vete metodatat më efektive të përdorimit të teknologjive të rrjetit si mjet për mësimin e katër aftësive gjuhësore, në studimin e gjuhëve të huaja. Interneti lehtëson futjen e materialit të ri në mësim dhe gjithashtu siguron një kuptim më të lehtë të temës së mësimit(14). Me ndihmën e internetit, studentët zhvillojnë kreativitetin e tyre duke punuar në projekte të ndryshme së bashku me bashkëmoshatarët e vendeve të tjera. Kështu, ata përpunojnë aftësitë leksikore gramatikore edhe duke i shkruar një letër interlocutorit, duke zhvilluar kështu aftësitë e shkrimit(15). Teknologjitë e rrjetit zhvillojnë operacione mendore, cilësi sociale dhe psikologjike, vetëbesim dhe aftësi për të punuar në një ekip(16). Gjëja kryesore është të jesh në gjendje t'u përgjigjesh spontanisht deklaratave të interlocutorit, të jesh në gjendje t'u përgjigjesh atyre si me shkrim, ashtu edhe me gojë. Teknologjia e informacionit vepron si një mjet i efektshëm mësimi(17). Kështu, pasi kemi studiuar gjendjen e përdorimit të teknologjive të rrjetit në procesin e mësimit të gjuhëve të huaja, mund të konkludojmë se efektiviteti i përdorimit të kompjuterëve varet nga metodatat dhe format e përdorimit të këtyre teknologjive, përdorimi efektiv i të cilave nuk kërkon shumë vite trajnime shtesë. Këto teknologji hapin mundësi të mëdha për mësuesit që janë në kërkim të mjeteve shtesë për të zgjidhur problemet e tyre profesionale(18).

Përfundime

Pas studimeve të kryera, është arritur në përfundimin se teknologjitë dixhitale kompjuterike, janë në gjendje t'u sigurojnë studentëve:

-diferencimin dhe individualizimin e të mësuarit;
-zhvillimin e pavarësisë dhe kreativitetit duke ofruar qasje në burime të reja të informacionit arsimor;

- krijimin e kushteve për manifestimin dhe zhvillimin e subjektivitetit të tyre. Përdorimi i teknologjive të rrjetit zhvillon aftësitë krijuese të nxënësve, aftësinë e tyre për të fituar në mënyrë të pavarur njohuri të reja dhe për të krijuar kushte për realizimin e tyre vetjak si lëndë e veprimtarisë arsimore. Përdorimi i teknologjive të rrjetit ndihmon jo vetëm në përmirësimin e

aksesit në njohuri, por edhe në zhvillimin e aftësive krijuese, të tilla si zgjidhja e problemeve dhe mendimi kritik. Për më tepër, teknologjitë dixhitale krijojnë kushte që studentët të realizojnë potencialin e tyre personal si subjekte të pavarura në procesin arsimor. Në këtë mënyrë, zhvillimi teknologjik nuk i shërben vetëm rritjes së efikasitetit, por edhe kultivimit të vetë-motivimit dhe aftësive për të mësuar gjatë gjithë jetës.

Literatura

1. Anderson T, Dron J. *Three generations of distance education pedagogy. The International Review of Research in Open and Distributed Learning.* 2011;12(3):80-97. doi:10.19173/irrodl.v12i3.890
2. Selwyn N. *Education and technology: Key issues and debates.* 2nd ed. Bloomsbury Academic; 2016.
3. Basova AV. *To the question of writing and written speech in teaching a foreign language: methods of teaching foreign languages.* In: *Language. Culture. Education: Collection of materials of the international scientific conference "Readings of Ushinsky".* Yaroslavl: Publishing House of YaGPU named after K.D. Ushinsky; 2006. p. 96. Issue 2.
4. Mukhametzhanova FG, Panchenko OL, Khairutdinov RR. *Magistracy as a methodological phenomenon: challenges of modernity.* *Person and education.* 2017;(3):9-14.
5. Mynbaeva AK, Sadvakasova ZM. *Innovative teaching methods, or how it is INTERESTING TO TEACH: study guide.* 4th ed, add. Almaty; 2010. 344 p.
6. Selevko GK. *Pedagogical technologies based on information and communication tools.* Moscow: Research Institute of School Technologies; 2005. 208 p.
7. Rocca F. *Teaching Italian as a Foreign Language: Theoretical and Practical Aspects.* Cambridge Scholars Publishing; 2018.
8. Greenhow C, Lewin C. *Social media and education: Reconceptualizing the boundaries of formal and informal learning.* *Learning, Media and Technology.* 2015;41:1-25. doi:10.1080/17439884.2015.1064954

9. Kamalov F, Santandreu Calonge D, Gurrib I. *New era of artificial intelligence in education: Towards a sustainable multifaceted revolution.* *Sustainability.* 2023;15(16):12451. doi:10.3390/su151612451
10. MDPI. *Sustainability.* Accessed October 15, 2024.
11. Kamalov F et al. *Article link* Accessed October 15, 2024.
12. Vivian R. *Students' use of personal social network sites to support their learning experience.* 2012. doi:10.13140/RG2.1.2337.6484
13. *Atlantis Press PDF* Accessed October 15, 2024.
14. Graves DH. *Writing: Teachers and children at work.* Portsmouth, NH: Heinemann; 1983.
15. Evans JC, Wideman HH. *Enhancing economics education with on-line interactive tutorials.* Paper presented at: Annual Educom conference; October 1995; Portland, OR.
16. *Educational Research* Accessed October 15, 2024.
17. Solomon G, Perkins DN, Globerson T. *Partners in cognition: Extending human intelligences with intelligent technologies.* *Educational Researcher.* 1991;20(3):2-9.
18. Uchida C. *Preparing students for the 21st century.* Arlington, VA: American Association of School Administrators; 1996.

EDUKIM

Një model i bashkëpunimit në mësimdhënie: Rast studimor me studentë të vitit të parë të programit të studimit Master në "Mësuesi", Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Angleze

Prof. Asoc. Dr. Etleva Kondi (Koni)

etleva.kondi@unitir.edu.al

Prof. Asoc. Dr. Daniela Hasa

daniela.hasa@unitir.edu.al

Abstract

This study explores how 20 first-year students in the Master's study program in "Teaching" cooperate in groups to carry out collaborative teaching in the subject "Teaching Methodology of the English Language". The study uses both quantitative and qualitative research methods, including a questionnaire with 11 questions (9 multiple-choice and two open-ended), peer evaluation, and self-evaluation. It looks at how teamwork strategies are used in student teaching, including collaborative planning and group work for activities like icebreakers, reviews, teaching, and evaluation. The study found that participants created a dynamic learning environment through peer observation, collaborative lesson planning, and student-led instruction aimed at enhancing student engagement and academic growth. It also identifies challenges such as time constraints and diverse teaching styles but highlights innovative strategies to overcome them. The study emphasizes the significant impact of collaborative practices on teaching effectiveness and how teamwork is critical in preparing future English educators for success in the classroom.

Keywords: *teamwork, aspiring teachers, collaborative practices, effectiveness*

Përmbledhje

Ky studim ka për qëllim të vëzhgojë se si 20 studentë të viti të parë, dega gjuhë angleze, program i studimit Master në "Mësuesi"

bashkëpunojnë në grupe për të realizuar mësimdhënie bashkëpunuese në orët e mësimit të lëndës "Metodologji e Mësimdhënies së Gjuhës Angleze". Studimi përdor analizën sasiore dhe cilësore të të dhënave nëpërmjet një pyetësori me 11 pyetje (9 me alternativa dhe 2 me shtjellim), vlerësimin të bashkëmohatarëve dhe vetëvlerësimin. Studimi synon të vëre në pah përdorimin e strategjive të punës në grup në mësimdhënien bashkëpunuese, duke përfshirë planifikimin bashkëpunues dhe punën në grup për aktivitete si pjesa hyrëse e orës së mësimit, përsëritja, shpjegimi i tematikës së re dhe vlerësimi. Të dhënat treguan se pjesëmarrësit krijuan një mjedis dinamik të të nxënimit përmes vëzhgimit, planifikimit të mësimit në bashkëpunim dhe udhëzimeve të ofruara nga studentët, që synojnë rritjen e pjesëmarrjes aktive dhe zhvillimin profesional të studentëve. Gjithashtu, këto të dhëna vunë në dukje edhe vështirësi të hasura gjatë bashkëpunimit si kufizimet kohore dhe metodat e ndryshme të mësimdhënies. Studimi thekson rëndësinë e praktikave bashkëpunuese dhe të punës në grup për përgatitjen e mësuesve të ardhshëm të gjuhës angleze dhe një mësimdhënie/ nxënie të suksesshme.

Fjalë kyçe: *puna në grup, mësues të ardhshëm, praktika bashkëpunuese, mësimdhënie e suksesshme*

Hyrje

Në hapësirën e gjerë të fushës së arsimit, ku teoritë gërshetohen me praktikën dhe risitë pedagogjike me nevojat e ndryshme të studentëve, një parim qëndron i palëkundur: bashkëpunimi. Ky parim është pjesë integrale e mësimdhënies, duke bërë bashkë të gjithë mësimdhënësit në ndjekje të përsosmërisë, barazisë dhe fuqizimit. Megjithatë, mes korridoreve plot zhurmë të institucioneve arsimore, nuk janë vetëm veteranët e sprovuar të profesionit të mësuesit ata që mbrojnë këtë etikë; janë gjithashtu të rinjtë që aspirojnë mësimdhënien, pishtarët e ardhshëm të risive pedagogjike, ata që përqafojnë frymën e bashkëpunimit ndërsa nisin rrugëtimin e tyre të mësimdhënies.

Askund nuk është më e theksuar rëndësia e përpjekjeve bashkëpunuese sesa në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Në gamën e pasur të gjuhës, letërsisë dhe komunikimit, mësimdhënësit përdorin përvojën dhe aftësitë e tyre me qëllim nxitjen e mendimit kritik, rritjen e aftësive krijuese dhe ndjeshmërinë të studentët. Megjithatë, realizimi i këtyre qëllimeve të larta kërkon më shumë se ekspertizë individuale; realizimi i tyre kërkon mençurinë kolektive, vizionin e përbashkët dhe frymën bashkëpunuese të vetë mësimdhënësve.

Ky punim është një rast studimor që synon të vëzhgojë përdorimin e punës në grup, si një qasje ndërvepruese në lëndën Metodologji e Mësimdhënies së Gjuhës Angleze, të zhvilluar me 20 studentë të vitit të parë, Master Shkencor "Mësuesi" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Ai synon të dëshmojë rëndësinë e vazhdueshme të punës në grup në formësimin e arsimit. Duke përdorur një qasje të shumanshme ndaj kërkimit cilësor, përfshirë këtu vëzhgimin e pjesëmarrësve nëpërmjet vlerësimit nga grupi i vlerësimit dhe pedagogu i lëndës bazuar në një fletë vlerësimi të hartuar prej këtij të fundit dhe një pyetësori që përfshin pyetje me alternativa dhe ato me shtjellim, qëllimi ynë është të paraqesim dinamikën e ndërlikuar të mësimdhënies bashkëpunuese në veprim.

Megjithatë, studimi ynë nuk ndalet vetëm në planifikimin bashkëpunues të orës së mësimit. Ai shtrihet përtej kësaj, duke u thelluar në përfshirjen e studentëve brenda grupeve të dedikuara për aspekte të ndryshme të pedagogjisë, si grupi që nis orën e mësimit nëpërmjet lojërave apo aktiviteteve, grupi që bën përsëritjen e tematikës së trajtuar në orën e kaluar të mësimit, grupi që do të shpjegojë dhe trajtojë tematikën e re të kësaj ore mësimi dhe grupi i vlerësimit. Bazuar në objektivat e secilit prej grupeve, ne synojmë të zbulojmë fjetet e

bashkëpunimit që formojnë strukturën e mësimdhënies së efektshme të gjuhës angleze.

Ky punim gjithashtu synon të nxjerrë në pah rëndësinë e punës në grup midis mësimdhënësve të ardhshëm të gjuhës angleze dhe aftësinë e kësaj qasjeje për të sjellë ndryshime thelbësore. Punimi thellohet në sfidat, strategjitë bashkëkohore të hartuara dhe rezultatet e prekshme të arritura përmes përpjekjeve bashkëpunuese. Gjithashtu, ai tregon se si bashkëpunimi ndikon në zhvillimin profesional dhe dinamikën e orës së mësimit, thekson rolin kryesor të praktikave bashkëpunuese në përgatitjen e mësuesve dhe inkurajon një brez të ri mësuesish që të përqafojnë bashkëpunimin si një gur themeli të rrugëtimin të tyre pedagogjik. Duke vepruar në këtë mënyrë, ne mund të krijojmë mjedise të mësimdhënies gjithëpërfshirëse që nxisin kureshtjen intelektuale, shprehinë krijuese dhe të nxënit gjatë gjithë jetës të çdo student.

Shqyrtimi i Literaturës

Përdoret gjerësisht, por në fakt puna në grup është e ndërlikuar dhe sfiduese për t'u përshkruar apo përmbushur. Megjithatë, studiues të shumtë e përkufizojnë punën në grup si një përpjekje bashkëpunuese që u mundëson individëve të ndryshëm që punojnë në grup të arrijnë qëllime të përbashkëta përmes shkëmbimit të njohurive dhe aftësive (1,2,3,4). Një grup pune zakonisht përbëhet nga dy ose më shumë individë që kryejnë detyra dhe aktivitete që lidhen me njëra-tjetrën me qëllim përmbushjen e një misioni të përbashkët.

Studime të ndryshme ndër vite sjellin dëshmi empirike që mbështesin dobishmërinë e mjediseve të të mësuarit bashkëpunues. Këto mjedise, ku studentët punojnë së bashku për të arritur qëllime të përbashkëta, kanë treguar se përmirësojnë rezultatet e të nxënit krahasuar me mjediset tradicionale, pasive apo konkurruese (5). Gjithashtu, ndryshimet në fushën e arsimit në dekadat e fundit kanë theksuar kapërcimin e pengesave disiplinore dhe përqendrimin e vëmendjes të aftësitë e buta (soft skills), duke theksuar më tej rëndësinë e të nxënit në bashkëpunim (6).

Të nxënit nëpërmjet punës në grup përfshin qasje të ndryshme të mësimdhënies, ku studentët bashkëpunojnë për të përmbushur objektivat e mësimdhënies nën drejtimin dhe këshillimin e një mësimdhënësi. Pavarësisht faktit se termi "të nxënit bashkëpunues" u përdor për herë të parë nga mësuesit britanikë në vitet 1950 gjatë një studimi kërkimor të studentëve të

mjekësisë në University College, University of London (7), ai është i vlefshëm dhe në kontekstin e ditëve të sotme pasi u përgjigjet sfidave arsimore me të cilat përballen kolegjet, duke synuar përballjen e studentëve me vështirësitë e hasura gjatë përpjekjes së tyre për t'u përshtatur me praktikën e klasave tradicionale (8).

Puna në grup nxit pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e nxënies, nxit ndërvarësinë pozitive, komunikimin, aftësitë sociale dhe përgjegjshmërinë e tyre (9). Kjo qasje ndryshon nga ajo tradicionale, e cila zakonisht ka në qendër të saj performancën individuale dhe anashkalon aftësitë e punës në grup (10). Barkley et al. (11) përshkruajnë teknika të ndryshme të të nxënies në bashkëpunim dhe theksojnë rëndësinë e planifikimit në të gjitha fazat e procesit të nxënies. Pavarësisht përparësive, të nxënies nëpërmjet punës në grup paraqet sfida për mësimdhënësit, duke përfshirë këtu mungesën e të kuptuarit, kufizimet në kohë dhe nevojën për mbështetje administrative (12). Zbatimi i suksesshëm kërkon angazhim, trajnim dhe mbështetje të vazhdueshme për të siguruar rezultate pozitive të të nxënies (12,13).

Mësimdhënia nëpërmjet punës në grup dhe angazhimi i studentëve në vlerësim

Megjithëse puna në grup është bërë gjithnjë e më e zakonshme në fusha të ndryshme, koncepti i bashkëpunimit nuk përputhet me natyrën individuale të arsimit të lartë, e për rrjedhojë nuk mund të hamendësojmë se studentët do të zbulojnë natyrshëm metoda për të maksimizuar përpjekjet e tyre bashkëpunuese dhe për të arritur sukses. Studentët shpesh arrijnë rezultate produktive të punës në grup, por zakonisht nuk janë të vetëdijshëm për veprimet e tyre. Kjo është dhe arsyeja përse ata nuk mund të zbatojnë me vetëdije strategjitë e tyre të suksesshme në përpjekje të tjera bashkëpunuese. Nëse një lëndë mësimore synon të nxisë bashkëpunimin e dëshiruar midis studentëve, atëherë kjo lëndë duhet të ofrojë udhëzime të drejtpërdrejta për punën në grup dhe zgjidhjen e problemeve. Këto udhëzime duhet të bëhen pjesë e kurrikulës (14). Prezantimi i qasjes bashkëpunuese kërkon që vetë mësimdhënësit të inkurajojnë studentët të njihen me këtë qasje, të analizojnë detyra dhe projekte të kaluara ku kanë punuar në grup dhe të përcaktojnë qëllimet e tyre lidhur me projekte të ardhshme ku ata do të dëshironin të punonin në grup. Të mësuarit bashkëpunues ka rezultuar i suksesshëm veçanërisht në punën me bazë projektesh ku secili anëtar kërkohet të kryejë një detyrë të caktuar.

Për rrjedhojë, mësimdhënësit duhet të tregojnë kujdes ndaj detyrave që studentëve u janë

caktuar gjatë planifikimit të projekteve. Për më tepër vetvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët ka një ndikim pozitiv sepse nxit të menduarit kritik. Përfshirja në vetëanalizimin dhe përcaktimin e qëllimeve u mundëson studentëve dhe mësimdhënësve të lënë mënjanë përvojat individuale dhe të mendojnë e veprojnë nën frymën e bashkëpunimit për qëllimin e përbashkët (15).

Zhvillimi i strategjive të efektshme të punës në grup është i një rëndësie më të veçantë se përfundimi me sukses i projektit. Vlerësimi nga bashkëmoshatarët ofron njohuri të vlefshme mbi atë se si studentët qasen veçanërisht ndaj strategjive bashkëpunuese të njëri-tjetrit. Këto vlerësime përmbledhin një gamë të gjerë aftësish, duke përfshirë dëgjimin aktiv, menaxhimin e konflikteve dhe aftësitë drejtuese. Vetë mësimdhënësit mund t'u vijnë në ndihmë diskutimeve mbi strategjitë e bashkëpunimit përpara se të formohen grupet e punës dhe të gjejnë mënyra për të kërkuar vlerësime apo komente anonime nga vetë bashkëmoshatarët e studentëve pas përfundimit të projektit, duke pranuar se shpesh studentët e bëjnë vlerësimin të ndikuar nga marrëdhëniet që ata kanë me bashkëmoshatarët e tyre (15).

Vlerësimet që vijnë nga bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësimet janë thelbësore në ridrejtimin e grupeve drejt qasjeve të suksesshme gjatë përvojave bashkëpunuese, sikundër theksohet nga Gueldenzoph dhe May (16). Të kryera gjatë zhvillimit të projektit, këto vlerësime i mundësojnë grupit të punës një bashkëpunim të efektshëm pa vlerësuar drejtpërdrejt performancën e njëri-tjetrit. Gjithashtu, regjistrimi i takimeve të grupit të punës për analiza të mëvonshme do të ishte një mënyrë e efektshme vlerësimi pasi duke studiuar modelet e komunikimit dhe mënyrën e të folurit, grupet mësojnë më shumë rreth dinamikave të ndërveprimit mes anëtarëve të grupit. Një mënyrë tjetër e dobishme është mbajtja shënim e konflikteve dhe sfidave, ku grupet dokumentojnë pengesat e hasura dhe zgjidhjet që janë dhënë gjatë projektit. Kjo do të nxiste ndërgjegjësimin për strategji të suksesshme për zgjidhjen e konflikteve dhe prirjen drejt të menduarit në grup. Këto metoda të vlerësimit lehtësojnë bisedat produktive midis mësimdhënësve dhe grupeve të punës lidhur me dinamikën e ndërveprimit në grup.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë studim përfshin analizën sasimore dhe atë cilësore për të mbledhur dhe analizuar të dhëna lidhur me praktikën e

punës në grup si një qasje ndërvepruese duke u shtrirë gjatë gjithë zhvillimit të lëndës Metodologji e Mësimdhënies së Gjuhës Angleze (viti akademik 2023-2024). Pjesëmarrësit janë 20 studentë të vitit të parë në programin Master Shkencor "Mësuesi" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Gjatë kësaj kohështrirjeje, studentët ishin të ndarë në grupe pune të cilët morën përgjegjësi për aspekte të ndryshme të orës së mësimit, duke përfshirë hyrjen në temë, përsëritjen e materialit të trajtuar orët e kaluara, shpjegimin e tematikës së re dhe vlerësimin e përparimit të grupit. Çdo javë, grupet e punës ndryshonin rolet, duke ofruar mundësi që studentët të eksperimentojnë me të gjitha aspektet e mësimdhënies dhe të zhvillojnë aftësi të ndryshme. Pas përfundimit të këtij projekti pune në grup u zhvillua një pyetësor i cili përmban nëntë pyetje të strukturuar me alternativa dhe dy pyetje që kërkojnë shtjellim. Të dy llojet e pyetjeve shqyrtojnë përvojat dhe perceptimet e studentëve rreth praktikave bashkëpunuese në mësimdhënie. Pyetësori është hartuar në mënyrë të tillë që të përfshijë çështje specifike lidhur me bashkëpunimin në grup, dobishmërinë e kësaj praktike, rëndësinë e bashkëpunimit në krijimin e mjedisit të duhur në orën mësimore dhe ndikimin e tij në zhvillimin profesional të mësuesve të ardhshëm të gjuhës angleze. Gjithashtu, vlerësimi dhe vëzhgimi nga bashkëmoshatarët dhe pedagogu i lëndës gjatë projektit mundësuan një pasqyrë të plotë mbi dinamikën e grupeve dhe angazhimin e studentëve. Kjo qasjeje e strukturuar ka lejuar mbledhjen e të dhënave duke bërë kështu të mundur analizimin, krahasimin e rezultateve në një mënyrë sistematike dhe nxjerrjen e përfundimeve të cilat mund të ndihmojnë në përmirësimin e praktikave të mësimdhënies bashkëpunuese në arsimin e lartë.

Rezultatet dhe diskutimi i tyre

Pyetësori i përdorur në këtë studim synon të hulumtojë perceptimet dhe praktikat e mësuesve të ardhshëm të gjuhës angleze lidhur me dobishmërinë dhe rëndësinë e bashkëpunimit në krijimin e një mjedisi mësimor të suksesshëm dhe mbështetës. Nëpërmjet analizës së rezultateve kemi për qëllim të japim një portret të qartë dhe të detajuar të përvojës së studentëve në grupe pune në kontekstin e mësimdhënies, duke ofruar një bazë të rëndësishme për të kuptuar ndikimin dhe vështirësitë që mund të përfshijnë praktikat bashkëpunuese në arsimin e lartë.

Sa shpesh bashkëpunoni me pjesëtarët e tjerë të grupit për përgatitjen e materialeve mësimore?




Tabela 1 Bashkëpunimi me pjesëtarët e tjerë të grupit të punës

Rezultatet tregojnë qasje të ndryshme ndaj bashkëpunimit midis pjesëtarëve të grupit të punës lidhur me përgatitjen e materialeve mësimore. Një pjesë e konsiderueshme (50%) shprehen se bashkëpunojnë gjithmonë, duke treguar një kulturë të fortë të punës në grup dhe përgjegjësi të përbashkët. Kjo qasje bashkëpunuese midis studentëve nxit një mjedis mbështetës, qasje dhe praktika të reja të dëshiruara të mësimdhënies midis vetë mësuesve të ardhshëm. Në të njëjtën kohë kemi një përqindje më të vogël por e dukshme e të anketuarve të cilët shprehen se bashkëpunonin ndonjëherë (20%) ose rralle (10%). Teksa bashkëpunimi që ndodh herë pas here na tregon se disa studentë e njohin vlerën e punës në grup, por mund të mos gjejnë gjithmonë mundësinë ose domosdoshmërinë për të punuar në grup, bashkëpunimi i rralle mund të lidhet me pengesa ose vështirësi të mundshme gjatë punës në grup. Trajtimi i këtyre pengesave dhe nxitja e një kulture më të qëndrueshme bashkëpunimi mund të përmirësojë më tej praktikën e mësimdhënies dhe të mbështesë rritjen dhe zhvillimin profesional të mësuesve të ardhshëm. Gjetjet theksojnë rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit midis grupeve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm dhe maksimizimin e rezultateve të nxënies.

A pajtoheni me pohimin: "Praktikat e mësimdhënies bashkëpunuese rrisin suksesin e mësimdhënies së gjuhës angleze"?




Tabela 2 Mendimi i studentëve lidhur me dobishmërinë e praktikave bashkëpunuese

Bazuar në rezultatet e dhëna në tabelën 2, shumë studentë pajtohen me pohimin (48 %) dhe një pjesë tjetër e konsiderueshme (26 %) pajtohen plotësisht, gjë e cila dëshmon se pjesa më e madhe e tyre (74%) e pranojnë ndikimin që praktikatat e mësimdhënies bashkëpunuese mund të kenë për një mësimdhënie të suksesshme. Megjithatë, është me vend të përmendet fakti se 21% e studentëve shfaqin një qëndrim asnjanes lidhur me këtë çështje, gjë e cila na tregon se shqyrtimi dhe diskutimi i mëtejshëm mund të jetë i nevojshëm për të kuptuar plotësisht koklavitjen e temës. Por duhet të pranojmë se përqindja më e madhe e studentëve pajtohen me pohimin, çka thekson rëndësinë e mjediseve bashkëpunuese për të nxitur një mësimdhënie dhe nxënie të suksesshme.



Tabela 3 Rëndësia e punës në grup për një mjedis pozitiv nxënies në klasë

Bazuar në rezultatet e dhëna me sipër, 55% e studentëve e vlerësojnë punën në grup si jashtëzakonisht të rëndësishme (renditja 5) në nxitjen e një mjedisi pozitiv në klasë. Për më tepër, 40% e tyre e vlerësojnë atë si të rëndësishme (renditja 4). Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e punës në grup në krijimin e mjedisit të duhur dhe mbështetës brenda klasës. Vetëm një numër i vogël i studentëve (5%), e vlerësuan punën në grup si më pak të rëndësishme, duke i dhënë renditjen 3. Nisur nga këto të dhëna mund të pohojmë se puna në grup ka një rëndësi të veçantë në krijimin e një mjedisi pozitiv ku nxiten përpjekjet bashkëpunuese midis mësimdhënësve dhe studentëve, pjesëmarrja aktive e studentëve, respekti i ndërsjellë dhe rezultate të suksesshme të të nxënies brenda mjedisit të klasës.




Tabela 4 Sfida më e madhe gjatë punës në grup

65% pohojnë se kufizimet kohore janë vështirësia më e madhe që kanë hasur gjatë bashkëpunimit me pjesëtarët e tjerë të grupit, çka tregon se kufizimet kohore mund të pengojnë studentët të mblidhen së bashku për të shkëmbyer ide, për të mbledhur materiale apo për të ardhur me strategjitë e duhura mësimore. Të gjitha këto janë me rëndësi për një cilësi dhe dobishmëri të përpjekjeve bashkëpunuese të studentëve që do të mbulojnë pjesën e shpjegimit të tematikës së re gjatë të orës së mësimi. Ndërkohë, 30% e studentëve identifikojnë metodat e ndryshme të mësimdhënies si një sfidë e rëndësishme gjatë bashkëpunimit. Njohja dhe pajtimi me qasjet e ndryshme pedagogjike që studentët mund të kenë ndihmon në nxitjen e bashkëpunimit dhe siguron që përpjekjet bashkëpunuese të përputhen me nevojat dhe parapëlqimet e ndryshme të pedagogëve dhe studentëve.



Tabela 5 Probabiliteti për të kërkuar mundësi të tjera bashkëpunimi në grup

Pjesa më e madhe e studentëve (55%) shprehen se me shumë gjasa do të vazhdojnë të kërkojnë mundësi për bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tyre në të ardhmen. Kjo dëshmon qasjen pozitive ndaj angazhimit bashkëpunues, të nxitur nga njohja e përfitimeve

të bashkëpunimit në përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe krijimin e një mjedisi mbështetës profesional. Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme (30%) shprehen se mund të vazhdojnë të kërkojnë bashkëpunim, duke treguar një nivel interesi, por ndoshta me disa rezerva për shkak të pengesave që mund të ndikojnë në gatishmërinë e tyre për të vijuar në mënyrë aktive përpjekjet bashkëpunuese. Këto gjetje tregojnë një qëndrim përgjithësisht pozitiv ndaj bashkëpunimit mes të anketuarve, gjë e cila dëshmon aftësinë për bashkëpunim të vazhdueshëm për aq kohë sa ekzistojnë strukturat mbështetëse për të lehtësuar dhe inkurajuar një bashkëpunim të tillë. Përpjekjet për të kapërcyer pengesat apo vështirësitë e mundshme, të tilla si kufizimet kohore dhe qasjet e ndryshme bashkëpunuese, do të sjellin rritjen profesionale dhe përmirësimin e rezultateve në arsim.




Tabela 6 Shkalla e kënaqësisë lidhur me mbështetjen dhe udhëzimet e pjesëtarëve të grupit të punës

71 % e studentëve shprehen të kënaqur (57%) apo shumë të kënaqur (14 %), çka dëshmon se janë ndjerë të mbështetur dhe udhëhequr në mënyrën më të mirë të mundshme nga bashkëmoshatarët e tyre gjatë kësaj përvoje. Gjithashtu, qëndrimi pozitiv tregon një ndjenjë të fortë bashkëpunimi dhe mbështetjeje të ndërsjellë brenda grupeve të punës përgjegjës për mësimdhënien, ku të gjithë pjesëtarët e grupit inkurajohen të mbështesin dhe të mësojnë nga njëri-tjetri me qëllim sigurimin e mësimdhënies/ nxënies së suksesshme. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme (24%) tregojnë një qëndrim asnjanes, duke dëshmuar pasigurinë apo ngurrimin e tyre për t'u shprehur lidhur me këtë pyetje; qëndrim i cili mund të ketë ardhur për shkak se studentët mund të mos jenë ndjerë as të kënaqur dhe as të pakënaqur me përvojat e tyre bashkëpunuese. Kjo nënkupton nevojën për të përmirësuar më tej mekanizmat mbështetës dhe komunikimin brenda grupeve të

punës. Për më tepër, një përqindje e vogël (5 %) e të anketuarve shprehën pakënaqësi për mbështetjen dhe udhëzimet e dhëna, duke sinjalizuar aspekte të mundshme për përmirësim në nxitjen e një mjedisi më mbështetës dhe bashkëpunues midis anëtarëve të grupit të punës.



Tabela 7 Shkalla e dobishmërisë së planifikimit të orës mësimore në bashkëpunim

Bazuar në përgjigjet e dhëna, është i dukshëm fakti se 50% e studentëve (renditja 5) mendojnë se planifikimi i orës mësimore në bashkëpunim ndikon shumë në rritjen e pjesëmarrjes aktive të tyre. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm (30 %) vlerëson se kjo qasje bashkëpunuese ka ndikim, duke i dhënë renditjen 4. 20% e vlerësojnë planifikimin e orës mësimore në bashkëpunim deri diku të dobishëm (renditja 3). Vlen për t'u theksuar fakti se asnjë i anketuar nuk e vlerëson atë si të padobishëm, duke dëshmuar vlerën dhe suksesin e qasjeve bashkëpunuese në hartimin dhe zbatimin e planeve mësimore, rëndësinë që puna në grup midis mësimdhënësve ka në rritjen e pjesëmarrjes aktive dhe nxitjen e metodave pedagogjike cilësore.



Tabela 8 Shkalla e kënaqësisë lidhur me udhëzimet e pedagogut të lëndës dhe grupit të vlerësimit

Një përqindje e konsiderueshme e studentëve (40 %) shprehen shumë të kënaqur me udhëzimet, sugjerimet dhe komentet e bëra si nga pedagogu i lëndës dhe nga grupi i vlerësimit, dhe po e njëjta përqindje (40 %) shprehen të kënaqur. Ndërsa 20 % shprehen asnjëherë lidhur me këtë pyetje, qëndrim që mund të lidhet me përvojat individuale dhe perceptimet të ndryshme lidhur me cilësinë dhe dobinë e udhëzimeve, sugjerimeve dhe komenteve të pedagogut apo grupit të vlerësimit. Ndërsa disa prej të anketuarve mund ta kenë konsideruar feedback -un konstruktiv dhe mbështetës, të tjerë mund të jenë ndjerë indiferentë ose të pasigurt lidhur me rëndësinë e tij. Kjo thekson rëndësinë e përmirësimit të mekanizmave të feedback-ut dhe kanaleve të komunikimit midis grupeve të punës për të siguruar që mësuesit të ardhshëm të ndihen të mbështetur gjatë përpjekjeve të tyre për zhvillim profesional.




Tabela 9 Shkalla e aftësisë për të bashkëpunuar në një mjedis ekipor

Përgjigjet tregojnë një ndjenjë të fortë besimi midis studentëve në lidhje me aftësinë e tyre për të komunikuar dhe bashkëpunuar në mënyrë të dëshiruar me bashkëmoshatarët e tyre në një mjedis ekipor. Shumë prej tyre (50%) shprehen se janë ndjerë të sigurt në aftësitë e tyre dhe 30% shprehen jashtëzakonisht të sigurt duke na dëshmuar një nivel të lartë vetëbesimi midis mësuesve të ardhshëm për sa i përket angazhimit të tyre në përpjekjet bashkëpunuese, të gatshëm të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të kontribuojnë në grupe pune.

Për më tepër, bazuar në përgjigjet e tyre, asnjë prej studentëve nuk ka një besim të ulët në vetvete apo i mungon besimi duke na treguar se të gjithë pjesëmarrësit në grupet e punës kanë një bazë të fortë të aftësive të tyre të komunikimit dhe bashkëpunimit dhe janë të përgatitur t'i shfaqin ato gjatë punës në grup. Megjithatë, duhet të pranojmë se përpjekjet për të zhvilluar

dhe përmirësuar aftësitë e komunikimit dhe të bashkëpunimit duhet të jenë të vazhdueshme, duke siguruar që mësuesit të mund të maksimizojnë përfitimet nga praktikatat e mësimit bashkëpunues dhe të kontribuojnë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e tyre profesional.

1.

•Si mendoni se kanë ndikuar praktikatat bashkëpunuese të mësimit në rritjen dhe zhvillimin tuaj profesional si mësues të ardhshëm të gjuhës angleze?

Shumë studentë në përgjigjet e tyre theksojnë përfitimet që sjell bashkëpunimi lidhur me ndarjen e perspektivave, njohurive dhe burimeve, të cilat përmirësojnë strategjitë dhe qasjet ndaj mësimit. Mësuesit bashkëpunues nxit ndjenjën e komuniteti dhe mbështetjes midis stafit mësues, duke inkurajuar nxënien e vazhdueshme dhe përmirësimin në fushën e arsimit. Për më tepër, puna në grup i një mësuesit me metoda të ndryshme pedagogjike dhe inkurajon shkëmbimin e ideve, duke çuar në rritjen e aftësive krijuese dhe qasjeve të reja si në planifikimin e orës mësimore ashtu edhe në procesin e mësimit/nxënies.

Studentët e anketuar theksojnë rolin e bashkëpunimit në krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse të të nxënies, ku çdo njëri prej tyre ndihet i vlerësuar dhe i angazhuar në mënyrë të barabartë në procesin e mësimit dhe të nxënies. Nëpërmjet bashkëpunimit, pedagogët jo vetëm rrisin suksesin e tyre në mësimit, por gjithashtu kontribuojnë në gjithëpërfshirjen e studentëve të tyre nëpërmjet bashkëpunimit, ndërveprimit social dhe aftësive të nxënies gjatë gjithë jetës.

2.

•Duke reflektuar mbi përvojat tuaja të mësimit në bashkëpunim, çfarë njohurish apo mësimesh keni marrë lidhur me rëndësinë e kësaj praktike, veçanërisht në kontekstin e mësimit të gjuhës angleze?

Përgjigjet nxjerrin në pah një sërë përvojash, ku shumë prej studentëve shprehin qasje pozitive ndaj procesit të mësimit në bashkëpunim. Shumë prej tyre e shohin punën në grup si të dobishme dhe të vlefshme në materializimin e informacionit të ri, socializimin me bashkëmoshatarët dhe nxitjen e pranimit të mendimeve ndryshe. Për më tepër, puna në grup zhvillon aftësitë krijuese duke siguruar një

proces nxënieje të suksesshëm. Megjithatë, u përmendën edhe vështirësi të tilla si ballafaqimi me anëtarët e grupit që nuk kontribuuan në mënyrë të barabartë dhe vështirësitë lidhur me koordinimin e orareve.

Për të përmirësuar përvojën e punës në grup, u ofruan disa sugjerime lidhur me problematikat. U rekomandua vendosja e rregullave bazë në fillim të bashkëpunimit për të lehtësuar komunikimin dhe vendimmarrjen, gjë e cila do të parandalonte zvarritjen apo abuzimin me ngarkesën e punës. Për më tepër, duhet të sigurohet që të gjithë anëtarët e grupit të punës të kontribuojnë në mënyrë të barabartë dhe ta marrin seriozisht bashkëpunimin, çka do të mund të rrisë efektshmërinë dhe kënaqësinë e përvojës së punës në grup. Gjetja e mënyrave për të përshtatur oraret e ndryshme dhe parapëlqimet e komunikimit mund të ndihmojë në përmirësimin e përpjekjeve të bashkëpunimit dhe të sigurojë që të gjithë anëtarët të kenë mundësinë të marrin pjesë në mënyrë aktive.

Kufizime të punimit

Ky studim ofron njohuri të vlefshme lidhur me përvojën bashkëpunuese, por paraqet edhe disa kufizime. Së pari, numri i vogël i të anketuarve e vështirëson përgjithësimin e gjetjeve dhe kufizon gamën e perspektivave të përfaqësuara. Për më tepër, mbështetja të dhënat e vetëraportuara mund të paraqesë paragjykime dhe pasaktësi të mundshme, pasi pjesëmarrësit mund të jenë ndikuar nga normat sociale apo pritshmëritë e tyre personale çka mund të bëjë që përgjigjet e tyre të mos jenë krejtësisht të sinqerta. Për më tepër, fusha e ngushtë e pyetjeve të studimit, duke u

Përfundime

Në ditët e sotme ka një vlerësim dhe njohje të përfitimeve të rëndësishme të bashkëpunimit në rritjen e suksesit në mësimdhënie, nxitjen e rritjes profesionale dhe krijimin e mjediseve mësimore gjithëpërfshirëse. Në studimin e kryer

vihet re një qasje pozitive e studentëve lidhur me ndikimin e bashkëpunimit në pjesëmarrjen aktive të tyre, strategjitë e mësimdhënies dhe zhvillimin individual, duke theksuar vlerën e punës në grup në arsim. Pavarësisht përfitimeve të qarta, studimi gjithashtu nxori në pah disa vështirësi të qenësishme të punës në grup. Kufizimet kohore, stilet e ndryshme të punës, pengesat në komunikim dhe shpërndarja e pabarabartë e ngarkesës ishin ndër vështirësitë më të zakonshme të përmendura nga studentët pjesë e këtij studimi. Këto vështirësi theksojnë rëndësinë e krijimit të rrugëve të qarta të komunikimit, vendosjes së rregullave bazë dhe llogaridhënies brenda grupeve bashkëpunuese me qëllim kapërcimin e pengesave, zhvillimin e metodave të duhura të mësimdhënies dhe sigurimin e një bashkëpunimi produktiv.

Pavarësisht vështirësive të përmendura, bashkëpunimi jo vetëm që rrit suksesin në mësimdhënie, por gjithashtu nxit mbështetjen e ndërsjellë, aftësitë krijuese dhe metodat e reja pedagogjike të mësimdhënësve. Duke shfrytëzuar perspektiva të ndryshme, duke ndarë burimet dhe duke nxitur ndjenjën e komunitetit, praktikatat bashkëpunuese të mësimdhënies kontribuojnë në procesin e vazhdueshëm të nxënies, përmirësimin dhe zhvillimin profesional në fushën e arsimit.

përqendruar kryesisht në aspekte të caktuara të bashkëpunimit, anashkalon dimensione më të gjera që mund të ofrojnë njohuri më të thella në sfidat ndërdisiplinore ose ndikimin e udhëzimeve në efektivitetin e bashkëpunimit. Gjithashtu, mungesa e faktorëve si kultura institucionale ose stilet individuale të mësimdhënies, mbeten të pastudiura. Këto kufizime theksojnë nevojën për kërkime të ardhshme me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe ofrimin e një kuptimi më të plotë të praktikave të mësimdhënies bashkëpunuese në mësimdhënien e gjuhës angleze.

Bibliografia

1. Chan, E., & Pheng, L. S. *Teamwork and project management*. Routledge: Routledge; (2018).
2. Driskell, T., Salas, E., & Driskell, J. E. *Foundations of teamwork and collaboration: American Psychological Association*; 2018.

3. Katzenbach, J. R., & Smith, D. K. *The wisdom of teams: Creating the high-performance organization*. (2015).
4. Sanyal, S., & Hisam, M. W. *Leading in high growth Asia: Managing relationship for teamwork and collaboration in the workplace*. Routledge. 2018.
5. Johnson, D. W., & Johnson, R. T. *Cooperative learning in 21st-century classrooms: Making it work*: Sage Publications; (2017).

6. Council N.R. *Education for Life and Work: Developing Transferable Knowledge and Skills in the 21st Century: The National Academies Press.*; 2012.
7. Bruffee K.A., *Collaborative Learning and the "Conversation of Mankind". College English. College English. 1984; 46: 635-652.*
8. Johnson, D. W., & Johnson, R. T. *The impact of cooperative learning on self-directed learning. In: The Cambridge Handbook of the Learning Sciences.: Cambridge University Press; 2017.*
9. Gillies, R. M *Cooperative Learning: Review of Research and Practice. Australian Journal of Teacher Education, 41(3). Australian Journal of Teacher Education, 41(3). (2016).*
10. Kyndt, E., Raes, E., Lismont, B., Timmers, F., Cascallar, E., & Dochy, F. *A meta-analysis of the effects of face-to-face cooperative learning. Do recent studies falsify or verify earlier findings? Educational Research Review, 10. 2013;: 133-149.*
11. Barkley, E. F., Cross, K. P., & Major, C. H. *Collaborative learning techniques: A handbook for college faculty: Jossey-Bass.; (2014).*
12. Gillies, R. M., Ashman, A. F., & Terwel, J. *The teacher's role in implementing cooperative learning in the classroom. Springer. (2008).*
13. Smith, K. A., Johnson, D. W., & Johnson, R. T. *Active learning: Cooperation in the college classroom: Interaction Book Company.; 1992.*
14. Vik T. *Cooperative learning methods in undergraduate mathematics, based on a literature review. International Journal of Mathematical Education in Science and Technology. (2001);: 32(6), 829-850.*
15. V. J., Weldon, T. L., & Felder, R. M. *Peer assessment of student learning. Journal of Professional Issues in Engineering Education and Practice. Journal of Professional Issues in Engineering Education and Practice. 2000; 126(2), : 66-70.*
16. Gueldenzoph, L. E., & May, D. R. *Skill development in the first five years of work: A longitudinal study of the effects of university, college major, and job change. Journal of Vocational Behavior, 61(3). (2002);: 441-459.*
17. MacGregor J. *A critical guide to cooperative learning: How students work and learn in small groups. Teachers College Press. 1992.*
18. Miller J.C., & O.B.M. *Creative learning: A framework for creativity in learning. Journal of Creative Behavior. Journal of Creative Behavior. 1992.*
19. Smith K.A. *Cooperative learning and individual student achievement in college teaching. Journal on Excellence in College Teaching. 1986.*

IDENTIFICATION OF SUPPORT TEACHERS' NEEDS FOR QUALIFICATION ON TEACHING METHODS AND TECHNIQUES FOR CHILDREN WITH SPECIAL NEEDS

Dr. Sultane Bilbilaj

Departamenti i Edukimit

Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë

tanabilbili@yahoo.com

Abstrakt

Ky studim është realizuar me 115 mësues mbështetës për 152 fëmijët me nevoja të veçanta, në 27 shkolla 9-vjeçare dhe 10 kopshte në ZVA Vlorë-Himarë. Tashmë, prania e mësuesve mbështetës në klasat gjithëpërfshirëse për fëmijët me nevoja të veçanta është realitet dhe sukses i politikave arsimore në vend. Ajo çfarë ngelet sfidë akoma është cilësia e mësimdhënies që u ofrohet këtyre fëmijëve me nevoja të veçanta, pasi mësueset mbështetëse janë kryesisht jashtë profilit të një pedagogjie të specializuar. Ky ishte edhe qëllimi i këtij studimi: të identifikohen nevojat e mësueseve mbështetëse për kualifikime më të specializuara mbi metodat dhe teknikat specifike që përdoren sipas nevojave të veçanta, për të rritur nivelin e arritjeve në shkollë dhe jashtë saj. Në studim gjendet informacion të duhur teorik mbi çrregullimet në të nxënë si: disleksi, diskalkuli, disgrafi, mbi çrregullime te Spektrit Autizëm, hiperaktivitet dhe shpërqëndrim vemendjeje, sindromën daun, epilepsinë dhe prapambetjen mendore. U fokusua në trajtimin teorik vetëm të këtyre çrregullimeve, nisur nga diagnoza e njëzetë e katër fëmijëve që janë pjesë e studimit. Një fokus të veçantë në studim, përveç metodave dhe teknikave specifike që duhet të jetë kompetent mësuesi për t'i përdorur në orën e mësimit, ishte edhe mjedisi fizik i të nxënit dhe mjetet mësimore didaktike të përdorura nga mësuesi. Nga të dhënat e grunbulluara nga ky

studim, doli që mësueset mbështetëse nuk kanë performancën e duhur për të qenë koherent në mësimdhënje ndaj këtij target grupi dhe kanë nevojë për kualifikime të vazhduara specifike për çrregullimet në të nxënë dhe llojet e tyre, si dhe epilepsinë duke marrë informacion praktik me parime dhe mënyra të trajtimit dhe metodikës së mësimdhënies në klasa me këta fëmijë. Roli i shqisave në procesin e të nxënit pati vend të veçantë në trajtimin teorik që mësueset të përdorin metoda mësimdhënieje dhe mjete didaktike që të stimulojnë sa më shumë shqisa që të jetë e mundur. Për t'u përmendur në këtë studim është edhe pjesëmarrja aktive e prindërve të shumicës së fëmijëve të marrë në studim, të cilët morën njohuri si të vazhdojnë të punojnë me fëmijët e tyre në shtëpi atë çfarë ka nisur mësuesja në shkollë.

Nga ky studim dolën mendimet e prindërve për situatat në shkollat ku frekuantojnë fëmijët e tyre. Mendimet ishin për arritjet, socializimin, metodat e përdorura nga mësuesja dhe nevojën e tyre për bashkëpunim më të ngushtë me ta dhe të dinë vetë si të punojnë si prindër. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi janë nevoja që këto mësuese mbështetëse kanë për të gjitha çrregullimet që mbartin këta fëmijë.

Fjalët kyçe: *mësimdhënie, mësuese mbështetës, nevojë për kualifikim, nxënës, nevoja të veçanta*

Abstract

